

**ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE PËR TIK
DHE GJUHË ANGLEZE - PERSPEKTIVË PËR
INTEGRIM NË EPOKËN DIGJITALE**



Prishtinë, 2012

**ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE PËR TIK
DHE GJUHË ANGLEZE - PERSPEKTIVË
PËR INTEGRIM NË EPOKËN
DIGJITALE**

Raporte të studimeve

Prishtinë, 2012

Botues

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

Autorë

M.Sc.Haxhere Zylfiu

M.Sc.Selim Mehmeti

Kryeredaktor

M.Sc.Nezir Çoçaj

Redaktor teknik

Skender Mekolli

Lektor

M.Sc.Bekim Morina

Tirazhi: 500 copë

Përgatitjen për botim
Ekipi hulumtues -IPK

Përmbajtja

ECDL – mundësi e përfitimit dhe e certifikimit të kompetencave për teknologji të informimit dhe komunikimit 5

Zbatimi i përmbajtjeve didaktike „English for Beginners’’ në lëndën e gjuhës angleze në shkollat profesionale në Kosovë 141

Instituti Pedagogjik i Kosovës

**ECDL – mundësi e përfitimit dhe e certifikimit të
kompetencave për teknologji të informimit dhe
komunikimit**

Raport i studimit kërkimor

Prishtinë, 2012

Autorë të raportit:

1. M. Sc. Haxhere Zylfiu
2. M. Sc. Selim Mehmeti

Ekipi hulumtues:

1. M. Sc. Haxhere Zylfiu
2. M. Sc. Selim Mehmeti
3. Mr. Sc. Hajrije Devetaku
4. Sahare Reçica
5. Skender Mekolli
6. M.Sc.Luljeta Shala
7. Binak Gërguri

Falënderime

Falënderojmë Fondacionin ECDL Kosova për përkrahje në realizimin e studimit kërkimor “ECDL – mundësi e përfitimit dhe e certifikimit të kompetencave për TIK-un”. Në mënyrë të veçantë, dëshirojmë të falënderojmë z. Bekim Kasumi, drejtor i Fondacionit ECDL Kosova, për bashkëpunim korrekt dhe profesional në ofrimin e të gjitha resurseve të nevojshme për realizimin e aktiviteteve të studimit.

Gjithashtu, shprehim falënderime për të gjithë drejtorët e shkollave, mësuesit, nxënësit dhe të tjerët që kontribuuan në këtë studim, pa ndihmën e të cilëve studimi nuk do të mund të realizohej dhe të përfundonte me sukses!

Përmbajtja:

<i>Shkurtesat e përdorura</i>	11
<i>Tabela dhe figura</i>	13
PËRMBLEDHJE	16
<i>Qëllimi i studimit</i>	16
<i>Qëllimi i raportit të studimit</i>	16
<i>Metodologjia e studimit</i>	16
<i>Gjetjet kryesore</i>	17
<i>Rekomandimet kryesore</i>	20
I. HYRJE	22
<i>1.1 Konteksti i studimit</i>	22
<i>1.2. Konteksti i zhvillimit të politikave arsimore në fushën e TIK-ut dhe ndërlidhja me ECDL-në</i>	23
II. KORNIZA KONCEPTUALE	24
<i>2.1. Kompetencat</i>	24
<i>2.2. Rezultatet mësimore</i>	25
<i>2.3. Fusha e kurrikulës Jeta dhe puna</i>	25
<i>2.4. Plani dhe programi mësimor Teknologji me TIK-un</i>	26
<i>2.5. Patenta Evropiane për Përdorimin e Kompjuterit – ECDL</i>	26
III. METODOLOGJIA E STUDIMIT	27
<i>3.1. Qëllimi dhe objektivat e studimit</i>	27
<i>3.2. Strategjitë e përdorura</i>	28
<i>3.2.1. Studimi kabinetik</i>	28
<i>3.2.2. Studimi në terren</i>	29
<i>3.3. Popullacioni dhe mostra</i>	29
<i>3.4. Realizimi i hulumtimit</i>	33
<i>3.4.1. Si kemi vepruar në realizimin e hulumtimit përmes teknikës së anketimit?</i>	33
<i>3.4.2. Si kemi vepruar në realizimin e testimit me testin e standardizuar të ECDL-së?</i>	33

3.4.3. Punëtorja me fokus-grupe.....	35
IV. MODELE TË AVANCUARA NGA VENDET EVROPIANE PËR INTEGRIMIN E ECDL-SË NË SHKOLLA.....	36
4.1. Çfarë nënkuptohet me kompetencat për teknologjinë informative?.....	36
4.2. Patenta Evropiane për përdorimin e kompjuterit - ECDL (European Computer Driving Licence).....	38
4.2.1. Karakteristikat kryesore të programit të ECDL -së.....	41
4.2.2. Historiku i zhvillimit global të programit të ECDL-së.....	42
4.2.3. Misioni i Fondacionit të ECDL-së.....	44
4.2.4. Agjenda Digjitale për Evropë 2010-2020.....	45
4.2.5. Përfitimet nga programi i ECDL-së	46
4.3. Modele të avancuara nga vendet evropiane për integrimin e ECDL-së në shkolla.....	48
4.3.1. Modeli austriak i integrimit të ECDL-së në shkolla.....	49
4.4. Modeli zviceran i integrimit të ECDL-së në shkolla.....	55
4.5. Fondacioni i ECDL-së në Kosovë - historiku dhe aktivitetet ..	59
4.6. Kostoja e përfitimit në programin e ECDL-së në Kosovë	61
V. PËRFSHIRJA E TIK-UT NË PROGRAMET E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT (KLASAT 6-9) DHE ARSIMIT TË MESËM TË LARTË (KLASAT 10-12/13)	63
5.1. Konteksti i zhvillimit të programeve të TIK-ut në Kosovë.....	63
5.2. Përfshirja e TIK-ut në planet dhe programet mësimore nga klasa e 10-të deri në klasën e 12-të në gjimnaze	68
5.3. Përfshirja e TIK-ut në planet dhe programet mësimore nga klasa e 10-të deri në klasën e 12-të në shkolla profesionale (profile dhe lëmi profesionale).....	76
VI. OPINIONET E NXËNËSVE PËR PËRFITIMET NGA TIK-U DHE KOMPETENCAT PËR PËRDORIMIN E KOMPJUTERIT.....	81
6.1. Informimi me përmbajtjen e programeve kryesore që ofron TIK-u dhe mënyrat e fitimit të kompetencave për përdorimin e kompjuterit.....	81

6.2.	<i>Përfshirja në kurse jashtëshkollore dhe internet-kafe për përdorimin e kompjuterit</i>	84
6.2.1.	<i>Qëllimet e përdorimit të kompjuterit në internet-kafe</i>	85
6.2.2.	<i>Qëllimi i përdorimit të kompjuterit në shtëpi</i>	86
6.3.	<i>Zbatimi i teknologjisë së informimit dhe komunikimit në mësim</i>	88
	<i>A është përdorur/zbatuar teknologjia (TIK) në kuadër të mësimin në klasën tuaj?</i>	88
6.3.1.	<i>Në cilat lëndë mësimore është bërë përpunimi i teksteve me programin Word në kuadër të mësimin në klasën tuaj?</i>	89
6.3.2.	<i>Në cilat lëndë mësimore është përdorur programi PowerPoint për prezantime në mësim?</i>	90
6.3.3.	<i>Sa kanë qenë programet e TIK-ut, të shfrytëzuara në mësim, në funksion të përfitimit të kompetencave për përdorimin e kompjuterit?</i>	90
6.4.	<i>Vetëvlerësimi i nxënësve për nivelin e kompetencave të tyre për përdorim të kompjuterit</i>	91
6.5.	<i>Perceptimi i nxënësve për nivelin e kompetencave të mësimdhënësve për përdorim të TIK-ut në mësim</i>	95
6.5.1.	<i>Niveli i shkathtësisë të mësimdhënësve në përdorimin e kompjuterit</i>	95
VII.	REZULTATET E NXËNËSVE TË TESTUAR ME TESTIN E STANDARDIZUAR TË ECDL-SË	97
7.1.	<i>Rezultatet e nxënësve të klasës së 10-të dhe 12-të</i>	98
7.2.	<i>Rezultatet e nxënësve/studentëve në testin e standardizuar të ECDL-së</i>	101
7.3.	<i>Vlerësimi i procesit të testimit për programin e ECDL-së nga nxënësit e testuar</i>	104
7.4.	<i>Rezultatet e testit të arritshmërisë, klasa e 9 -të</i>	106
7.5.	<i>Rezultatet e provimit të maturës në lëndën e TIK-ut</i>	107

<i>VIII. MUNDËSITË E INTEGRIMIT TË MODULEVE TË ECDL-SË NË KURRIKULËN E TIK-UT DHE NË KURRIKULAT LËNDORE TË FUSHËS.....</i>	<i>109</i>
<i>IX. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....</i>	<i>114</i>
<i>9.1. Vlerësimi i studimit.....</i>	<i>114</i>
<i>9.2. Gjetjet më të rëndësishme të studimit.....</i>	<i>115</i>
<i>9.3. Përfundimi.....</i>	<i>120</i>
<i>9.4. Rekomandime.....</i>	<i>121</i>
<i>Referencat:.....</i>	<i>123</i>
<i>Shtojcat.....</i>	<i>125</i>

Shkurtesat e përdorura

MASHT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
ECDL	Patenta Evropiane për përdorimin e kompjuterit (European Computer Driving Licence)
ICDL	Patenta Internacionale për Përdorimin e Kompjuterit
CEPIS	Këshilli Evropian i Shoqërive të Informatikës Profesionale
ESPRIT	European Strategic Program on Research in Information Technology (Programi Strategjik Evropian për Hulumtime në Teknologjinë e Informacionit)
TIK	Teknologjia e Informacionit
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
KKK	Korniza e Kurrikulës të Kosovës
AUK	Universiteti Amerikan në Kosovë
SBASHK	Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës
SHMT	Shkolla e Mesme Teknike
UN	Kombet e Bashkuara
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë
KE	Komisioni Evropian
IWI	Institut für Wirtschaftsinformatik (Instituti për Informatikë të Ekonomisë)
ISO	International Organization for Standardization (Organizata Ndërkombëtare për Standardizim)
BE	Bashkësia Evropiane
DLGI	Dienstlaistungsgesellschaft für Informatik (Kompania e Shërbimit për Informatikë)
ISH	Instituti për Kërkime Arsimore në Hamburg
OCG	Österreichischen Computer Gesellschaft - Shoqërisë Austriake për Kompjuter
BMUKK	Bundesministerium für Unterricht, Kunst und Kultur (Ministria Federale për Arsim, Art dhe Kulturë)
SI	Schweizer Informatik Gesellschaft (Shoqëria Zvicerane për

	Informatikë)
AHS	Allgemeinbildene Höhere Schule (Shkollë e Mesme e Përgjithshme)
APS	Allgemeinebildene Pflichtschule (Shkollë e Përgjithshme e Obliguar)
BS	Berufsschule (Shkollë Profesionale)
PH	Pädagogische Hochschulen (Shkollë e Lartë Pedagogjike)
PISA	Programme for International Student Assessment (Program për Vlerësim Ndërkombëtar të Studentëve)
QT	Qendra Testuese
SI	Schweizer Informatik Gesellschaft (Shoqëria Zvicerane për Kompjuter)
EDK	Konferenca Zvicerane e Drejtorëve Kantonalë të Arsimit
ISCED	International Standard Classification of Education (Klasifikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Arsimit)
OJQ	Organizatë Joqeveritare
PVPE	Plani i Veprimit i Partneritet Evropian
GIZ	Gesellschaft für Internationale Zusaemmenarbeit (Shoqëria për Bashkëpunim Ndërkombëtar)

Tabela dhe figura

- Tabela 1. Shpërndarja e mostrës së nxënësve sipas variabëlilit të tipit të shkollave, drejtimeve dhe klasave;
- Tabela 2. Shpërndarja e nxënësve sipas variabëlilit të vendbanimit fshat - qytet;
- Tabela 3. Shpërndarja e nxënësve kandidatë për studentë sipas variabëlilit të fakultetit ku janë anketuar dhe gjinisë;
- Tabela 4. Kostoja për kualifikim për testues/vlerësues;
- Tabela 5. Kostoja e përgjithshme për programin ECDL;
- Tabela 6. Materialet mësimore për programin ECDL-së;
- Tabela 7. Pasqyra e kostos për programin e ECDL-së, specifikuar në modulet përkatëse;
- Tabela 8. Programi i TIK-ut në klasën e 11-të, specifikuar në kategoritë kryesore, nënkategoritë mësimore dhe fondit të orëve mësimore në drejtimet e gjimnazit;
- Tabela 9. Programi i TIK-ut në klasën e 12-të, specifikuar në kategoritë kryesore, nënkategoritë mësimore dhe fondit të orëve mësimore në drejtimet e gjimnazit.
- Tabela 10. Programi i TIK-ut në klasën e 13-të, specifikuar në kategori kryesore, nënkategori dhe fond të orëve;
- Tabela 11. Plani i rishikuar i orëve të TIK-ut sipas fushave dhe profileve dhe sipas klasave;
- Tabela 12. Përgjigjet e nxënësve për informimin e tyre me përmbajtjet e programit që ofron TIK-u;
- Tabela 13. Përgjigjet e nxënësve për mënyrat e ngritjes së kompetencave të tyre për përdorimin e kompjuterit;
- Tabela 14. Përgjigjet e nxënësve për qëllimet e përdorimit të kompjuterit gjatë frekuentimit të tyre në internet-kafe;
- Tabela 15. Përgjigjet e nxënësve për qëllimet e përdorimit të kompjuterit në shtëpi;
- Tabela 16. Përgjigjet e nxënësve për zbatimin e TIK-ut në kuadër të mësimi;

- Tabela 17. Përgjigjet e nxënësve për përpunimin e teksteve në kuadër të mësimin në klasat e tyre, me programin e Word-it;
- Tabela 18. Përgjigjet e nxënësve për përdorimin e programit PowerPoint për prezantime në mësim;
- Tabela 19. Përgjigjet e nxënësve për programet e shfrytëzuara në mësim, në funksion të përfitimit të kompetencave për përdorimin e kompjuterit;
- Tabela 20. Ndërlidhja e përgjigjeve të nxënësve për mënyrat e përfitimit të kompetencave për përdorimin e kompjuterit dhe vetëvlerësimit për kompetencat që i zotërojnë;
- Tabela 21. Arsyet sipas nxënësve për kompetenca jo të larta dhe jo të kënaqshme të nxënësve për TIK-un;
- Tabela 22. Përgjigjet e nxënësve për mënyrën e aplikimit në Universitet dhe ndërlidhja me përgjigjet për nivelin e kompetencave të deklaruara nga vetë nxënësit;
- Tabela 23. Përgjigjet e nxënësve për mënyrën e aplikimit në Universitet dhe ndërlidhja me përgjigjet për nivelin e kompetencave të deklaruara nga vetë nxënësit;
- Tabela 24. Nivelet e sigurisë së nxënësve që kanë mbaruar maturën për aplikimin e shkathtësive të tyre në përdorimin e kompjuterit;
- Tabela 25. Niveli i sigurisë së nxënësve për aplikimin e shkathtësive të tyre në përdorimin e kompjuterit;
- Tabela 26. Arsyet sipas nxënësve për kompetenca jo të larta dhe jo të kënaqshme të nxënësve për TIK-un;
- Tabela 27. Numri i dhe përqindja e nxënësve sipas klasave dhe tipit të shkollave që kanë marrë pjesë në testin e standardizuar të ECDL-së;
- Tabela 28. Numri i dhe përqindja e nxënësve sipas gjinisë dhe tipit të shkollave që kanë marrë pjesë në testin e standardizuar të ECDL-së;
- Tabela 29. Numri i nxënësve sipas gjinisë, klasave, tipit të shkollave dhe moduleve të ECDL-së që kanë hyrë në test;
- Tabela 30. Numri i nxënësve sipas tipit të shkollave që kanë kaluar pozitivisht modulet e ECDL-së;

- Tabela 31. Rezultatet e nxënësve në modulet e ECDL-së specifikuar në gjini;
- Tabela 32. Numri i nxënësve/studentëve të testuar, sipas tipit të shkollave dhe gjinisë;
- Tabela 33. Numri i nxënësve/studentëve të testuar, specifikuar në module të testuara, tipit të shkollës dhe gjinisë;
- Tabela 34. Numri i nxënësve/studentëve që kanë realizuar pozitivisht më shumë se 75% të testit në modulet përkatëse, sipas moduleve, tipit të shkollave dhe gjinisë;
- Tabela 35. Shkalla e kënaqësisë me procesin e testimit;
- Tabela 36. Arsyet sipas nxënësve për mosp suksesin e tyre në teste;
- Tabela 37. Hapat që do t'i ndërmarrin nxënësit për të përmirësuar dhe avancuar shkathtësitë e përdorimit të kompjuterit.

PËRMBLEDHJE

Qëllimi i studimit

Qëllimi i përgjithshëm i studimit “*ECDL – mundësi e përfitimit dhe e certifikimit të kompetencave për TIK*” është të kontribuojë në promovimin e vlerave të ECDL-së për integrim në epokën digjitale në kontekst të zhvillimeve në fushat kurrikulare të arsimit në Kosovë.

Qëllimi i raportit të studimit

Raporti sjell rezultatet nga (i) studimi i përvojave të Zvicrës dhe Austrisë në integrimin e ECDL-së në kurrikulat mësimore, (ii) studimi i programeve ekzistuese të TIK-ut në arsimin parauniversitar në Kosovë, si dhe (iii) rezultatet nga studimi i kompetencave të nxënësve për përdorimin e kompjuterit.

Raporti është përgatitur me qëllim të informimit të komunitetit arsimor në Kosovë lidhur me: (i) përvojat ndërkombëtare (Zvicrës dhe Austrisë) në integrimin e ECDL-së në kurrikula mësimore(ii) përfaqësimin e TIK-ut në programet mësimore dhe me nivelin e kompetencave të nxënësve për përdorimin e kompjuterit; si dhe (iii) me qëllim të nxitjes së një debati të brendshëm të palëve me interes në fushën e arsimit mbi veprimet e nevojshme që duhet të ndiqen për përfshirjen ECDL-së në kurrikula mësimore.

Metodologjia e studimit

Metodologjia e studimit konsiston në një analizë cilësore dhe sasiore të gjendjes aktuale në fushën e TIK-ut dhe kompetencave të nxënësve për përdorimin e kompjuterit. Metodologjia e studimit është bazuar në: **(i) hulumtimin kabinetik**, nëpërmjet të cilit është bërë analiza e

dokumenteve dhe programeve ekzistuese në fushën e TIK-ut dhe përvojave ndërkombëtare; **(ii) hulumtimin përmes pyetësorëve dhe testeve të standardizuara të vlerësimit për ECDL** (duke përdorur një kampion përfaqësues), përmes të cilëve janë marrë opinionet e nxënësve lidhur me TIK-un dhe janë matur kompetencat e nxënësve për përdorimin e kompjuterit; **(iii) diskutimeve me fokus grup**, për të validuar gjetjet nga studimi dhe për të diskutuar mundësitë e integritit të ECDL-së në kurrikulat e reja.

Studimi me nxënës është përqendruar në klasën e 9-të të shkollës së mesme të ulët, në klasën e 11-të të shkollës së mesme të lartë dhe në klasën përfundimtare të shkollës së mesme të lartë (klasa 12/13/).

Gjetjet kryesore

Nga analiza dhe diskutimi i rezultateve kemi gjetjet në vijim:

- Fondi i orëve dhe përmbajtjet e TIK-ut në klasat 6-të,7-të dhe 8-të nuk e siguron zhvillimin minimal të shkathtësive të nxënësve për përdorimin e kompjuterit. Në klasën e 9-të kemi një ngritje të fondit të orëve, mirëpo përmbajtja programore dhe fondi i orëve në këtë klasë/moshë nuk mbulon nevojat për zhvillimin e kompetencave të nxënësve për TIK-un;
- Ndryshimet e programit të TIK-ut në mes të drejtimeve dhe klasave në arsimin e mesëm të lartë nuk sigurojnë arritjen e kompetencave minimale për përdorimin e kompjuterit nga të gjithë nxënësit. Një numër i konsiderueshëm i rezultateve të pritura mësimore, të vendosura në plane dhe programe të *Teknologjisë me TIK-un*, më shumë janë dhënë në formë të deklaratave të synimeve sesa të rezultateve mësimore të matshme;
- Përmbajtjet e TIK-ut në tekstet në shfrytëzim nuk i prezantojnë në masë të duhur zhvillimet në fushën e TIK-ut, një numër i konsiderueshëm i pyetjeve të shtruara në tekstet e TIK-ut për nxënës, më shumë promovojnë të nxënët teorik sesa atë praktik;

- Ngritja e kompetencave për përdorimin e kompjuterit nga nxënësit është realizuar në mënyra të ndryshme. Të dhënat nga hulumtimi tregojnë se në masën më të madhe nxënësit (45 % e tyre) i kanë përvetësuar shkathtësitë e kompjuterit në shtëpi, në mënyrë të pavarur dhe me përkrahjen e anëtarëve të tjerë të familjes, pastaj në shkollë (42% e nxënësve), në internet-kafe (7 % e nxënësve), në kurse për përdorim të kompjuterit (2.52 % e nxënësve) dhe në forma të tjera (3 % e nxënësve);
- Zbatimi i TIK-ut në mësim dallon nga shkolla në shkollë dhe nga klasa në klasë. Më shumë se gjysma e nxënësve të anketuar (56 % e tyre) pohojnë se vetëm ndonjëherë, apo fare nuk është përdorur TIK-u në mësim. Pjesa tjetër e nxënësve të anketuar (44 %) pohojnë se shumë shpesh dhe shpesh është përdorur TIK-u në kuadër të mësimin në klasat e tyre. Programet e TIK-ut, si Word, Exel, Power Point etj., kryesisht përdoren vetëm në lëndën e informatikës;
- Vetëvlerësimi i nxënësve për nivelin e kompetencave të tyre për përdorim të kompjuterit është mjaft i lartë, mirëpo është kontradiktor me rezultatet e testimit me teste të ECDL-së, meqenëse rezultatet e testimit janë tejet të ulëta në të gjitha modulet e testuara;
- Në pyetjen drejtuar nxënësve në pyetësor: *Si keni vepruar gjatë shkarkimit të aplikacionit nga ueb-faqja e Universitetit të Prishtinës dhe si e keni plotësuar atë?*, vetëm 46 % e kandidatëve të anketuar gjatë kohës së dorëzimit të dokumentacionit për regjistrim në Universitetin e Prishtinës kanë thënë se këtë e kanë bërë vetë, pa ndihmën e askujt, ndërsa të tjerët janë ndihmuar nga të afërmit e tyre për këtë procedurë;
- Prej 208 nxënësve të anketuar me pyetësor, vetëm 108 kanë marrë pjesë në testet e standardizuara ECDL-së. Shumica e theksuar e nxënësve të anketuar që nuk kanë marrë pjesë në testin e standardizuar të ECDL-së, mospjesëmarrjen në test e arsyetojnë me pasigurinë që ata kanë pasur lidhur me kompetencat e tyre për përdorimin e kompjuterit;

- Nxënësit e përfshirë në testin e standardizuar të ECDL-së nuk janë përgatitur paraprakisht me teste diagnostikuese, me qëllim të vërtetimit se sa përgatitja e tyre paraprake nga shkolla dhe format e tjera i kanë siguruar kompetencat bazë për përdorimin e kompjuterit. Nga numri i përgjithshëm i nxënësve që janë testuar në modulet përkatëse me testet e standardizuara të ECDL-së kalueshmëria ka qenë¹:

- **Moduli 1** - Bazat e teknologjisë së informimit dhe komunikimit (ICT) kanë kaluar 3 (37.80 %) nga 8 nxënës që kanë përfunduar maturën dhe janë testuar për këtë modul;
- **Moduli 2** - Shfrytëzimi i kompjuterit dhe menaxhimi i fajllave (Windows XP) kanë kaluar 10 (33.33 %) nga 30 nxënës që kanë përfunduar maturën dhe 9 (18.75 %) nga 48 nxënës të klasës X apo XII dhe janë testuar për këtë modul;
- **Moduli 3** - Përpunimi i teksteve (Word) kanë kaluar 1 (3.45 %) nga 29 nxënës që kanë përfunduar maturën dhe 1 (2.08 %) nga 48 nxënës të klasës X apo XII të testuar për këtë modul;
- **Moduli 4** - Kalkulimi i tabelave (Excel) nuk ka kaluar asnjë nga 30 nxënës që kanë përfunduar maturën, të testuar për këtë modul;
- **Moduli 5** - Baza e të dhënave (Access) ka kaluar 1(12.50%) nga 8 nxënës që kanë përfunduar maturën, të testuar për këtë modul;
- **Moduli 6** - Prezantimet (Power Point) kanë kaluar 2 (20 %) nga 10 nxënës që kanë përfunduar maturën dhe 2 (6.90 %) nga 29 nxënës të klasës X apo XII, të testuar për këtë modul;
- **Moduli 7** - Interneti dhe komunikimi (Internet Explorer & Outlook) kanë kaluar 2 (7.69%) nga 26 nxënës që kanë përfunduar maturën dhe 1 (2.13%) nga 47 nxënës të klasës X apo XII, të testuar për këtë modul.

¹ Pragu i kalueshmërisë në modulet përkatëse të ECDL-së ka qenë 75 pikë, prej 100 pikëve.

Fondacioni ECDL Kosova me sukses e ka promovuar standardin e ECDL-së në Kosovë. Standardi i ECDL-së në Kosovë është adaptuar si standard nga një mori organizatash e institucionesh të vendit, duke përfshirë edhe një numër të shkollave publike dhe private. Përmbajtjet e moduleve të ECDL-së janë kërkesa bazë të arritjes së kompetencave të nxënësve për përdorimin e kompjuterit dhe mund të integrohen në kurrikulat mësimore të TIK-ut dhe të lëndëve të tjera mësimore në arsimin parauniversitar në Kosovë.

Pjesëmarrësit e përfshirë në diskutime për planet dhe programet e TIK-ut propozojnë integrimin e ECDL-së në shkolla përmes:

- Moduleve të veçanta për nxënës;
- Si lëndë e veçantë;
- Fushave kurrikulare dhe lëndëve të tjera mësimore;
- Realizimit të projekteve.

Modeli austriak dhe modeli zviceran i integrimin të ECDL-së në shkolla janë modele të avancuara dhe mund të shërbejnë si bazë orientuese se si mund të integrohet ECDL-ja edhe në shkollat e Republikës së Kosovës.

Rekomandimet kryesore

Bazuar në gjetjet e studimit (të pasqyruara në raport) mund të nxirren këto **rekomandime**:

- **MASHT-i** të vazhdojë me trajnimin e të gjithë mësimdhënësve të arsimit parauniversitar në Kosovë për programin e ECDL-së, si dhe të monitorojë punën e mësimdhënësve të certifikuar për ECDL-në; të hartojë një platformë të përbashkët me ekspertë të fushës së TIK-ut dhe ekspertë për hartimin e planeve dhe programeve mësimore, teksteve mësimore dhe materialeve ndihmëse, me theks në integrimin e moduleve të ECDL-së në shkolla; të krijojë një mekanizëm ligjor për njohje të vlefshmërinë së certifikatave të programit të ECDL-së në sistemin e pikëzimit për regjistrim në

klasën e 10-të të shkollës së mesme të lartë dhe për regjistrim në Universitet.

- **DKA-të** të vendosin një sistem funksional të mbikëqyrjes së pajisjeve të TIK-ut në shkolla; të mbështesin shkollat me sistem funksional të rrjetit të internetit; të hartojnë një platformë të përbashkët me partnerë dhe shkolla për të krijuar portalin e ECDL-së për shfrytëzim të burimeve dhe materialeve për procesin mësimor; t'i japin prioritet zhvillimit profesional të mësimeve dhe drejtorëve të shkollave në fushën e TIK-ut.
- **Shkollat** të angazhohen në ngritje të kapaciteteve në shkollë për përdorimin e TIK-ut në procesin mësimor; të shfrytëzojnë një pjesë të autonomisë së shkollës për të integruar ECDL-në në shkollë; të përfshijnë iniciativa me kosto konkrete për TIK-un në planet zhvillimore të shkollave të tyre; të ndërtojnë partneritete me komunitetin për TIK-un; të vendosin në prioritet të shkollës ngritjen e kompetencave të nxënësve në përdorimin e kompjuterit.

I. HYRJJE

Ky raport paraqet rezultatet e studimit “*ECDL - mundësi e përfitimit dhe e certifikimit të kompetencave për TIK-un*”. Realizimi i këtij studimi është mbështetur nga Fondacioni ECDL Kosova dhe ka për objektive analizën dhe identifikimin e përvojave ndërkombëtare për integrimin e ECDL-së në kurrikula të arsimit parauniversitar, analizën dhe krahasimin e programeve ekzistuese të TIK-ut në Kosovë, si dhe evidentimin e kompetencave aktuale të nxënësve për përdorimin e kompjuterit.

Fokus kryesor i studimit janë kompetencat e nxënësve për përdorimin e kompjuterit. Deri më tani nuk ka pasur studime në shkallë vendi që reflektojnë analizën e programeve të TIK-ut dhe mundësive që ofrojnë programet dhe procesi i mësimdhënies dhe nxënies për zhvillimin e kompetencave të nxënësve për përdorimin e kompjuterit. Prandaj, studimi sjell të dhëna mjaft të rëndësishme mbi këto aspekte dhe mund të shërbejnë për procesin e hartimit të kurrikulave, për fusha kurrikulare dhe për programe lëndore.

1.1 Konteksti i studimit

Instituti Pedagogjik i Kosovës është institucion kërkimor-shkencor publik që merret me hulumtime, trajnime, vlerësime dhe inovacione në fushën e arsimit. Misioni i Institutit Pedagogjik të Kosovës është që t’i ofrojë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe institucioneve të tjera arsimore mbështetje dhe ekspertizë shkencore e profesionale të mbështetur në rezultatet e punës hulumtuese-kërkimore dhe në praktika të avancuara.

Fondacionit ECDL në Kosovë është i autorizuar nga Fondacioni i ECDL-së si autoritet nacional certifikues për certifikimin e njohurive dhe shkathtësive digjitale të individëve në territorin e Republikës së Kosovës.

Prandaj, në përputhje me misionin e IPK-së dhe me mbështetje nga ECDL Kosova është iniciuar projekti i studimit kërkimor “ECDL - mundësi e përfitimit dhe certifikimit të kompetencave për TIK-un”, me fokus kompetencat e nxënësve për përdorimin e kompjuterit.

1.2. Konteksti i zhvillimit të politikave arsimore në fushën e TIK-ut dhe ndërlidhja me ECDL-në

Sistemi arsimor i Kosovës është në fazë të rëndësishme të reformimit, në përpjekje për të modernizuar, avancuar dhe arritur trendet bashkëkohore të arsimit. Digjitalizimi i shkollave dhe ngritja e kapaciteteve për përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit në mësimdhënie dhe nxënie është një nga objektivat e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, e artikuluar në Strategjinë për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2007-2017 dhe *tani në Planin Strategjik të Sektorit të Arsimit në Kosovë 2011-2016*.

Korniza e Kurrikulës së Kosovës promovon integrimin e lëndëve mësimore në fusha kurrikulare dhe promovon qasjen e bazuar në kompetenca. Në kuadër të fushës kurrikulare ***Jeta dhe Puna*** është e integruar edhe lënda e TIK-ut, e cila në masën më të lartë integron aspektet kryesore të ECDL-së. Pra, integrimi i lëndëve mësimore në fusha kurrikulare dhe qasja e bazuar në kompetenca janë synimet kryesore të kurrikulës së re, që reflektojnë edhe mundësinë e integrimit të ECDL-së në kurrikula të reja për klasë dhe fusha kurrikulare, të cilat pritet të hartohen gjatë vitit 2011/2012 dhe pritet të pilotohen me qëllim të validimit të tyre/ matjes së vlefshmërisë së tre.

Me qëllim të ***ngritjes së kapaciteteve të mësimdhënësve*** për përdorimin e kompjuterit në procesin e mësimdhënies dhe nxënies, që nga viti 2009 MASHT-i ka kontraktuar Universitetin Amerikan të Kosovës (AUK) për përgatitjen profesionale të mësimdhënësve për programin e trajnimit *Patenta Evropiane për përdorimin e kompjuterit* (ECDL), e cila njihet si standard ndërkombëtar për aftësitë kompjuterike, duke u

ofruar atyre certifikim të njohur ndërkombëtarisht dhe të pranuar nga qeveritë, shoqëritë kompjuterike, organizatat ndërkombëtare. Programi i trajnimit të mësimdhënësve për programin e ECDL-së është i shtrirë në gjithë Kosovën, me mundësi të përfitimit nga të gjithë mësimdhënësit të angazhuar në arsimin parauniversitar të Kosovës. Deri më tani, këtë program të trajnimit e kanë vijuar përafërsisht 10000 mësimdhënës të komunave të ndryshme të Kosovës. Trajnimi në këtë fazë i mësimdhënësve për programin e ECDL-së është me interes të veçantë, për faktin se është në proces me zhvillimin e KKK-së dhe integrimi i përmbajtjeve të programit të ECDL-së në kurrikula të fusha mësimore/lëndëve mësimore shihet si një mundësi dhe njëkohësisht si një sfidë.

II. KORNIZA KONCEPTUALE

Për qëllimet e studimit “*ECDL - mundësi e përfitimit dhe e certifikimit të kompetencave për TIK-un*”, ekipi hulumtues i Institutit Pedagogjik të Kosovës ka analizuar kornizën konceptuale të lidhur ngushtë me temën e studimit kërkimor dhe me qëllim që të pasqyrojë një kuptim më të qartë të informacioneve nga fusha e studimit, ka përzgjedhur dhe ka përfshirë në raport një pjesë të tyre. Aspektet që përfshihen në kornizën konceptuale janë pjesë e dokumenteve zyrtare të MASHT-it në Kosovë dhe e publikimeve të Fondacionit të ECDL-së, si dhe e hulumtimeve në fushën e studimit.

2.1. Kompetencat

Në lidhje me kompetencat ekzistojnë përkufizime të ndryshme. Shumica e autorëve me kompetenca nënkuptojnë tërësinë e njohurive, aftësive, shkathtësive, shprehive, qëndrimeve dhe vlerave të nevojshme që i përmbush dhe i shfaq një individ për një fushë/lëndë të caktuar në një periudhë të caktuar kohore për të kryer me efektivitet dhe përgjegjësi një aktivitet të caktuar.

Konceptit të kompetencave në këtë studim iu kemi referuar sipas Kornizës së Kurrikulës së Kosovës (2011). Sipas KKK-së, kompetencat përfshijnë një sistem të integruar dhe koherent të dijeve, të shkathtësive dhe të qëndrimeve të aplikueshme dhe të transferueshme, të cilat do t'u ndihmojnë nxënësve që të ballafaqohen me sfidat e epokës digjitale, të ekonomisë së tregut të lirë dhe të bazuar në dije, në një botë të marrëdhënieve të ndërvarura. Kompetencat për TIK në këtë studim kuptohen shkathtësitë e përdorimit të kompjuterit.

2.2. Rezultatet mësimore

Edhe për rezultatet mësimore kemi qasje të ndryshme të paraqitjes dhe përkufizimit të tyre, varësisht nga kontekstualizimi i tyre, si rezultate të pritura, rezultate të përmbajtjes, rezultate të të nxënësve etj. Në këtë studim, fokusi i rezultateve mësimore vihet në rezultatet e pritura në planet dhe programet e TIK-ut, të cilat janë artikulum i kompetencave që duhet të arrijnë nxënësit në fund të klasave të caktuara nga programi i TIK-ut.

2.3. Fusha e kurrikulës Jeta dhe puna

Ekzistojnë dallime ndërmjet vendeve të ndryshme në lidhje me organizimin e lëndëve mësimore në fusha të ndryshme kurrikulare. Në këtë studim, për bazë kemi fushat e kurrikulës, të përcaktuara me Kornizën e Kurrikulës së Kosovës (2011). Sipas KKK-së, fushat e Kurrikulës përbëjnë bazën për organizimin e procesit edukativo-arsimor në shkollë, në nivele dhe shkallë përkatëse të Kurrikulës. Fushat mësimore përfshijnë një ose disa lëndë apo module mësimore.

Jeta dhe puna është fushë e Kurrikulës, në të cilën përfshihen këto lëndë dhe module mësimore: Shkathtësitë për jetë, Punë dore dhe Ekonomi shtëpiake, Këshillimi dhe orientimi në karrierë, Teknologji dhe TIK-un, Edukimi për punë dhe ndërmarrësi. Qëllimi kryesor i të

nxënit në fushën *Jeta dhe puna* është që të aftësojë nxënësit të jenë të informuar, të shkathtë, mendimtarë, ndërmarrës².

2.4. Plani dhe programi mësimor Teknologji me TIK-un

Konceptet *Plan dhe Program mësimor, Kurrikulë lëndore* etj., janë koncepte që përfaqësojnë afërsisht të njëjtën gjë, me dallime fare të vogla. Por, meqenëse në dokumentet tona zyrtare akoma përdoret koncepti *Plan dhe Program mësimor*, edhe ne në kontekstin e studimit tonë e kemi përdorur këtë koncept.

Në kornizën e planeve dhe programeve mësimore aktuale lënda mësimore *Teknologjia*, duke përfshirë edhe TIK-un, zë një vend mjaft të rëndësishëm. Pjesë të programit të TIK-ut dhe të fondit të orëve për TIK-un përfshihen në programet mësimore nga klasa e 6-të e shkollës së mesme të ulët deri në klasën e 12/13-të të shkollës së mesme të lartë³. Rezultatet e pritura mësimore janë pjesë e programit mësimor të lëndës Teknologji me TIK dhe shërbejnë, përveç tjerash, edhe për vlerësimin e kompetencave të nxënësve në TIK.

2.5. Patenta Evropiane për Përdorimin e Kompjuterit – ECDL

Koncepti i ECDL-së është i njëjtë në të gjitha vendet që janë pjesë e Fondacionit të ECDL-së dhe që kanë mandat të Autoritetit Nacional Certifikues.

ECDL-ja është kualifikim i pranuar ndërkombëtarisht, i cili u mundëson individëve të vërtetojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre kompjuterike. Kandidatët që përfundojnë me sukses provimet e programit të ECDL-së pajisen me certifikatë të njohur ndërkombëtarisht.

² Korniza e Kurrikulës së Kosovës 2010

³ Më gjerësisht për përmbajtjen e programit të TIK-ut, sipas klasave, do të kemi informacione në kapitullin: Analiza e programeve ekzistuese të TIK-ut në arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9) dhe arsimin e mesëm të lartë (klasat 10-12/13)

Programi për ECDL-në Core është një program që konsiston në shtatë module, të cilat e mbulojnë pjesën teorike dhe praktike të aftësive kompjuterike. Modulet e programit të ECDL-së janë: Windows XP, Word, Exel, Access, Outlook & Internet Explorer, Bazat e Teknologjisë Informative. Të gjitha këto module gjejnë aplikim edhe në sistemin e arsimit, pra edhe në mësimdhënie dhe nxënie. Në trendët ndërkombëtarë, për t'u certifikuar për programin e ECDL-së, një kandidat duhet brenda që tre vjetësh të kalojë me sukses testet për shtatë modulet e këtij programi⁴.

III. METODOLOGJIA E STUDIMIT

3.1. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i përgjithshëm studimit “*ECDL - mundësi e përfitimit dhe e certifikimit të kompetencave për TIK-ut*” është të kontribuojë në promovimin e vlerave të ECDL-së për integrim në epokën digjitale në kontekst të zhvillimeve në fushat kurrikulare të arsimit në Kosovë.

Materializimi i kontributit të studimit bëhet përmes ofrimit të mbështetjes dhe ekspertizës profesionale, procesit të rishikimit të Kurrikulës në Kosovë, përmes analizës së programeve të TIK-ut, evidentimit të kompetencave të nxënësve për përdorimin e kompjuterit dhe përvojave të avancuara në fushën e TIK-ut, në mënyrë që ato:

- Të tregojnë se ku janë përparësitë dhe mangësitë e programeve të TIK-ut;
- Të tregojnë cili është niveli i kompetencave të nxënësve për përdorimin e kompjuterit;
- Të japin orientime të qarta dhe të mbështetura në përvoja të mira për mundësitë e integritit të ECDL-së në kurrikula

⁴ Më gjerësisht për Fondacionin ECDL, programin dhe modulet e ECDL-së, shih kapitullin: Patenta evropiane për përdorimin e kompjuterit – ECDL.

mësimore, që sigurojnë nivel të lartë të kompetencave të nxënësve për përdorimin e kompjuterit.

3.2. Strategjitë e përdorura

Studimi është i bazuar në metodologjinë hulumtuese kuantitative dhe kualitative. Dy janë strategjitë kryesore të përdorura në këtë studim:

- studimi kabinetik dhe
- studimi në terren.

3.2.1. Studimi kabinetik

Studimi kabinetik prezanton një pamje të plotë mbi konceptin e kompetencave për teknologjinë informative, mbi zhvillimet e Fondacionit ECDL-së, veçanërisht mbi përvojat e integritit të ECDL-së në shkollat e Zvicrës dhe Austrisë. Gjithashtu, studimi kabinetik prezanton një pamje të plotë mbi përmbajtjen e TIK-ut në planet dhe programet mësimore të arsimit në Kosovë, nga klasa 6-të deri në klasat 12/13-të të arsimit parauniversitar, teksteve shkollore të teknologjisë së informimit dhe komunikimit dhe rezultatet e nxënësve në vlerësimet e jashtme, në Testin e arritshmërisë dhe Provimin e maturës.

Pra, hulumtimi kabinetik mbulon tri fusha tematike:

- Analiza e kontekstit dhe zhvillimeve të integritit të ECDL-së në shkolla;
- Analiza e programeve ekzistuese të TIK-ut në arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9) dhe arsimin e mesëm të lartë (klasat 10-12/13);
- Politikat arsimore në lidhje me kontekstin e adresimit të teknologjisë së informimit dhe komunikimit.

3.2.2. Studimi në terren

Hulumtimi në terren është qasja kualitative që ofroi informacione relevante lidhur me objektivat e studimit, në mënyrë të veçantë për nivelin e kompetencave të nxënësve për përdorimin e kompjuterit. Gjithashtu, kjo qasje mundësoi edhe diskutimin me grupet e interesit për mundësitë e integritit të moduleve të ECDL-së në kurrikulat lëndore të TIK-ut dhe në fusha të tjera mësimore, si dhe për pengesat në këtë proces.

Hulumtimi në terren përfshin katër fusha:

- Analizën për kompetencat e nxënësve për përdorimin e kompjuterit – hulumtimi me pyetësor;
- Vlerësimin për kompetencat e nxënësve për përdorimin e kompjuterit – vlerësimi me teste të standardizuara të ECDL-së;
- Analizën e mundësive për integrimi e moduleve të ECDL-së në kurrikulat lëndore të TIK-ut dhe në fusha të tjera mësimore – punëtori me grupe të interesit dhe vizita studimore.

3.3. Popullacioni dhe mostra

Popullacionin në studim e përbëjnë:

- Nxënësit e klasës së 10-të dhe të klasës së 12-të të gjimnazeve dhe shkollave profesionale, si dhe nxënësit që në vitin paraprak e kanë përfunduar maturën dhe kanë qenë në proces të regjistrimit në Universitet;
- Grupet e interesit me përfaqësues të hartuesve të programeve të TIK-ut dhe mësimdhënës të TIK-ut në shkollat e mesme të ulëta dhe të larta në Kosovë.

Madhësia e mostrës me nxënës: Mostra e nxënësve përbëhet prej 108 nxënësve të katër shkollave të mesme të larta (dy gjimnaze dhe dy shkolla profesionale – ekonomike):

- Mostra e gjimnazeve - 63 nxënës, prej tyre 37 nxënës të klasës së 10-të dhe 26 nxënës të klasës së 12-të;
- Mostra e shkollave profesionale ekonomike - 45 nxënës, prej tyre 23 nxënës të klasës së 10-të dhe 22 nxënës të klasës së 12-të.

Tipi i shkollës:	Emri i shkollës	Klasa			
		Drejtimi	X	XII	Gjith:
Gjimnaz	Sami Frashëri	Mat-informatikë	11	5	16
		Shoqëror	12	8	20
	Ulpiana	Natyror	8	8	16
		Shoqëror	6	5	11
Shkollë profesionale	Hoxhë Kadri Prishtina	Ekonomi	12	12	24
	Adem Gllavica	Ekonomi	11	10	21
Gjithsej:			60	48	108

Tabela 1. Shpërndarja e mostrës së nxënësve sipas variabëlilit të tipit të shkollave, drejtimeve dhe klasave

Vendbanimi	Nr:	%
Fshat	58	54 %
Qytet	50	46 %
Gjithsej:	108	100

Tabela 2. Shpërndarja e nxënësve sipas variabëlilit të vendbanimit fshat - qytet

Përcaktimi i shkollave për këtë studim është bërë mbi bazën e katër kritereve:

1. Të gjitha shkollat e përfshira të kenë status publik;
2. Të përfshihen dy shkolla të kryeqytetit dhe dy shkolla nga një qendër e vogël komunale;
3. Të përfshihen gjimnazet me drejtime të përziera dhe shkollat profesionale që kanë drejtime ekonomike;
4. Të përfshihen drejtimet e njëjta si në klasën e 10-të ashtu edhe në klasën e 12-të.

Mbi këto kritere janë përzgjedhur gjimnazet dhe shkollat profesionale nga komuna e Prishtinës dhe komuna e Lipjanit.

Ndërsa, selektimi i nxënësve është bërë krejt rastësor, duke pasur për bazë radhitjen e librit të parë të klasës dhe librit të mesëm në raftet e shkollës, duke filluar me numrin 2 të nxënësit në ditar dhe vazhduar pastaj me çdo të gjashtin nxënës me radhë.

Çfarë kemi synuar me mostrën e nxënës të klasës së 10-të dhe klasës së 12-të?

Studimi me nxënës është kryer në gjysmën e dytë të muajit shtator 2011. Me mostrën e nxënësve kemi synuar të evidentojmë ndikimet e programit mësimor të TIK-ut nga shkolla e mesme e ulët, përkatësisht nga klasa e 9-të në ngritjen e kompetencave të nxënësve për përdorim të kompjuterit. Kurse, me mostrën e nxënësve të klasës së 12-të kemi synuar të evidentojmë ndikimin e programit të klasës së 10-të dhe klasës së 11-të në ngritjen e kompetencave të nxënësve për përdorimin e kompjuterit.

Është përzgjedhur një mostër solide e nxënësve për përfshirje në anketim, meqenëse me të njëjtën mostër është planifikuar edhe realizimi i testit të standardizuar të ECDL-së dhe sigurisht që ndikim për mospërfshirje më të gjerë kanë pasur edhe rrethanat e limituara financiare.

Mostra e dytë e përfshirë në studim përbëhet nga nxënësit që e kanë përfunduar maturën në vitin paraprak akademik/ kandidatë për regjistrim në Universitetin e Prishtinës: *Fakultetin Filozofik, Fakultetin e Edukimit dhe Fakultetin Juridik - Ekonomik*⁵.

⁵ Intervistimi i kandidatëve në Fakultetin Juridik dhe Fakultetin Ekonomik është bërë në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend, pra kandidatët e intervistuar përfaqësojnë të dy fakultetet. Selektimi i fakulteteve për përzgjedhjen e kandidatëve nuk është bërë me ndonjë kriter të veçantë.

Fakulteti	Gjinia		
	F	M	Gjithsej
I Edukimit	22	13	35
Ekonomik dhe Juridik	15	18	33
Fakulteti Filozofik	12	20	32
Gjithsej:	49	51	100

Tabela 3. Shpërndarja e nxënësve kandidatë për studentë sipas variabël të fakultetit ku janë anketuar dhe gjinisë.

Koha e anketimit të kandidatëve me pyetësorë të anketës ka qenë e limituar dhe kemi përzgjedhur zonën ku më së shumti ka pasur frekuentim të studentëve në ditën e dytë dhe të tretë të paraqitjes së dokumentacionit për regjistrim në fakultet.

Selektimi i mostrës së dytë për përfshirje në anketim është bërë krejt rastësor, duke kërkuar nga çdo i treti nxënës/student që ka kaluar pranë intervistuesit të plotësojë pyetësorin e përgatitur për shkathtësitë e përdorimit të kompjuterit dhe duke u respektuar gatishmëria e tyre për të plotësuar atë.

Çfarë kemi synuar me mostrën e nxënësve kandidatë për studentë?

Studimi me nxënësit/studentët është kryer në fillim të muajit korrik 2011. Me mostrën e nxënësve/ kandidatë për studentë kemi synuar të evidentojmë ndikimin e programit mësimor të TIK-ut në përfundim të shkollës së mesme të lartë (gjimnaze ose shkolla profesionale) në ngritjen e kompetencave të tyre për përdorimin e kompjuterit. Edhe madhësinë e kësaj mostre e ka përcaktuar përfshirja në testin e standardizuar për programin e ECDL-së⁶.

⁶ Të gjitha shpenzimet financiare të testimit të nxënësve kandidatë për studentë me testin e standardizuar të ECDL-së janë mbuluar nga Fondacioni ECDL Kosova.

3.4. Realizimi i hulumtimit

3.4.1. *Si kemi vepruar në realizimin e hulumtimit përmes teknikës së anketimit?*

Hulumtimi në shkollë: Në çdo shkollë të përzgjedhur për realizim të studimit ekipi hulumtues fillimisht i ka kontaktuar drejtuesit e shkollës, me qëllim të prezantimit të qëllimit të studimit. Kjo ka qenë fazë me rëndësi dhe vlen të potencohet se në katër shkollat e përfshira në studim kemi pasur përkrahje për të ecur më tutje me planin e studimit. Pastaj, me ndihmën e drejtuesve të shkollave dhe në bazë të kriterëve të përcaktuara për përzgjedhjen e mostrës së nxënësve kemi bërë përzgjedhjen e nxënësve për anketim, kemi gjetur hapësirat/ klasat e lira për realizim të anketës, dhe pas udhëzimeve të dhëna për nxënës është bërë anketimi i tyre me pyetësorë, si dhe janë njoftuar për datën e përfshirjes në testin e standardizuar të ECDL-së.

Hulumtimi në fakultete: Është bërë në ditën e dytë dhe të tretë të paraqitjes së dokumenteve për regjistrim në Universitet. Ekipi hulumtues, në secilin prej fakulteteve të përzgjedhur ka gjetur një hapësirë ku nxënësit/kandidatë për t'u regjistruan në Universitet kanë pasur mundësi të plotësojnë pyetësorin e hulumtimit dhe të përcaktohen për testim në testin e standardizuar të ECDL-së. Kandidatët që kanë shprehur gatishmëri për t'u përfshirë në këtë test e kanë dhënë adresën e tyre për të kontaktuar dhe më vonë janë ftuar për testim.

3.4.2. *Si kemi vepruar në realizimin e testimit me testin e standardizuar të ECDL-së?*

Pasi kemi siguruar përkrahjen e plotë financiare dhe teknike nga Fondacioni i ECDL Kosovës, koordinatoret e projektit kanë përgatitur planin dinamik të realizimit të testimit, pastaj i kemi njoftuar drejtoritë e shkollave dhe nxënësit për qendrat dhe kohën e testimit. Gjithashtu, e kemi caktuar edhe ekipin e hulumtuesve nga Instituti Pedagogjik i

Kosovës për monitorimin e procesit të testimit, për çdo qendër të testimit nga një anëtar.

Testimi me nxënësit e klasës së 10-të dhe të 12-të është mbajtur në të njëjtën ditë dhe është organizuar në dy qendra të testimit të certifikuara nga ECDL-ja: në Qendrën e Universitetit Amerikan- AUK dhe në qendrën e SBASHK-ut, në SHMT “Shtjefen Gjeqovi” në Prishtinë.

Përzgjedhja e moduleve është bazuar në analizën e programeve mësimore që nxënësit i kanë zhvilluar në klasat paraprake, me qëllim që të matim ndikimin e tyre në përgatitjen e nxënësve me kompetenca të duhura për përdorimin e kompjuterit.

Nxënësit e klasës së 10-të janë përfshirë në testin e tri moduleve të ECDL-së:

- Moduli 2 - Shfrytëzimi i kompjuterit dhe menaxhimi i fajllave (Word);
- Moduli 3 - Përpunimi i teksteve (Windows XP);
- Moduli 7- Interneti dhe komunikimi (Internet Explorer & Outlook).

Nxënësit e klasës së 12-të janë përfshirë në testin e dy moduleve të ECDL-së:

- Moduli 4 - Kalkulimi i tabelave (Excel);
- Moduli 6 - Prezantimet (PowerPoint).

Për dallim prej testimit të të nxënësve të klasës së 10-të dhe të 12-të testimi i nxënësve kandidatë për regjistrim në Universitetin e Prishtinës është bërë për të shtatë modulet brenda dy ditësh dhe është organizuar në gjashtë qendra të Kosovës, të certifikuara për organizimin e testeve për ECDL-në: Prishtinë (dy qendra), Ferizaj Vushtrri, Mitrovicë dhe Pejë. Qendrat janë përzgjedhur në bazë të numrit të kandidatëve që kanë shprehur gatishmëri për t’u përfshirë në testin e standardizuar të ECDL-së.

Grupi i nxënësve kandidatë për studentë kanë pasur mundësi të marrin pjesë në të gjitha modulet e ECDL-së:

- Moduli 1 - Bazat e teknologjisë së informimit dhe komunikimit (ICT);
- Moduli 2 - Shfrytëzimi i kompjuterit dhe menaxhimi i fajllave (Windows XP);
- Moduli 3 - Përpunimi i teksteve (Word);
- Moduli 4 - Kalkulimi i tabelave (Excel);
- Moduli 5 - Baza e të dhënave (Access);
- Moduli 6 - Prezantimet (PowerPoint);
- Moduli 7- Interneti dhe komunikimi (Internet Explorer & Outlook)

Në të gjitha qendrat ku është organizuar testimi i nxënësve janë respektuar procedurat dhe standardet e sigurimit të cilësisë, të aprovuara nga Fondacioni ECDL.

3.4.3. Punëtorja me fokus-grupe

Takimet me fokus-grupe që lidhen drejtpërdrejt me procesin e hartimit të programeve të TIK-ut dhe me mësimdhënës që janë pjesë e procesit të mësimdhënies dhe nxënies ishin pjesë e aktiviteteve të projektit, me qëllim të veçantë për të diskutuar dhe analizuar *kompetencat e nxënësve për TIK-un dhe rëndësinë e integrimit të ECDL-së në shkolla*.

Punëtorja me fokus-grupe është ndarë në dy grupe. Njëri grup ka diskutuar dhe analizuar *kompetencat e nxënësve për TIK-un dhe rëndësia e integrimit të ECDL-së në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, kurse grupi tjetër për temën e njëjtë, por për arsimin e mesëm të lartë - gjimnaze dhe shkolla profesionale*.

Rezultatet e punëtorisë me fokus-grupe janë integruar në kapitullin VIII të këtij raporti.

IV. MODELE TË AVANCUARA NGA VENDET EVROPIANE PËR INTEGRIMIN E ECDL-SË NË SHKOLLA

4.1. Çfarë nënkuptohet me kompetencat për teknologjinë informative?

Kompetencat për përdorimin e teknologjisë informative në përgjithësi, njohja dhe përdorimi i pavarur dhe efikas i programeve aplikative kompjuterike në veçanti, gjithnjë e më shumë, po fitojnë rol dhe rëndësi në jetën e përditshme dhe në angazhimin profesional të individëve.

Me “*mediat e reja*”, që zakonisht nënkuptohet interneti dhe kompjuteri, CD-ROM dhe multimedia, njëkohësisht është e përdorur edhe shprehja “*kompetenca për mediat*”. Për të pasur të qartë se çka kuptojmë me konceptin *kompetenca për teknologjinë informative*, në vazhdim po japim disa nga definicionet bazë lidhur me fushën.

Që nga viti 1990 vërehet një zëvendësim i shpejtë i fjalës *kualifikim* me fjalën *kompetencë*. Fjala *kompetencë*, varësisht nga konteksti i përdorimit të saj, ka kuptime të ndryshme: Në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe kuptimi i ngushtë i fjalës *kompetencë* tregon *njohuri të thella e të përpikta që ka dikush në një fushë të dijes, etj.* - *aftësi*⁷. Ndërsa, fjala *kualifikim* në kuptimin e ngushtë të saj nënkupton *shkallën e njohurive a përgatitjes së dikujt në një fushë të caktuar të prodhimit, të shkencës, etj.*⁸ dhe mbi bazën e kësaj, emërtimi *kompetent-e* jepet për dikë *që është i aftë, i përgatitur mirë, që ka kompetencë*⁹. Përdorimi i shprehjes *kualifikim* ndërlihd shumë ngushtë kërkesën për zgjidhjen e një situatë të caktuar (aktivitetit) me mundësitë profesionale të individit për t’u ballafaquar me atë situatë. Ndërsa,

⁷ Akademia e Shkencës e Shqipërisë: Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, “Toena”, Tiranë, 2002, f. 595

⁸ Po aty, f. 623

⁹ Po aty, f. 595

kompetenca është më pak e ndërlidhur me mundësitë profesionale të individit, por me një prirje të përgjithshme të tij për mbizotërim të kërkesave jetësore në përgjithësi . Gjithashtu , të kuptuarit e *kompetencës* ndryshon në raport me *shkathtësinë*, meqenëse shkathtësitë shihen si pjesë përbërëse të kompetencave, së bashku me njohuritë, vlerat dhe qëndrimet (ashtu edhe veprimet rutinore, modelet e të menduarit, sjelljet)¹⁰.

Sipas Dieter Baacke, studiues i shkencave edukative dhe profesor në Universitetin e Bielfeldit në Gjermani, me kompetenca për media nënkuptojmë “aftësinë e përdorimit të mediave dhe përmbajtjes së tyre në përputhshmëri me qëllimet dhe nevojat e individit¹¹”. Ai, gjithashtu, ofron një ndarje të funksionit të mediave, si: Didaktika e mediave (Mediendidaktik), që nënkupton përdorimin e mediave në funksion të arritjes së qëllimeve arsimore; Arsimimi për mediat (Medienerziehung), që nënkupton edukimin për përdorimin e mediave, sidomos për edukimin e moshave të reja për përdorim të drejtë të mediave; Përdorimi i mediave (Medienkunde), që ofron njohuri për funksionin e medias në lidhje me aspektet ligjore, ekonomike, politike, sociale të një vendi; Pedagogjia e mediave (Medienpädagogik), që nënkupton konceptin bazë për përdorimin e mediave në të gjitha veprimet socio-pedagogjike dhe socio - kulturore nga të gjitha grup-moshat, në funksion të plotësimit të kohës së lirë, plotësimit të nevojave rreth vendit të punës dhe familjes dhe pjesëmarrjes aktive në jetën shoqërore¹².

Sipas Gerhard Tulodzieckit, profesor i shkencave edukative në Universitetin e Paterbornit, me kompetencat për mediat nënkuptojmë “aftësitë dhe gatishmërinë e duhur, kreativitetin, vetë-orientimin dhe

¹⁰ MASHT: Korniza e Kurrikulimit (drafti i dytë), Prishtinë 2010, f. 71

¹¹Dieter Baacke: Medienkompetenz, www.wikipedia.org/wiki/Medienkompetenz
(shkarkuar më: 20.07.2011)

¹² Po aty

përgjegjësinë shoqërore të individit për veprim në një botë të udhëhequr nga mediat”¹³.

4.2. Patenta Evropiane për përdorimin e kompjuterit - ECDL (European Computer Driving Licence)

ECDL (jashtë Evropës njihet si ICDL) është kualifikim i pranuar ndërkombëtarisht, i cili u mundëson individëve të vërtetojnë dituritë dhe aftësitë e tyre bazë për përdorimin e kompjuterit. ECDL/ICDL përmban 7 module, në të cilat definohen njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për përdorim kompetent të kompjuterit dhe aplikacioneve të zakonshme kompjuterike. Në mënyrë që të arrihet certifikimi i ECDL/ICDL, individualisht duhet të kalohet testi për secilin nga 7 modulet (testet janë modulare dhe mund të përfundohen sipas radhës së dëshiruar):

- Moduli 1 - Bazat e teknologjisë së informimit dhe komunikimit (ICT);
- Moduli 2 - Shfrytëzimi i kompjuterit dhe menaxhimi i fajllave (Word);
- Moduli 3 - Përpunimi i teksteve (Windows XP);
- Moduli 4 - Kalkulimi i tabelave (Excel);
- Moduli 5 - Baza e të dhënave (Access);
- Moduli 6 - Prezantimet (PowerPoint);
- Moduli 7- Interneti dhe komunikimi (Internet Explorer & Outlook)¹⁴.

¹³ Gerhard Tulodziecki: was Schülerin und Schüler im Medienbereich wissen und können sollen – Kompetenzmodell und Bildungsstandards für die Medienbildung, Universität Paderborn, 2006. fq.24,

www.dimel-uni-paderborn.de (shkarkuar më 20.07.2011)

¹⁴ Për informacion të plotë për përmbajtjen e moduleve shih shtojcën 1: Modulet e ECDL-së

Moduli 1 është test teorik i njohurive informatike në nivel të përgjithshëm, ndërsa modulet 2-7 janë kryesisht teste të aftësive praktike. Përfituesit së pari pajisen me *Skills Card* - dokument personal, ku janë të bartura të gjitha shënimet e nevojshme të përfituesit, dhe më vonë plotësohet me modulet e përfunduara nga kandidati. Aftësimi për programin e ECDL-së mund të realizohet përmes vijimit të kursit përgatitor për këtë program, apo përmes studimit të pavarur të kandidatit (p.sh. përmes e-learning). Individët që kanë arritur certifikimin në ECDL/ICDL mund të demonstrojnë kompetencat e tyre në mënyrë të suksesshme në shfrytëzim të kompjuterit dhe aplikacioneve të tij. Varësisht nga modulet e programit të kaluara nga kandidati ofrohen edhe certifikata përkatëse. Certifikatat më të njohura për përfitim nga programi ECDL janë¹⁵:

- *ECDL Start* – përbëhet nga katër module, të cilat mund të realizohen së bashku ose ndaras:
 - ✓ Word;
 - ✓ PowerPoint;
 - ✓ Excel;
 - ✓ Internet Explorer & Outlook.
- *ECDL Core* - dëshmon njohuritë dhe aftësitë praktike për përdorimin e kompjuterit. Për përfitimin e certifikatës është e nevojshme që brenda tre vjetëve të kalohen me sukses testimet në të gjitha modulet:
 - ✓ Bazat e informatikës;
 - ✓ Windows XP;
 - ✓ Word;
 - ✓ Excel;
 - ✓ Access;
 - ✓ PowerPoint;

¹⁵ Institut für wirtschaftsinformatik IwI: Qualität und Nutzen der ICT-Anwender – Zertifikate in der Schweiz, (informacion i shpërndarë në fq.12 dhe 13), Luzern, 2010

- ✓ Internet Explorer & Outlook.
- *ECDL Advanced* – përmban katër module të ndërtuara mbi bazën e *ECDL Core*. Certifikimi i njohurive dhe aftësive mund të bëhet mbi bazën e modulit përkatës, apo njëherazi për të gjitha modulet:
 - ✓ Word - nivel i avancuar;
 - ✓ Excel - nivel i avancuar;
 - ✓ Access - nivel i avancuar;
 - ✓ PowerPoint – nivel i avancuar.
- *ECDL Expert* - dëshmon realizimin e katër moduleve në nivel të avancuar (*ECDL Advanced*) nga kandidati dhe e titullon atë përdorues të nivelit ekspert.
- *ECDL eKids* - ku përmes lojës vlerësohen aftësitë bazë të përdoruesve të rinj(në moshë) të kompjuterit.

Një paraqitje grafike të shkallëzimit të moduleve në nivele të përfuturimit e kemi paraqitur në tabelën 1.




Fig.1.Mdulet e ECDL -së dhe lojet e çertifikimit

Qëllimi i programit të ECDL-së:

- Zhvillimi i kompetencave për përdorim të kompjuterit dhe motivimi i secilit individ për përfitimin e tyre;
- Ngritja e shkallës së informimit për Teknologjinë Informative (IT);
- Informimi për përparësitë e përdorimit (të drejtë) të kompjuterit;
- Rritja e produktivitetit të të gjithë punonjësve, puna e të cilëve lidhet drejtpërdrejt me PC-në;
- Përmirësimi i investimeve në fushën e Teknologjisë Informative;
- Ofrimi i kualifikimit bazë për të gjithë.

4.2.1. Karakteristikat kryesore të programit të ECDL -së

Përmbajtjet e programit të ECDL-së rregullisht azhurnohen nga ekspertë të 148 vendeve të ndryshme të botës. Kjo përmbajtje është e hartuar në atë formë që i jep mundësi realizimit përmes disa programeve softurike. Përfituesi ka mundësi që para nënshtrimit të testimit /vlerësimit të tij për këtë program të përcaktohet për realizimin e testimit në programet Apple, Microsoft apo Open. Karakteristika të programit të ECDL-së janë edhe:

- *Internacionaliteti*: 148 vende kanë adaptuar këtë program, testimi certifikues mund të realizohet në 41 gjuhë botërore;
- *Ndërlidhja mes shkencës dhe industrisë*: Programi ndërlidh kompetencat akademike dhe praktike (vepruese) dhe mbështetet nga shoqata të ndryshme profesionale;
- *Pavarësia teknologjike*: Programi i ECDL-së përcakton aftësitë për Teknologjinë Informative, pavarësisht nga prodhuesi/firma e Hard - dhe softuerë.

Përparësitë e ECDL-së:

- Njohuri dhe aftësi për TI-së për të gjithë;
- Metodë inovative dhe praktike për matjen dhe vlerësimin e njohurive dhe aftësive për TI-në;

- Model shumë i suksesshëm i arsimimit dhe trajnimit në fushën e TI-së;
- Ndërgjegjësim i madh për përparësitë e pjesëmarrjes aktive në shoqërinë informimit;
- Kualifikim fleksibil dhe praktik që i siguron poseduesit mobilitet të madh në shoqëri.

4.2.2. *Historiku i zhvillimit global të programit të ECDL-së*

Në vitin 1995, Këshilli Evropian i Shoqërive të Informatikës Profesionale CEPIS¹⁶ krijoi një Task-forcë të mbështetur nga Komisioni Evropian përmes programit hulumtues ESPRIT (European Strategic Program on Research in Information Technology) për të shqyrtuar mundësitë për rritjen e nivelit të kompetencave digjitale në të gjithë Evropën. Në gusht të vitit 1996 në Suedi u lansua programi i ri certifikimit, i njohur si Patenta Evropiane për përdorimin e kompjuterit - ECDL. Në mënyrë të shpejtë programi i ECDL-së u pranua në të gjithë Evropën, por gjithashtu u identifikua nevoja për themelimin e një organi qendror koordinues për të siguruar një standard të vazhdueshëm të zbatimit në të gjitha vendet evropiane. Më 8 janar 1997 u themelua organizata jofitimprurëse - Fondacioni ECDL, me qendrën e tij në Dublin të Irlandës.

Në vitin 1999, ECDL-ja fitoi rëndësi të madhe në Evropë, numri i përfituesve tejkaloi 1 milionëshin dhe ky numër vazhdonte të rritej gjithnjë e më shumë. Ky sukses filloi të tërhiqte vëmendjen e vendeve jashtë Evropës, ku ECDL-ja u zhvillua dhe u bë i njohur si Licencimi Evropian i Njohurive Kompjuterike - ICDL (International Computer Driving License).

Shoqëritë kompjuterike dhe organizatat ndërkombëtare në Afrikë dhe në Amerikën e Jugut filluan promovimin e ICDL-së dhe në vitin 1999

¹⁶ CEPIS është një organizatë jofitimprurëse, e angazhuar për përmirësimin dhe promovimin e standardeve të larta të informatikës profesionale, si dhe në njohjen e ndikimeve që informatika ka në fushën e biznesit, punësimit dhe në shoqëri në përgjithësi - www.cepis.org (shkarkuar më: 22.07.2011)

UNESCO, nëpërmjet zyrës së saj në Kajro, nënshkroi një marrëveshje me Fondacionin e ECDL-së për ta bërë atë operator kombëtar për disa shtete arabe. Menjëherë pas kësaj, ICDL-ja u nis në tregjet e Amerikës së Veriut dhe Azisë. Aktivitetin e tij Fondacioni ECDL-ja e zgjeroi në vitin 2003 me lansimin e programit të avancuar ECDL / ICDL, program ky i një niveli të nivelit të lartë të certifikimit, i dizajnuar për ata që kanë arritur me sukses nivelin e aftësive ECDL/ICDL dhe dëshirojnë zhvillim të mëtutjeshëm të aftësive të tyre kompjuterike. Planin mësimor i programit ECDL/ICDL është zhvilluar vazhdimisht në harmoni me ndryshimet tekniko-teknologjike dhe nevojës për përdorimin e tyre. Në vitin 2007, Fondacioni i ECDL-së ka bërë një shqyrtim esencial të programit ECDL/ICDL 4,0 në funksion të harmonizimit të programit me zhvillimet teknologjike. Kjo rezultoi me hartimin e programit ECDL/ICDL5,0, i cili pastaj u zbatua nga operatorët kombëtarë gjatë vitit 2009.

Një paraqitje grafike e kronologjisë së zhvillimit të programit të ECDL-së është realizuar në një studim të Institut für Wirtschaftsinformatik IWI, fig.1.




Fig.2¹⁷. Historiku global i zhvillimit të ECDL-së

¹⁷ Institut für Wirtschaftsinformatik IWI: Qualität und Nutzen der ICT-Anwender – Zertifikate in der Schweiz, fq.9, Luzern, 2010

4.2.3. Misioni i Fondacionit të ECDL-së

Fondacioni i ECDL-së është autoriteti certifikues i programeve ndërkombëtarisht prijëse të shkathhtësive kompjuterike - ECDL. Cilësia dhe reputacioni i programeve certifikuese të ECDL-së janë të ndërtuara mbi përvojën e gjatë në ofrimin e suksesshëm të programeve certifikuese për TIK-un (teknologjia informative dhe komunikuese) miliona njerëzve anembanë botës.

Misioni i Fondacionit të ECDL-së është të mundësojë shfrytëzimin kompetent të TIK-ut. Suksesi global i tij rrjedh nga roli nismëtar që ka në identifikimin dhe zhvillimin e programeve si dhe përkushtimin për të siguruar metodologji testuese që në mënyrë të vazhdueshme i zbatojnë standardet më të larta të cilësisë.

Ky fondacion është një organizatë *not-for-profit*, e cila përfiton nga përkrahja unike e ekspertëve të shoqatave nacionale të informatikës dhe qasja në organizatat ndërkombëtare anembanë botës. Punon me komunitete, autoritet lokale dhe regjionale, qeveri, organe ndërkombëtare, si UN-i dhe NGO-të e tjera ndërkombëtare në ofrimin e programeve të saja certifikuese. Ka zyrat e veta në Bruksel, Dublin dhe Singapor dhe në çdo shtet i përcakton partnerët nacionalë (po ashtu të njohur si “operator”) për Zbatimin e programeve certifikuese në nivel nacional. Ky rrjet global i shpërndarjes operon duke i zbatuar në mënyrë të përpiktë rregullat dhe standardet e sigurimit të cilësisë që mundëson arritjen e konsistencës në Zbatimin e programeve anembanë botës.

Për të zgjeruar shtrirjen e programeve të tij, Fondacioni i ECDL-së vazhdon të punojë me operatorë të tij përmes një rrjeti ndërkombëtar prej rreth 24.000 qendrave të testimit në 148 vendeve të ndryshme të botës. Programet e certifikimit të Fondacionit të ECDL-së janë të projektuara, të vlefshme dhe të miratuara nga akademikë dhe ekspertë të industrisë nga e gjithë bota.

Fondacioni i ECDL-së përcakton Standardet për Sigurimin e Cilësisë, të cilave duhet t'i përmbahen të gjithë operatorët kombëtarë dhe duhet

të jenë të harmonizuara me standardet e programit në të gjithë botën. Një kontroll i kësaj sigurie nga Fondacioni i ECDL-së bëhet përmes Sistemit të Menaxhimi të Cilësisë, me standardin ISO 9001: 2008. Respektim i këtij standardi siguron që proceset e realizuara nga Fondacioni i ECDL-së janë efektive dhe subjekt i vlerësimit dhe përmirësimit të vazhduar.

Presidenti i Komisionit Evropian (KE), Baroso, e thekson rëndësinë e certifikatës së ECDL-së për shtetet e Evropës dhe u rekomandon këtyre investimin në shkathtësitë digjitale me qëllim të ndërtimit të një Evrope konkurruese dhe të aftë për sfidat e shekullit XXI.

Për ta përkrahur realizimin e këtij synimi, KE-ja ka iniciuar një mori programesh:

- **E Government Action Plan 2011-2015**: Përmes planit të vet veprues për

-**E Qeverisje 2011-2015**, KE-ja synon ta përmirësoj qasjen në shërbimet ‘online’ deri në 50 %.

4.2.4. Agjenda Digjitale për Evropë 2010-2020

Përmes **Agjendës Digjitale për Evropë**, KE-ja synon ta promovojë zhvillimin e një Evrope konkurruese, përfshirëse dhe digjitale. Fondacioni i ECDL-së, në bashkëpunim me Qeveritë e shteteve Evropiane dhe institucionet e BE-së anembanë Evropës, është duke i implementuar një numër të madh projektesh, ndër të cilat më të rëndësishmet për t’u theksuar janë:

- Certifikimi i stafit të administratave publike për ECDL-në;
- Certifikimi i forcave policore dhe të sigurisë për ECDL-në;
- Certifikimi i nxënësve të shkollave të mesme për ECDL-në;
- Aftësimi i të papunëve në shfrytëzimin e programeve kompjuterike dhe certifikimi i tyre për ECD-në.

4.2.5. *Përfitimet nga programi i ECDL-së*Për të gjithë ne, gjithnjë e më shumë po bëhen të rëndësishme dhe të nevojshme njohuritë për përdorimin e kompjuterit. Kompetenca për mediat përfshin njohuritë për zbatimin e teknologjive informative në funksion të të qenit aktiv në jetën ekonomike, sociale dhe politike. Njohuritë për përdorimin e kompjuterit janë parakusht për t'u përshtatur me kërkesat e ngushta profesionale të çdo individi. Gati në çdo profil profesional, njohuritë dhe aftësitë për përdorimin e kompjuterit luajnë një rol mjaft të madh. Për të gjithë ata që janë të punësuar, apo që janë në proces të formimit dhe zhvillimit të tyre profesional (nxënësit, studentët, të rriturit), programi i ECDL-së ofron një platformë mjaft të përshtatshme për fitimin/zhvillimin e njohurive dhe aftësive për përdorimin e kompjuterit. Realizimi i shtatë moduleve të programit të ECDL-së ofron më tepër se përfitim të një certificate për pjesëmarrje (siç ndodh në shumë kurse për kompjuter), por siguron një përvetësim të përshkallëzuar të njohurive dhe aftësive për përdorim të kompjuterit. Ndër të tjera, përfitimi dhe certifikimi i njohurive dhe aftësive për përdorimin e kompjuterit përmes programit i ECDL-së ka një njohje të lartë internacionale dhe kjo e bën më të veçantë këtë program. Zbatimi i tij po zë vend gjithnjë e më shumë në institucionet publike dhe private të çdo vendi.

Njohuritë për Teknologjinë Informative në **kompani/ndërmarrje** të vogla dhe të mëdha kanë një rëndësi mjaft të madhe në konkurrencën dhe suksesin apo mosesuksesin e saj. Në vendet e zhvilluara si evropiane, si Gjermania, paraqitja e certifikatës së programit të ECDL-së nga punëkërkuksi për punëdhënësin është një dëshmi e qëndrueshme se ai posedon njohuri dhe aftësi të mjaftueshme për punën me kompjuter. Sipas kompanisë së shërbimit për shkencën kompjuterike DLGI, njëherësh përfaqësuese për programin e ECDL-së në Gjermani, *“përparësitë e paraqitjes së certifikatës së ECDL-së në procesin e konkurrimit për vend pune janë të dukshme, meqenëse certifikata ofron*

dëshmi për njohuri, aftësi dhe kompetenca bazë për përdorimin e kompjuterit dhe punëdhënësi ka mundësi në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjykojë aftësitë e kandidatit për përdorimin e kompjuterit. Personat me ECDL-në u përshtaten shumë më lehtë ndryshimeve ekonomike dhe tekniko- teknologjike dhe konkurrencës gjithnjë në rritje”¹⁸.

Përfitimet e punëdhënësit nga ECDL-ja mund të përmbliidhen në:

- Metodë e besueshme për matje dhe krahasim i aftësive të punonjësve për fushën e TI-së;
- Ngritjen e produktivitetit;
- Ngritjen e cilësisë në prodhim;
- Reduktimin e kohës dhe kostos;
- Përdorim më efikas i teknologjisë poseduese;
- Kthim efikas i investimeve.

Programi i ECDL-së ndikon dukshëm në përmirësimin e cilësisë në **administratën publike**, sidomos përmes ofrimit të shërbimeve elektronike. Në disa vende evropiane, si Austri, Belgjikë, Britani dhe Itali, ECDL-ja është pjesë e programeve të qeverisjes elektronike (E-Government)¹⁹.

Në disa vende të Evropës, programi i ECDL-së ka filluar të integrohet edhe në **procesin arsimor/shkolla**. Në një studim, të realizuar nga Instituti për Kërkime Arsimore dhe për arsimim të të rriturve (ISH) në Hamburg të Gjermanisë, rezulton se *nxënësit të cilët që në shkollat e tyre kanë realizuar programin e ECDL-së, kanë mundësi më të mira për zhvillim profesional dhe hyrje në tregun e punës. Njëkohësisht, integrimi i standardeve të programit të ECDL-së në shkolla ka sjell*

¹⁸ DLGI - Dienstlaeistungsgesellschaft für Infirmatik mbH: *Daten und Fakten/ECDL*, fq.4, www.dlgi.de (shkarkuar më: 26.07.2011)

¹⁹ Po aty, f. 4.

*rezultate pozitive në ngritjen e kualitetit të mësimdhënies në fushën e teknologjisë informative*²⁰.

Në përgjithësi, përfitimet e kandidatëve nga ECDL-ja mund të konsiderohen:

- Ngritja e nivelit të njohurive dhe aftësive bazë për Teknologjinë e Informimit;
- Arritja e kualifikimit të njohur ndërkombëtarisht, certifikimi, i cili mundëson/lehtëson qasje në tregun internacional të punës;
- Zhvillimi i karrierës dhe mobilitet brenda tregut të punës;
- Hapja e mundësive për edukim më të lartë në fushën e Teknologjisë së Informimit.

4.3. Modele të avancuara nga vendet evropiane për integrimin e ECDL-së në shkolla

Në disa vende evropiane, si Austria, Italia, Zvicra dhe deri diku Gjermania, përmbajtjet e ECDL-së tanimë janë pjesë e programit arsimor. Oferta për përfitim nga programi i ECDL-së ndryshon nga vendi në vend, ku në disa vende përmbajtje të programit të ECDL-së janë të integruara në kurrikulën e përmbajtjeve programore të lëndëve mësimore që lidhen me fushën e TI-së, dhe njëkohësisht këto përmbajtje merren për bazë edhe në hartimin e standardeve arsimore. Krahas kësaj, shumica e shkollave licencohen në cilësinë e qendrave të testimit për programin e ECDL-së, të cilat pastaj u ofrojnë mbështetje nxënësve për realizimin e shtatë moduleve të programit, si dhe realizojnë vlerësimin/certifikimin e njohurive dhe aftësive të nxënësve për modulet përkatëse të programit. Në secilin vend ekziston institucioni/shoqëria e shërbimit të shkencave kompjuterike, përfaqësues për programin e ECDL-së . Në Gjermani, institucion

²⁰ Studie zum Europäischen Computerführerschein ECDL: *Schüler finden schneller in der Beruf-* DLGI Bonn, 2008, www.pressebox.de/pressemeldungen/dlgi

përfaqësues për këtë program është *DLGI (Dienstlaistungsgesellschaft für Informatik mbH)*, në Austri, përfaqësuese për ECDL-në është kompania *OCG (Österreichischen Computer Gesellschaft)*, ndërsa testimet për programin e ECDL-së i realizon *IT in der Bildung – Gesellschaft für Innovation und Technologie mbH*, në bashkëpunim me *Bundesministerium für Unterricht, Kunst und Kultur (BMUKK)*²¹. Në Zvicër, certifikimi për ECDL-në realizohet nga *SI (Schweizer Informatik Gesellschaft)*, ndërsa funksionin operativ e realizon *ECDL Schwitzerland AG*²².

4.3.1. Modeli austriak i integritit të ECDL-së në shkollë²³

Sistemi arsimor në Austri²⁴ rregullohet nga Ministria Federale për Arsim, Art dhe Kulturë (Bundesministerium für Unterricht, Kunst und Kultur - BMUKK). Përmes kësaj ministrie koordinohen të gjitha përmbajtjet mësimore dhe aktivitetet e tjera arsimore në shkollë (trajnimi i mësimeve, qeverisja e shkollave etj).

Austria është një nga vendet më të avancuara evropiane në fushën e integritit të ECDL-së në shkollë. Që nga viti 1998, në Austri realizohen teste për programin ECDL në të gjitha nivelet/tipat e shkollave (Allgemeinbildene Höhere Schule-AHS, Allgemeinebildene Pflichtschule-APS, Berufsbildeneschule-BHS, Berufsschule -BS dhe Pädagogische Hochschulen – PH)²⁵. Në shumë shkollë, përmbajtja e Syllabusit të ECDL Core shërben si bazë për mësime në fushën e Teknologjisë Informatike dhe me këtë Austria është një shembull në gjithë Evropën.

²¹ ECDL in Education Austria: ECDL an Schulen, www.edu.ecdl.at (shkarkuar më: 01.08.2011).

²² Institut für Wirtschaftsinformatik IWI: Qualität und Nutzen der ICT-Anwender – Zertifikate in der Schweiz, f. 13, Luzern, 2010.

²³ www.edu.ecdl.at (shkarkuar më : 04.08.2011)

²⁴ Paraqitja grafike e sistemin arsimor të Austrisë - shtojca 2

²⁵ Bildungssystem in Österreich, www.wikipedia.org(shkarkuar më 04.08.2011)

Realizimi i programit të ECDL-së në shkollat e Austrisë është mundësuar falë bashkëpunimit mes Shoqatës ECDL në shkolla dhe në administratën publike(*IT in der Bildung*) dhe Shoqërisë Austriake për Kompjuter(*OCG*). Sipas një interviste të ECDL News, realizuar me Ernst Karmer- udhëheqës i *IT in der Bildung* dhe iniciator i ECDL-së në Austri, *ideja për realizimin e certifikatës së njohur ndërkombëtarisht-ECDL, në shkolla u dëgjua në një seminar për Teknologjinë e Informimit, të mbajtur në Shkollën e turizmit në Salzburg. Pas një serie bisedimesh lidhur me realizimin e projektit “ECDL në shkolla”, më 13. 10. 1998 u themelua shoqata “IT in der Bildung”, më 14. 10. 1998 u kualifikuan testuesit/vlerësuesit e për programin e ECDL-së, ndërsa më 22. 12. 1998 u realizua testimi i parë i nxënësve. Ky inovacion ishte një ndër sukseset më të mëdha në sistemin arsimor të Austrisë’*,²⁶.

Sipas Karmer, qëllimi i projektit “ECDL në shkolla” është zhvillimi i njohurive dhe aftësive të nxënësve për përdorimin e kompjuterit. Përmes këtij programi sigurohet cilësi në fushën e TI-së, por edhe në fushat e tjera mësimore në përgjithësi, cilësi kjo e identifikuar nga Studimi PISA në Austri. Ofrimi i mundësisë për përfitim nga programi i ECDL-së për nxënësit është realizuar që në vitin 1999, ku kjo ofertë ka qenë e vlefshme për nxënësit 18-vjeçar. Ndërkohë, oferta për përfitim nga programi i ECDL-së vlen edhe për 14-vjeçarët. Për momentin (viti 2004) janë 1200 shkolla që e realizojnë programin e ECDL-së dhe ato vendosin kur dhe cilat module (nga shtatë module sa janë në programin e ECDL Core) t’i realizojnë me nxënës. Janë më se 25.000 Skill Cards të realizuara me nxënës dhe çdo i treti nxënës në Austri fillon me programin e ECDL-së. Meqenëse ECDL-ja është një certifikim i jashtëm, vlerësimi që i bëhet përfitimit të nxënësit në këtë program nuk mund të jetë pjesë e notimit të rregullt të nxënësit. Testuesit/vlerësuesit në shkolla janë anëtarë të shoqatës, ata nuk mund të jenë njëkohësisht

²⁶ECDL News-Aktuelle informationen zum ECDL: Ernst Karmer - Nichts geht mehr ohne ECDL, Nr.1/2004, f. 4.

edhe mësimdhënës në të njëjtën shkollë. Në arsimin e obliguar (Pflichtschule) përmbajtja e programit të ECDL-së është bërë pjesë përbërëse e programit mësimor dhe shumë mësimdhënës deklarohen se “tani dinë më mirë se çfarë duhet t’u mësojë nxënësve”. Programi i ECDL-së në veçanti është avancuar në Austrinë e Epërme (Oberösterreich), në Steiermark dhe në Salzburg. Sukses më të madh në këtë program kanë shkollat urbane se sa në ato rurale dhe atë shkolla të profileve humane dhe niveli i shkollimit të obligueshëm sesa në Allgemeinbildende höhere Schule- AHS (gjimnaze). Në të gjitha shkollat janë vlerësuar më se 154.000 module²⁷.

Sipas Gerald Futschek, përfaqësues i ‘ECDL Chair Austria’, programi i ECDL-së është zhvilluar si standard për fushën e TI në të gjitha nivelet dhe tipat e shkollave të Austrisë. Përfitimi nga programi fillon me juniorë, dëshmi për njohuritë dhe aftësitë e para për përdorimin e kompjuterit për fëmijët ndërmjet moshës tetë dhe dymbëdhjetë vjeçare dhe vazhdon pastaj me të gjitha moshat. Kjo përgatitje u mundëson gjeneratave të ardhshme inkuadrim më të lehtë dhe sukses në tregun e punës²⁸.

4.3.2. Informacione të përgjithshme për programin e ECDL-së në shkollat e Austrisë

Programi ‘ECDL Core’ në shkollat e Austrisë ofrohet që për moshën 12-vjeçare të nxënësve. Çdo shkollë që pretendon të certifikohet si Qendër Testuese për programin e ECDL-së, së pari duhet të plotësojë një formular/ kërkesë²⁹ në të cilin jepen të gjitha karakteristikat e shkollës (emri i shkollës, tipi i shkollës, adresa), shënime për llojet e programeve kompjuterike që shkolla ka në funksion (Windows XP, Windows Vista, Windows 7, Open Office, Office 2007, Office 2010,

²⁷ Po aty, f. 4

²⁸ Po aty, f. 3

²⁹ ECDL in Education Austria : ECDL Testcenterantrag ,www.ecdl.ch (shkarkuar më 05. 08. 2011).

etj) dhe kjo kërkesë i drejtohet shoqatës „IT in der Bildung”. Pas licencimit të shkollës (mbi bazën e përmbushjes së kriterëve të parashtruara për licencim) si Qendër e Testimit për ECDL-në. Pas kësaj, në uebfaqen e saj shkolla hap ofertën për testues/vlerësues të kualifikuar – realizues të testeve në shkollë, të cilët paraprakisht janë të regjistruar si anëtarë të shoqatës. Këta testues/vlerësues mund të jenë mësimdhënës të cilësdo shkollë, pa marrë parasysh tipin e shkollës apo rajonin prej nga vijnë. Përzgjedhja e testuesve/vlerësuesve nuk është në kompetencat e shkollës, por testues/vlerësues të një termini përkatës për testim/vlerësimin e nxënësve mund të jetë testuesi/vlerësuesi i parë që ka konfirmuar marrjen përsipër këtë proces³⁰.

Përgatitja e mësimdhënësve për testues/vlerësues të programit të ECDL-së

Kualifikimi për testues/vlerësues për programin e ‘ECDL Core’ në shkollat e Austrisë është një proces, për kalimin e të cilit kandidati duhet të plotësojë disa kriterë:

- Të jetë mësimdhënës në ndonjë shkollë të Austrisë (pa marrë parasysh tipin e shkollës);
- Të ketë të përfunduara të shtatë modulet e programit të ECDL-së³¹;
- Të ketë të përfunduar me sukses kualifikimin për testues/vlerësues;
- Të jetë anëtar i shoqatës „Verain zur Förderung des ECDL an Schulen”.

³⁰ Po aty: Testcenter Registrierung

³¹ Mësimdhënësit që përfundojnë me sukses katër modulet e programit ECDL, kualifikohen për testim/vlerësim të procesit përmes formës elektronike; mësimdhënësit që përfundojnë të shtatë modulet e programit ECDL, kualifikohen për testim/vlerësim të procesit përmes formës elektronike dhe përmes Open Office – Modulen, që mundëson edhe korrigjimin me dorë të përmbajtjeve.

Kualifikimi për testues/vlerësues të programit ‘ECDL Core’ arrihet përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve kandidatë në seminarin 1 ½ ditor, ku ata aftësohen për përmbajtjet teorike dhe praktike të programit të ECDL-së.

Kategoria	Çmimi
Skillscard	30 €
Kostoja personale	25 €
Kostoja e shërbimeve	60 € deri 130 €, varësisht nga numri i pjesëmarrësve
Kostoja për përsëritjen e modulit	12 €

Tabela 4. Kostoja për kualifikim për testues/vlerësues

Hapat që duhet të ndjekë nxënësi për të përfituar nga programi i ECDL-së:

Përveç përmbajtjeve të programit të ECDL-së të integruara në planet dhe programet mësimore në fushën e TI-së në shkolla, nxënësi ka mundësi të përcaktohet edhe për pjesëmarrje në kurse shtesë për programin që realizohet nga Qendrat e Testimit në shkolla, apo për mësim të pavarur të përmbajtjeve (moduleve) të programit të ECDL-së. Pas kësaj, nxënësi kontakton me QT-në në shkollë, informohet për terminet e provimeve/testimeve, për versionet e programeve, përmes së cilave do të realizohet testimi/vlerësimi (Office 2007, 2010), format e testimit dhe informacione të tjera varësisht nga interesimet e nxënësve. Pas përfundimit të testimit, nxënësi vlerësohet me “kaluar” apo “jo kaluar”. Në rastet pozitive, nxënësi pajiset me certifikatën për modulën/modulet përkatëse të testuara, e cila lëshohet nga *Shoqëria Austriake për Kompjuter (OCG)*³².

³² ECDL Core: Kosten, Vorteile, Module, Lehrinhalte, wie kome ich zum ECDL, f. 1, www.iuec.net (shkarkuar më: 06.08.2011).

ECDL për nxënësit me nevoja të veçanta pedagogjike (Kinder mit Sonderpädagogischen Förderbedarf)

Që nga marsi i vitit 2008, në Austri është filluar me realizimin e testimit/vlerësimit të nxënësve me nevoja të veçanta pedagogjike për programin e ECDL-së. Paraprakisht, në shkollat e përgjithshme të nivelit obligativ - Allgemeinebildene Pflichtschule (APS), lloji dhe niveli i nevojës për mbështetje pedagogjike të nxënësit rregullohet me një vendim juridik. Në shkollat e tipit tjetër dhe në arsimin e të rriturve është detyrë e testuesit që në bashkëpunim me shoqatën „IT in der Bildung“ të vendosë për këtë nivel dhe lloj të ndihmës për nxënësin përkatës, dhe është në kompetencat e tij që mbi bazën e kësaj nevoje të vendosë për mjetet, materialet, kohën në dispozicion të secilit nxënës për realizimin e testimit/vlerësimit të njohurive dhe aftësive të tij për programin e ECDL-së. Një herë në vit realizohet seminari përgatitor njëditor për vlerësuesit/testuesit e nxënësve me nevoja të veçanta pedagogjike. Të gjitha rregullat dhe kriteret për testimin/vlerësimin e këtyre nxënësve për programin e ECDL-së plotësohen dhe përshtaten me kërkesat çdo një vit. Procedurat e tjera të përgatitjes dhe certifikimit janë të njëjta me nxënësit e tjerë në shkollë³³. Në vitin shkollor 2010/2011, shoqata “IT in der Bildung” merr përsipër pagesën për Slilcard për këtë kategori të nxënësve, gjithashtu ofrohet edhe mundësia e plotësimit manual të materialeve testuese/vlerësuese nga këta nxënës. Kostoja e përgjithshme mbi bazën e kategorive përfituese nga programi i ECDL-së është e paraqitur në tabelën 5. **Kostoja për ECDL Core**³⁴

³³ MSc.Erich Parmmer: Kriterien für ECDL Prüfungen bei behinderten Kindern, 2008, f.1. www.edu.ecdl.at (shkarkuar më: 11.08.2011)

³⁴ ECDL Core: Kosten, Vorteile, Module, Lehrinhalte, wie komme ich zum ECDL, f. 2, www.iuec.net (shkarkuar më : 06.08.2011)

Kategoria	Nxënës, mësimdhënës dhe punëtorë administrativ	Nxënës me aftësi të kufizuara	Të rriturit
Skill Card	43 €	Pagesa për Skillcard realizohet nga „ECDL an Schulen “	50 €
Moduli	Një modul=12 € * shtatë module =84 €	12 € për modul	Një modl = 27 €* shtatë module =189 €
Gjithsej	127 €		239 €
Përsëritja e moduleve	Një modul =12€		

Tab.5.Kostoja e përgjithshme për programin ECDL

4.4. Modeli zviceran i integritit të ECDL-së në shkolla

Sipas një studimi të realizuar nga Hochschule Luzern,, *Qualitet und Nutzen der ICT-Anwender –Zertifikate in der Schweiz*”, *integrimi i lëndës së informatikës (krahas matematikës dhe shkencave natyrore) në arsimin e përgjithshëm ka ardhur jo vetëm nga rëndësia dhe ndikimi TIK-ut në ekonom, por njohja dhe përdorimi i tij tani më është pjesë e çdo profesioni në Zvicër, dhe baza teknologjike e një shoqërie moderne të informacionit qëndron mbi të kuptuarit e rolit të kësaj teknologjie në raport me ekonominë. Përmes të mësuarit të TIK-ut, krahas lëndëve tjera bazë në shkolla, nxënësit aftësohen për përdorimin e kompjuterit dhe realizimit të operacioneve matematikore përmes tij. Për arritjen e këtij qëllimi, përfitimi i njohurive bazë për TIK-un duhet të ndodhë që në nivelin e parë të shkollimit të nxënësve.*³⁵

Programi i ECDL-së në Zvicër filloi të realizohet në vitin 1999 në arsimin e vazhdueshëm (arsim i të rriturve), ndërsa një vit më vonë ky program u ofrua edhe në kuadër të ofertës arsimore në shkolla. Sipas studimit në fjalë, deri në fund të vitit 2008, nga programi i ECDL-së

³⁵ Institut für Wirtschaftsinformatik IWI: *Qualitet und Nutzen der ICT-Anwender – Zertifikate in der Schweiz*, f. 2, Luzern, 2010.

kanë përfituar 120 mijë persona të moshës 10 deri 97 vjeç, ndërsa 55 % e pronarëve të Skillscard në Zvicër janë nxënës³⁶.

Bartës i të gjitha aktiviteteve që lidhen me fushën e ECDL-së në Zvicër është Shoqëria Zvicerane për Informatikë (*Schweizer Informatik Gesellschaft-SI*), ndërsa funksionin operativ e realizon *ECDL Switzerland AG*. ECDL Switzerland AG – është themeluar në vitin 2000 me seli në Basel dhe është përgjegjëse për koordinim të të gjitha aktiviteteve që lidhen me fushën e ECDL-së në Zvicër, në Principatën e Lichtenstain-it, Holandë dhe vendet e tjera joesropiane. Testimet/vlerësimet për këtë program në Zvicër ofrohen në pesë gjuhë të komuniteteve që jetojnë atje: Gjermanisht, Frëngjisht, Italisht, Anglisht dhe Spanjisht. Modulet e testuara/vlerësuara pozitivisht barten në dokumentin personal *Skill Card* të kandidatit, e cila lëshohet nga Qendra Testuese, është me pagesë dhe ofron mundësinë e vlefshmërisë për realizim të të gjitha moduleve brenda tre vjetësh. Sot testimet/vlerësimet për programin ECDL realizohen në 300 Qendra Testuese në të gjithë Zvicrën. Krahas certifikatës *ECDL Start*(katër module bazë) dhe ‘*ECDL Core*’ (absolvimi në shtatë modulet e programit), nga viti 2002/2003 ofrohet edhe ‘*ECDL Advance*’, ndërsa për njohuri dhe aftësi specifike në krijimin e Homepage (uebfaqeve), nga 2006 ofrohet programi ‘*ECDL WebStarter*’, ndërsa për përpunim profesional të fotove ofrohet programi ‘*ECDL ImageMaker*’³⁷.

Integrimi i programit i ECDL-së në shkollat e Zvicrës

Sistemi arsimor zviceran³⁸ është sistem i decentralizuar dhe i rregulluar mbi bazën e kantoneve. Kantonet dhe komunat e tyre janë përgjegjës për anën organizative dhe financiare të shkollave. Në baza nacionale, e përbashkët është përcaktimi për moshën hyrëse në shkollë, fillimi dhe

³⁶ Po aty f. 13.

³⁷ Po aty, f. 13.

³⁸ Paraqitja grafike e sistemin arsimor të Zvicrës - shtojca 3

zgjatja e vitit shkollor, dhe kohëzgjatja e shkollimit të obligueshëm. Konferenca Zvicerane e Drejtorëve Kantonalë të Arsimit (EDK) është organ i bashkimit të 26 kantoneve të Zvicrës, përgjegjëse për të gjitha fushat e politikës arsimore dhe kulturore të saj. Mbi këtë sistem, vendimin për integrimin e përmbajtjeve të programit të ECDL-së në kurrikulat shkollore në Zvicër merret në nivelet komunale dhe në shkolla të kantonit.

Certifikimi për programin e ECDL-së në shkolla në Zvicër ka filluar me hapjen Qendrës së parë testuese dhe me testimin/vlerësimin e njohurive dhe aftësive të mësimdhënësve të nivelit ISCED 1 dhe 2 në shkollat e Apenzell-it në kantonin e Luzerint. Nga viti 2007/2008 kjo mundësi u ofrua edhe për nxënësit e Sekondarstufe I (ISCED 2) të të njëjtave shkolla. Përgatitja e nxënësve për testimin/vlerësimin e njohurive dhe aftësive për ECDL-në u realizua përmes qasjes pa pagesë në portalin elektronik ECDL 4Plus, në serverin nacional të arsimit educanet³⁹. Deri më tani, në të gjitha kantonet gjermano - folëse në Zvicër, ECDL-ja është integruar në Sekondarstufe I⁴⁰ dhe në Sekondarstufe II (ISCED 3 dhe 4)⁴¹.

ECDL-ja për nxënësit me aftësi të kufizuara

“*ECDL barrierefrei*” (ECDL –bf) është një projekt që realizohet nga shoqata Zvicerane “*Zugang Für alle- ZFA*” (Qasje për të gjithë), Shoqëria Zvicerane për Informatikë (SI) dhe ECDL Switzerland AG, dhe ka për qëllim mbështetjen e njerëzve me aftësi të kufizuara për qasje më të mirë në aftësimin bazë për kompetenca për Teknologjinë e

³⁹ educanet² – platformë e internetit e përshtatur për procesin arsimor në të gjithë Zvicrën. Është lansuar në vitin 2001 me urdhër të nivelit federal dhe kantonal të Zvicrës. Afër 90% e shkollave të Zvicrës të kyçur në platformën elektronike punojnë me educanet2. www.educanet2.ch/broschuere.pdf (shkarkuar më: 16. 08. 2011)

⁴⁰ Sekondarstufe I- nivel i shkollimit që zgjat tre vjet dhe përfshin klasat shtatë, tetë dhe nëntë (mosha 12 deri 15 e nxënësve, www.educa.ch (shkarkuar më 10.08.2011)

⁴¹ Sekondarstufe II përfshin gjimnazet dhe shkollat e ndryshme profesionale, po aty.

Informimit. Në kuadër të projektit ECDL-bf, zhvillohet një sistem i të mësuarit multimedial përmes të cilit, përfituesit kanë mundësi të përgatiten për testet vlerësuese për ECDL-në. Ky program është i dedikuar për:

- Personat me probleme në shikim;
- Personat me probleme në të folur/dëgjuar;
- Personat me aftësi të kufizuara fizike;
- Personat me vështirësi në të mësuar.⁴²

Realizimi i programit të ECDL-së në ‘Kantonsschule’ në Schaffhausen të Zvicrës

‘Kantonsschule Schaffhausen’ është një shkollë e mesme në kantonin Schaffhausen në Zvicër. Realizimi i mësimit në këtë shkollë është i ndarë në tre profile bazë: profili muzikor - gjuhësor, shkencor-matematikor, dhe profili gjuhësor (gjuhësi e lashtë). Shkolla ofron informacion të mjaftueshëm për nxënësit lidhur me programin e ECDL-së, mundësitë e përgatitjes për përmbajtjet e programit, etj. Përmes kurseve që ofrohen në shkollë, nxënësit kanë mundësi të përgatiten për testimin e njohurive dhe aftësive të tyre për programin e ECDL-së. Gjithashtu, shkolla ofron edhe testet diagnostikuese, të cilat janë me pagesë dhe mund të shfrytëzohen vetëm një herë nga nxënësi. Testimet për modulet e programit realizohen në oraret jashtë mësimore të shkollës.

Edhe pse kantoni Schaffhausen merr përsipër një pjesë të shumës për përfitimin e certifikatës ECDL, nxënësi duhet të paguaj hapjen e Enligh-Kontos (Skills Card) me çmimin prej 75 CHF⁴³. Pas regjistrimit dhe pajisjes me Skillscard, nxënësi pajiset me një fjalëkalim (password)

⁴² Bit Media Schweiz AG: ECDL barrierefrei - Das Lehrpaket zum Europäischen Computer Föhreschein für menschen mit Behinderungen; www.bitmedia.ch (shkarkuar më 11. 08. 2011)

⁴³ Kosten von ECDL, www.kanti.ch (shkarkuar më 10. 08. 2011)

të shkollës, gjë që dëshmon dhe mundëson testimin vetëm në Qendrën Testuese të shkollës përkatëse. Me rastin e dhënies së fjalëkalimit të shkollës dhe fjalëkalimit të Skillscard, nxënësi ka qasje në testim për cilindo nga modulet e programit të ECDL-së. Me përfundimin me sukses moduleve të programit, nxënësit i barten këto shënime në Skillcardën e tij. Certifikatën për modulën e kaluar nxënësi e merr nga mësimdhënësi kujdestar i klasës pas dy ose tri javësh.

4.5. Fondacioni i ECDL-së në Kosovë - historiku dhe aktivitetet

ECDL Kosova u themelua në vitin 2009 dhe është autorizuar nga Fondacioni i ECDL-së (ECDL Foundation, www.ecdl.org), si Autoritet Nacional Certifikues për certifikimin e njohurive dhe shkathtësive digjitale të individëve në territorin e Republikës së Kosovës.

ECDL Kosova ka arritur që ta shtrijë rrjetin e saj të qendrave testuese anembanë Kosovës. Aktualisht (qershor 2011) ECDL Kosova numëron 28 qendra testuese (universitete publike e private, kompani, OJQ, shkolla, etj.) me gjithsej 250 administratorë të certifikuar të provimeve dhe mbi 160 proktorë.

ECDL Kosova, në bashkëpunim me botuesit e librave dhe materialeve didaktike, ka arritur t'i miratojë një mori materialesh mësimore në gjuhën shqipe, të cilat u shërbejnë qendrave trajnuese dhe kandidatëve që të përgatiten për testim/vlerësim për programin e ECDL-së, tabela 6.

Librin e ECDL-së për programet aplikative të Office-it të Microsoft-it	<ul style="list-style-type: none"> • Libri i ECDL-së për Office 2003, botues: Smart Bits, botim i vitit 2009 • Libri i ECDL-së për Office 2010 dhe Windows 7, botues BitMedia, botim i vitit 2011
Portalin mësimor për mësim elektronik	<ul style="list-style-type: none"> • www.edukimi.net, për Office 2002 dhe Windows XP • www.trajnimi.com, për Office 2003 dhe Windows XP • http://bit-kosova.e-learning.cc, për Office 2010 dhe Windows 7
Sistemin automatik online të evaluimit të provimeve (provimet të disponueshme në të gjitha gjuhët zyrtare të vendit)	<ul style="list-style-type: none"> • www.enlight.ch
Testet provuese (diagnostikuese)	<ul style="list-style-type: none"> • www.enlight.ch

Tabela 6. Materialet mësimore për programin e ECDL-së

ECDL Kosova me sukses e ka promovuar standardin e ECDL-së në Kosovë; tanimë ECDL-ja është adaptuar si standard nga një mori organizatash e institucionesh të vendit. Arritja kryesore e ECDL-së në fushën e promovimit të edukimit digjital është inkorporimi i ECDL-së në **Planin e Veprimet për Zbatimin e Partneritetit Evropian 2011 (PVPE-2011)**. Meqenëse Integrimi Evropian mbetet prioriteti kryesor i Qeverisë së Kosovës, Plani i Veprimet i Partneritet Evropian është dokumenti kryesor afatmesëm planifikues, i cili ka për qëllim adresimin e sfidave dhe prioriteteve kyçe afatshkurta dhe afatmesme të identifikuar nga Partneriteti Evropian.

Në këtë kontekst, PVPE-ja duhet të përdoret për planifikimin e veprimtarisë së përgjithshme të Qeverisë në lidhje me agjendën politike dhe prioritetet e saj, agjendën legjislativë të Qeverisë dhe të Kuvendit, nevojat për punësim, ndërtimin institucional dhe trajnimin e personelit si dhe investimet e nevojshme.

PVPE 89/2 përcakton Zbatimin e trajnimit dhe certifikimit me ECDL-në për të gjithë punonjësit e administratës publike. Nga ky hap priten shumë përfitime në fushën e avancimit të shërbimeve të administratës, rritjes së eficiencës dhe efikasitetit, zvogëlimit të kostos dhe rritjes së transparencës.

Këtij veprimi të çmuar të Qeverisë së Republikës së Kosovës i kanë paraprirë shumë projekte të suksesshme nga viti 2004 e këndej.

4.6. Kostoja e përfitimit në programin e ECDL-së në Kosovë

Trajnimi për programin e ECDL-së në Kosovës konsiston zakonisht me 88 orë trajnimi të shpërndara në ditë dhe terminë të veçantë. Kostoja e përfitimit /trajnimit dhe certifikimit për programin e ECDL-së ndryshon, varësisht nga kategoritë përfituese.

Trajnimi		
Moduli	Orët	Kostoja
Moduli 1. Bazat e teknologjisë së informimit dhe komunikimit (ICT)	8	24.00 €
Moduli 2. Shfrytëzimi i kompjuterit dhe menaxhimi i fajllave (Word)	12	36.00 €
Moduli 3. Përpunimi i teksteve (Windows XP)	20	60.00 €
Moduli 4. Kalkulimi i tabelave (Excel)	16	48.00 €
Moduli 5. Baza e të dhënave (Access)	16	48.00 €
Moduli 6. Prezantimet (Power Point)	8	24.00 €
Moduli 7. Interneti dhe komunikimi (Internet Explorer & Outlook	8	24.00 €
Gjithsej (të gjitha modulet) 264.00 €		
Certifikimi		
Përshkrimi	Çmimi- edukim	Çmimi- trajnim
Skills Card	20.00 €	45.00 €
Testi (për njësi)	10.00 €	15.00 €
Libri i ECDL-së	15.00 €	15.00 €

Tabela7. Pasqyra e koston për programin e ECDL-së, specifikuar në modulet përkatëse

V. PËRFSHIRJA E TIK-UT NË PROGRAMET E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT (KLASAT 6-9) DHE ARSIMIT TË MESËM TË LARTË (KLASAT 10-12/13)

5.1. Konteksti i zhvillimit të programeve të TIK-ut në Kosovë

Arsimi në Kosovë nga fillimi i shekullit 21, së bashku me të edhe shoqëria, po kalon në një proces transformimi. Zhvillimet në arsim janë shoqëruar me një numër të konsiderueshëm të ndryshimeve, si: ndryshimi i strukturës së arsimit, hartimi Kornizës së Kurrikulës dhe planeve e programeve mësimore, përgatitja e teksteve të reja mësimore, trajnimi i mësimdhënësve për zbatimin e teknikave të reja të mësimdhënies, përfshirja e teknologjisë në mësimdhënie, humanizimi i arsimit dhe respektimi i të drejtave të njeriut. Këto zhvillime kanë shtruar nevojën për njohuri, aftësi dhe shkathtësi në fushën e teknologjisë së informimit dhe komunikimit.

Pikënisje e ndryshimeve të reja në arsimin parauniversitar në Kosovë ishte Korniza e Kurrikulës së Re të Kosovës, e përgatitur në vitin 2001, mbi bazën e secilës u bënë shumë ndryshime në arsim, duke përfshirë strukturën arsimore dhe planet e programet mësimore.

Në bazë të strukturës së re arsimore u shtua klasa e 9-të si klasë e obligueshme, ku synohej orientimi i nxënësve për shkollim të mëtejshëm, me qëllim që nxënësit ta kenë më lehtë të vendosin për shkollën përkatëse apo për karrierën e ardhshme profesionale⁴⁴. Kurse, në fund të klasës së 12-të të shkollës së mesme të lartë synohej që nxënësit të arrijnë studim më të thelluar në profilin e zgjedhur dhe aftësimin për integrim të suksesshëm në tregun e punës apo për integrim në arsimin universitar⁴⁵.

⁴⁴ MASHT: Korniza e Kurrikulës së Re të Kosovës 2001, f. 40

⁴⁵ Po aty, f. 41

Synimet në fund të shkallëve kyçe dhe niveleve të shkollimit kanë bërë që të hartohet një kornizë orientuese e lëndëve mësimore, të cilat do të përfshihen në klasë të caktuara dhe shkallë e nivele të caktuara të arsimit parauniversitar. Në kornizën orientuese të planeve mësimore, lënda mësimore *Teknologjia*, duke përfshirë edhe TIK-un, zë një vend të rëndësishëm. Si lëndë mësimore në klasat 6-8, përfaqësohet me 4.5% të numrit të përgjithshëm të orëve mësimore të të gjitha lëndëve mësimore, në klasën e 9 përfaqësohet me 6.45%, ndërsa në gjimnaze përfaqësohet varësisht prej drejtimeve të gjimnazit, p.sh. në drejtimin matematikë me TIK-un përfaqësohet me 9.80% të numrit të përgjithshëm të orëve mësimore, kurse në drejtimin shoqëror përfaqësohet me 4.50 % të numrit të përgjithshëm të orëve mësimore⁴⁶. Planet dhe programet mësimore ekzistuese përmbajnë strukturë të përafërt për secilën lëndë mësimore, si hyrjen, qëllimet, objektivat e përgjithshme dhe të veçanta, përmbajtjet programore në të cilat përfshihen kategoritë mësimore, nënkategoritë, numri i orëve, rezultatet e pritura etj., pastaj udhëzime për metodologjinë e mësimdhënies dhe vlerësimit, si dhe literaturën e burime të tjera të lidhura me lëndën përkatëse dhe nivelin e shkollimit. Në këtë frymë është hartuar edhe plani dhe programi i teknologjisë, duke përfshirë edhe TIK-un.

5.2. Përfshirja e TIK-ut në planet dhe programet mësimore në klasat 6-9-të

Edukimi për teknologji të informimit dhe komunikimit është një nga komponentët thelbësorë të Kurrikulës në shkollën bashkëkohore. Sot, në shoqërinë e dijes, “në një botë ku ndeshesh me shumë lloje teknologjish, të cilat janë pjesë e jetës së përditshme për të gjithë njerëzit gjatë punës ose kohës së lirë, nxënësit duhet të pajisen me aftësi për t’u përballur me to me vetëbesim”⁴⁷. Përfshirja përmbajtjesore

⁴⁶ Po aty, f. 83 - 93

⁴⁷Instituti i zhvillimit të arsimit (2010): Udhëzues kurrikular (material ndihmës për mësuesit e gjimnazit), Fusha: Teknologjia, f. 5, Tiranë.

e TIK-ut në planet dhe programet mësimore e siguron hapin e parë drejt realizimit të kësaj objektive.

Përvojat e Kosovës në këtë fushë janë relativisht të reja. Zhvillimet më të avancuara në këtë drejtim janë bërë në procesin e hartimit të planeve dhe programeve të reja mësimore 2001-2006. Për të parë përfshirjen e TIK-ut në planet dhe programet mësimore në klasat 6-9, ne kemi analizuar planin dhe programin e teknologjisë me TIK-un në të gjitha klasat dhe në pjesën në vijim do t'i prezantojmë gjetjet nga kjo analizë.

5.2.1. Programi i Teknologjisë me TIK-un në klasën e 6-të

Sipas planit dhe programit mësimor të klasës së 6-të, i hartuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë në vitin 2003, programi i lëndës mësimore të Teknologjisë me TIK-un realizohet me 1 orë në javë, përkatësisht me 37 orë në vit. Nga 37 orë të kësaj lënde mësimore, 32 orë janë paraparë për kategoritë mësimore që përfaqësojnë teknologjinë, kurse 5 orë janë ndarë për kategorinë mësimore që përfaqëson TIK-un: Teknologjia e informimit dhe komunikimit. Nga kjo kategori mësimore janë paraparë që të mësohen këto tema:

- Pjesët përbërëse kryesore të sistemit kompjuterik;
- Programet për përpunimin e tekstit dhe vizatimeve;
- Lidhjet ndërmjet programeve të ndryshme.

Rezultati kryesor i pritur nga përvetësimi i kësaj përmbajtje programore është: Nxënësi të dijë të përdorë kompjuterin për punimin e dokumentacionit teknik. Mirëpo, me këtë fond të orëve dhe me këtë përmbajtje të lëndës është vështirë të sigurohet ky rezultat, sidomos kur kihet parasysh se nxënësit për herë të parë, në mënyrë të organizuar dhe institucionale, fillojnë të mësojnë për përdorimin e kompjuterit.

5.2.2. Programi i Teknologjisë me TIK në klasën e 7-të

Programi i lëndës mësimore të Teknologjisë me TIK-un, sipas planit dhe programit mësimor të klasës së 7-të, i hartuar nga Ministria e

Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë në vitin 2004, realizohet me 1 orë në javë, përkatësisht me 37 orë në vit. Nga 37 orë të kësaj lënde mësimore, 33 orë janë paraparë për kategoritë mësimore që përfaqësojnë teknologjinë, kurse 4 orë janë ndarë për kategorinë mësimore që përfaqëson TIK-un: njohuri të përgjithshme për teknologjinë e komunikimeve. Nga kjo kategori mësimore janë paraparë që të mësohen këto tema:

- a) Teknologjia e komunikimit telefonik – telefonia fikse dhe mobile;
- b) Teknologjia e komunikimit radiofonik;
- c) Teknologjia e komunikimit televiziv dhe
- d) Teknologjia e komunikimit përmes kompjuterit (internetit).

Nga kjo pasqyrë, shihet se në programin mësimor të klasës së 7-të përvetësimi të njohurive dhe aftësive të TIK-ut i është lënë fare pak hapësirë.

5.2.3. Programi i Teknologjisë me TIK në klasën e 8- të

Sipas planit dhe programit mësimor të klasës së 8-të, i hartuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë në vitin 2005, programi i lëndës mësimore të Teknologjisë me TIK realizohet me 1 orë në javë, përkatësisht me 37 orë në vit. Nga 37 orë të kësaj lënde mësimore, 29 orë janë paraparë për kategoritë mësimore që përfaqësojnë teknologjinë, kurse 8 orë ose 21.62% janë ndarë për kategorinë mësimore që përfaqëson TIK-un: Komunikimi me kompjuter. Nga kjo kategori mësimore janë paraparë që të mësohen dy nënkategori mësimore: 1. Përmbajtja e Internetit dhe 2. Programi Internet Explorer.

Në nënkategorinë Përmbajtja e Internetit, programi i klasës së 8-të përfshin këto përmbajtje programore:

- Posta elektronike; Newsgroup;
- Word Wide Web-Webi;
- FTP (File Transfer Protocol);

- Chat; dhe Net Meeting.

Në nënkategorinë Programi Internetit Explorer, programi i klasës së 8-të përfshin këto përmbajtje programore:

- Startimi i programit;
- Adresa e Web-it;
- Pjesët strukturore të një Web-i – menytë, linket, kornizat, etj.;
- Veprimet kryesore: marrja e të dhënave nga interneti (download), kopjimi, shtypja, etj.
- Kërkimi i të dhënave sipas fjalëve kyçe (Search Engines, Google, etj.) dhe
- Hapja e adresës elektronike në Hotmail dhe Yahoo dhe shfrytëzimi i saj për komunikime (dërgimi i porosive, marrja e porosive, bashkëngjitja e dokumenteve kompjuterike një porosie (attachments), etj.

5.2.4. Programi i Teknologjisë me TIK në klasën e 9- të

Programi i lëndës mësimore të Teknologjisë me TIK, sipas planit dhe programit mësimor të klasës së 9-të, i hartuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë në vitin 2004, realizohet me 2 orë në javë, përkatësisht me 70 orë në vit. Nga 70 orë të kësaj lënde mësimore, 35 orë mësimore janë paraparë për kategoritë mësimore që përfaqësojnë teknologjinë, kurse 35 orë ose 50 % janë ndarë për kategorinë mësimore: Teknologjia e informimit dhe komunikimit (TIK).

Nga kjo kategori mësimore, programi parasheh që të mësohen këto nënkategori mësimore:

- a) Sistemet numerike;
- b) Njësia për sasinë e informatës dhe kodet;
- c) Sistemi kompjuterik;
- d) Hardueri;
- e) Softueri;
- f) Sistemi operativ;
- g) Programet aplikative.

Përmbledhje e analizës së pjesës programore të TIK-ut nga klasa e 6-të deri në klasën e 9-të

- Programi i teknologjisë së informimit dhe komunikimit nga klasa e 6-të deri në klasën e 9-të nuk siguron në masën e nevojshme kompetencat e nxënësve për përdorimin e kompjuterit në programet bazike;
- Fondi i orëve për përmbajtjet e TIK-ut në klasat 6,7 dhe 8 është minimal dhe nuk siguron zhvillimin e shkathtësive të nxënësve për përdorimin e kompjuterit,
- Fondi i orëve për përmbajtjet e TIK-ut në klasën e 9-të është në masë të kënaqshme, mirëpo përsëri nuk mbulon nevojat për zhvillimin e kompetencave të nxënësve për TIK-un në këtë moshë;
- Deri në klasën e 9-të mësohet vetëm programi aplikativ MS Word, kurse programet tjera, Ms Excel, MS PowerPoint etj., nuk mësohen fare në arsimin e mesëm të ulët, edhe pse janë në funksion të lëndëve të tjera, sidomos Ms PowerPoint, për prezantime dhe forma të tjera të vizualeizimit të përmbajtjeve mësimore në lëndë të ndryshme mësimore, si dhe Ms Excel në lëndën e Matematikës dhe të Fizikës;
- Një numër i konsiderueshëm i rezultateve të pritura mësimore më shumë janë dhënë në formë të deklaratave të synimeve sesa të rezultateve mësimore të matshme;
- Një numër i konsiderueshëm i pyetjeve të shtruara në tekste për nxënës më shumë promovojnë të nxënit teorik sesa atë praktik.

5.3. Përfshirja e TIK-ut në planet dhe programet mësimore nga klasa e 10-të deri në klasën e 12-të në gjimnaze

Për dallim prej arsimit të mesëm të ulët, në arsimin e mesëm të lartë – në gjimnaze, Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit mësohet si lëndë e veçantë. Në klasën e 10-të plani dhe programi i Teknologjisë së

Informimit dhe Komunikimit është i përbashkët për të gjitha drejtimit e gjimnazeve në Kosovë⁴⁸, kurse në klasat e tjera ndryshon, varësisht nga tipi i gjimnazit. Gjithashtu, në klasën e 10-të plani dhe programi mësimor i kësaj lënde është emërtuar Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit, kurse në klasat e tjera lënda mësimore është emërtuar Teknologjia me TIK-un, pavarësisht se tërë programi mësimor është TIK.

5.3.1. Programi i Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit në klasën e 10-të në gjimnaze

Programi i lëndës mësimore të TIK-ut, sipas planit dhe programit mësimor të të gjitha drejtimeve të gjimnazit në klasën e 10-të, i hartuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë në vitin 2004, realizohet me 2 orë në javë, përkatësisht me 74 orë mësimore në vit.

Sipas planit dhe programit zyrtar të klasës së 10-të, Teknologjia e Informimit dhe e Komunikimit - TIK është vazhdimësi dhe zgjerim i njohurive paraprake nga kjo fushë. Përveç zgjerimit të njohurive paraprake për TIK-un, në klasën e dhjetë nxënësit gjithashtu marrin dituri nga programi aplikativ për përpunim tabelar dhe grafik të të dhënave, mundësitë multimediale në sistemet kompjuterike, si dhe nga programi aplikativ për përgatitjen e prezantimeve. Pra, fushat kryesore të programit të TIK-ut në klasën e 10-të janë:

- Programi aplikativ për përpunim tabelar dhe grafik të të dhënave: Ms Excel (42 orë mësimore);
- Multimedia (10 orë mësimore);
- Programi aplikativ për përgatitjen e prezantimeve: Ms PowerPoint (14 orë mësimore);

⁴⁸ Në Republikën e Kosovës, aktualisht janë pesë drejtime të gjimnazeve: Gjimnazi matematikë–informatikë; Gjimnazi shoqëror; Gjimnazi filologjik; Gjimnazi i shkencave natyrore dhe Gjimnazi i përgjithshëm.

Korniza e programit përmban objektivat e veçanta, përmbajtjen programore, standardet e arritshmërisë, udhëzimet metodologjike dhe ndërlidhjet ndërlëndore.

5.3.2. Programi i Teknologjisë me TIK-un në klasën e 11-të në gjimnaze

Programi mësimor i Teknologjisë me TIK-un në klasën e 11-të realizohet me fond të ndryshëm të orëve, varësisht nga drejtimi i gjimnazit. Drejtimi Matematikë informatikë ka 3 orë në javë, drejtimet tjera si: Gjimnazi i përgjithshëm, natyror, shoqëror kanë nga 2 orë në javë, kurse Gjimnazi filologjik e ka vetëm 1 orë në javë. Plani dhe programi mësimor i Teknologjisë me TIK-un përfshin tri kategori mësimore, të cilat mësohen nga të gjitha drejtimet e gjimnazit, por me dallime në fondin e orëve mësimore.

Nr.	Kategoritë kryesore mësimore	Gjinnazi i përgjithshëm	Gjinnazi matematikë-informatikë	Gjinnazi i shkencave natyrore	Gjinnazi shoqëror	Gjinnazi filologjik
1	Njohuri të përgjithshme	1.1 Konceptet bazike 1.2 Mbrojtja dhe siguria e shënimeve (8 orë)	1.1 Konceptet bazike 1.2 Mbrojtja dhe siguria e shënimeve (8 orë)	1.1 Konceptet bazike 1.2 Mbrojtja dhe siguria e shënimeve (8 orë)	1.1 Konceptet bazike 1.2 Mbrojtja dhe siguria e shënimeve (8 orë)	1.1 Konceptet bazike 1.2 Mbrojtja dhe siguria e shënimeve (8 orë)
2	Hardveri	2.1 Struktura e sistemit kompjuterik (4 orë)	2.1 Struktura e sistemit kompjuterik (4 orë)	2.1 Struktura e sistemit kompjuterik (4 orë)	2.1 Struktura e sistemit kompjuterik (4 orë)	2.1 Struktura e sistemit kompjuterik (4 orë)
3	Softveri	3.1 Interneti, MS Office dhe Interneti 3.2 Menaxhimi i mesazheve dhe i informacioneve (MS Outlook) 3.3 Programi për krijimin e bazës së të dhënave (Ms Access) (62 orë)	3.1 Interneti, MS Office dhe Interneti 3.2 Menaxhimi i mesazheve dhe i informacioneve (MS Outlook) 3.3 Programi për krijimin e bazës së të dhënave (Ms Access) (99 orë)	3.1 Interneti, MS Office dhe Interneti 3.2 Menaxhimi i mesazheve dhe i informacioneve (MS Outlook) 3.3 Programi për krijimin e bazës së të dhënave (Ms Access) (62 orë)	3.1 Interneti, MS Office dhe Interneti 3.2 Menaxhimi i mesazheve dhe i informacioneve (MS Outlook) 3.3 Programi për krijimin e bazës së të dhënave (Ms Access) (62 orë)	3.1 Interneti, MS Office dhe Interneti 3.2 Menaxhimi i mesazheve dhe i informacioneve (MS Outlook) (25 orë)

Tabela 8. Programi i TIK-ut në klasën e 11-Të, specifikuar në kategoritë kryesore, nënkategoritë mësimore dhe fondit të orëve mësimore në drejtimet e gjimnazit.

Siç shihet në tabelë, dallimi kryesor qëndron në programin e Gjimnazit filologjik, për kategorinë kryesore mësimore softueri. Vetëm në këtë drejtim të gjimnazit nuk mësohet Ms Access, si nënkategori e softuerit.

5.3.3. Programi i Teknologjisë me TIK-un në klasën e 12-të në gjimnaze

Programi mësimor i Teknologjisë me TIK-un në klasën e 12-të ka dallime në fondi javor i orëve mësimore të klasës së 11-Të. Në gjimnazin Matematikë–informatikë, programi i TIK-ut e realizon me 4

orë në javë, në Gjinnazin shoqëror 1 orë në javë, në Gjinnazin filologjik, në Gjinnazin e përgjithshëm dhe Gjinnazin natyror me 2 orë në javë.

Nr.	Kategoritë kryesore mësimore	Gjinnazi i përgjithshëm	Gjinnazi matematikë-informatikë	Gjinnazi i shkencave natyrore	Gjinnazi shoqëror	Gjinnazi filologjik
1	Interneti dhe www Algoritmet (vetëm në gjim. Mat.-inf.)	- Puna me internet dhe me www - HTML - Krijimi i Web faqeve në Word (10 orë)	Algoritmet – njohuri themelore - Llogaritja e Shumës/ Prodhimit/ Faktorielit Degëzimet/Kushtet Kombinimet – Shumë/Faktoriel/Prodhim Vargjet (vektorët dhe matricat) Gjetja e anëtarëve të caktuar Sortimi Funksionet Detyra matematikore (Seritë e pafundme/ Determinanta/Integrali) (44 orë)	- Puna me internet dhe me www - HTML - Krijimi i Web faqeve në Word (8 orë)	- Puna me internet dhe me www - HTML - Krijimi i Web faqeve në Word (6 orë)	- Puna me internet dhe me www - HTML - Krijimi i Web faqeve në Word (8 orë)
2	Front Page Programi në C++ (vetëm në gjim. Mat.-inf.)	Hyrje – Prezantimi i Front-Page-it Krijimi i Web faqes Krijimi i Web prezantimit (Web Sajt-it) Puna me Web faqe Formatizimi i i Web faqes Insertimi i figurave dhe puna me figura Puna me	Hyrje në programim – Gjuhët programuese Hyrje në C++ - Programi i parë në C++ Variablat/ Deklarimi/ Inicializimi/Konstantet Operatorët – Prioriteti Direktivat preprocesorike Leximi dhe shtypja (Hyrja/Dalja) Kushtet/Degëzimet Urdhrat Sëitch dhe GoTo Unazat Funksionet Dukshmëria e	Hyrje – Prezantimi i Front-Page-it Krijimi i Web faqes Krijimi i Web prezantimit (Web Sajt-it) Puna me Web faqe Formatizimi i i Web faqes Insertimi i figurave dhe puna me figura Puna me	Hyrje – Prezantimi i i Front-Page-it Krijimi i Web faqes -Krijimi i Web prezantimit (Web Sajt-it) Puna me Web faqe Formatizimi i Web faqes Insertimi i figurave dhe puna	Hyrje – Prezantimi i Front-Page-it Krijimi i Web faqes Krijimi i Web prezantimit (Web Sajt-it) Puna me Web faqe Formatizimi i i Web faqes Insertimi i figurave dhe puna me figura Puna me

	linqe (lidhje) dhe pamja e navigimit Krijimi i tabelave dhe puna me tabela Puna me korniza Krijimi i formularëve Formatizim i përmes CSS (Cascading Style Sheets) Menaxhimi i Web faqeve Publikimi i Web faqeve Përdorimi i Web komponentëve (64 orë)	variablave Përcjellja e vlerave – sipas vlerës dhe sipas referencës Argumentet standardë dhe mbingarkimi i funksioneve Hyrja/Dalja e pajisjeve dhe karaktereve Gabimet - Përrjashtimet dhe manipulimi i gabimeve Vargjet (vektorët dhe matricat) Pointerët Strukturat/Vargjet e strukturave Fajllat sekuencialë Fajllat me qasje të rastit Hyrje në programimin e orientuar në objekte (88 orë)	linqe (lidhje) dhe pamja e navigimit Krijimi i tabelave dhe puna me tabela Puna me korniza Krijimi i formularëve Formatizim i përmes CSS (Cascading Style Sheets) Menaxhimi i Web faqeve Publikimi i Web faqeve Përdorimi i Web komponentëve (58 orë)	me figura Puna me linqe (lidhje) dhe pamja e navigimit Krijimi i tabelave dhe puna me tabela Puna me korniza Krijimi i formularëve Puna me korniza Krijimi i formularëve ve Menaxhimi i Web faqeve (27 orë)	linqe (lidhje) dhe pamja e navigimit Krijimi i tabelave dhe puna me tabela Puna me korniza Krijimi i formularëve Formatizim i përmes CSS (Cascading Style Sheets) Menaxhimi i Web faqeve Publikimi i Web faqeve - Përdorimi i Web komponentëve (58 orë)
--	--	---	--	---	---

Tabela 9. Programi i TIK-ut në klasën e 12-të, specifikuar në kategoritë kryesore, nënkategoritë mësimore dhe fondin e orëve mësimore në drejtimit e gjimnazit.

Sic shihet në tabelë, dallimi kryesor qëndron në programin e Gjimnazit matematikë - informatikë, për faktin se në këtë drejtim të gjimnazit ofrohet përmbajtje tjetër mësimore nga TIK-u në krahasim me drejtimit të tjera të gjimnazit. Dallim tjetër në mes të drejtimeve arsimore në gjimnaz vërehet edhe në fondin e orëve në dispozicion për lëndën e TIK-ut. Megjithëse fondi i orëve në Drejtimin shoqëror është për 50 % më i vogël, kjo nuk vërehet në përmbajtjen mësimore të lëndës dhe jep për të kuptuar se në këtë drejtim nxënësit janë shumë më të ngarkuar

me përmbajtje mësimore, në raport me numrin e orëve mësimore në dispozicion.

5.3.4. Programi i Teknologjisë së Informacionit në klasën e 13-të në gjimnaze

Nga gjimnaze, vetëm drejtimi i përgjithshëm përfshihet në klasën e 13-të. Programi mësimor i Teknologjisë së Informacionit në klasën e 13-të në përmbajtje është afërsisht i njëjtë me programin e klasës së 12-të në drejtimin Matematikë-informatikë, por dallon në fond të orëve në dispozicion, ku në këtë klasë, programi është paraparë që të realizohet me 2 orë në javë.

N r.	Kategoritë kryesore mësimore	Gjimnazi i përgjithshëm
1	Algoritmet	- Algoritmet – njohuri themelore; Llogaritja e Shumës/ Prodhimit/ Faktorielit; Degëzimet/Kushtet; Kombinimet – Shumë/Faktoriel/Prodhim; Vargjet (vektorët dhe matricat); Gjetja e anëtarëve të caktuar; Sortimi; Funksionet; (28 orë)
2	Programimi në C++	- Hyrje në programim – Gjuhët programuese; Hyrje në C++ - Programi i parë në C++; Variablat/ Deklarimi/ Inicializimi/Konstantet; Operatorët – Prioriteti; Direktivat preprocesorike; Leximi dhe shtypja (Hyrja/Dalja); Kushtet/Degëzimet; Urdhrrat Sëitch dhe GoTo; Unazat; Funksionet; Dukshmëria e variablave; Përcjellja e vlerave – sipas vlerës dhe sipas referencës; Argumentet standarde dhe mbingarkimi i funksioneve; Hyrja/Dalja e pajisjeve dhe karaktereve; Gabimet - Përrjashtimet dhe manipulimi i gabimeve; Vargjet (vektorët dhe matricat); Pointerët; (36 orë)

Tabela 10. Programi i TIK-ut në klasën e 13-Të, specifikuar në kategori kryesore, nënkategori dhe fond të orëve.

Përmbledhje e analizës së programeve të TIK-ut nga klasa e 10-të deri në klasën e 13-të në gjimnaze

- Për dallim nga arsimi i mesëm i ulët, në nivelin e arsimit të mesëm të lartë – në gjimnaze, Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit mësohet si lëndë e veçantë;
- Plani dhe programi i TIK-ut në klasën e 10-të është i përbashkët për të gjitha drejtimet e gjimnazeve në Kosovë;
- Plani dhe programi mësimor i kësaj lënde në klasën e 10-të është emërtuar *Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit*, kurse në klasat e tjera lënda mësimore është emërtuar *Teknologjia me TIK*, pavarësisht se tërë programi mësimor është TIK;
- Ndryshimet e programit të TIK-ut, që ekzistojnë ndërmjet drejtimeve, nuk sigurojnë arritjen e kompetencave minimale për përdorimin e kompjuterit nga të gjithë nxënësit e drejtimeve specifike të gjimnazeve;
- Duke pasur parasysh vitet kur janë hartuar programet e TIK-ut dhe zhvillimet e reja në fushën e TIK-ut, shohim se programet ekzistuese nuk përfaqësojnë trendët aktualë të zhvillimeve në fushën e TIK-ut;
- Një numër i konsiderueshëm i rezultateve të pritura mësimore më shumë janë dhënë në formë të deklaratave, të synimeve, sesa të rezultateve mësimore të matshme;
- Përmbajtjet e TIK-ut në tekstet në shfrytëzim nuk prezantojnë në masë të duhur zhvillimet në fushën e TIK-ut;
- Një numër i konsiderueshëm i pyetjeve të shtruar në tekste për nxënës më shumë promovojnë të nxënit teorik sesa atë praktik.

5.4. Përfshirja e TIK-ut në planet dhe programet mësimore nga klasa e 10-të deri në klasën e 12-të në shkolla profesionale (profile dhe lëmi profesionale)

Programi i Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit në profilet dhe fushat profesionale të shkollave profesionale në Kosovë dallon nga drejtimet e gjimnazeve. Programet i TIK-ut në shkollat profesionale janë hartuar nga MASH-i dhe partnerët mbështetës në zhvillimin e arsimit profesional, si GTZ (tani GIZ), KOSVET, IEME, etj. Rishikimi i tyre është bërë në vitin 2008/2009, sipas modelit MASHT – IEME – GTZ.

Modeli kurrikular D :MASHT-IEME –GTZ (I rishikuar)				
Programet që kanë filluar të zbatohen në shkollat profesionale në vitin shkollor 2008-2009				
Zbatimi-2008-2009 për klasën e 10-të				
2000-2010 për klasën e 11-të				
2010-2011 për klasën e 12-të				
	Profili profesional	Shkalla-1		Shkalla-2
		Klasa e 10-të	Klasa e 11-të	Klasa e 12-të
		TIK-orë në javë	TIK-orë në javë	TIK-orë në javë
I	Lëmi: Ndërtimtari			
1	Arkitekturë	TIK-2 ⁴⁹	TIK-2, CAD ⁵⁰ -2 CAD 2d CAD – Dizanjimi me anë të kompjuterit Punimi i një projekti të thjeshtë me CAD 2D-3D 2D(dy dimensional)/3D(tre dimensional)	TIK-2, CAD-2 CAD 2d-3D

⁴⁹ TIK -2 prezanton fondin e orëve të lëndës mësimore të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit për një javë mësimore.

⁵⁰ CAD-2 tregon lëndën mësimore Vizatimi me kompjuter.

2	Gjeodezi	TIK-2	TIK-2	TIK-2
3	Ndërtimtar	TIK-2	TIK-2, Auto-CAD-1	TIK-2, Auto-CAD-1
II	Lëmi: Tekstil			
4	Tjerrje	TIK-2	TIK-2	TIK-2, CAD-2
5	Vektari,	TIK-2	TIK-2	TIK-2, CAD-2
6	Teknik i thurjes	TIK-2	TIK-2	TIK-2, CAD-2
7	Konfeksion	TIK-2	TIK-2	TIK-2 CAD-1
III	Lëmi: Metalurgji- Gjeologji , Kimi teknologji			
8	Përpunimi i metaleve	TIK-2	TIK-2	TIK-2
9	Përfitimimi i metaleve	TIK-2	TIK-2	TIK-2
10	Gjeologji	TIK-2	-	-
11	Miniera	TIK-2	TIK-2	TIK-2, Cad- 2
14	Laborant të shkencave të natyrës	TIK-2	TIK-2	TIK-2
15	Teknologji kimike	TIK-2	TIK-2	TIK-2
IV	Lëmi: Grafika			
16	Grafik i libërlidhjes	TIK-2	TIK-1, DG-2 Dizajn grafik (DG)	TIK-1, DG-2
17	Grafik i shtypit	TIK-2	TIK-1 DG ⁵¹ -2	TIK-1 DG-2
18	Grafik i përgatitjes grafike	TIK-2	TIK-1 DG-2	TIK-1 DG-2
19	Grafik i mediave	TIK-2	TIK-1, DG-2	TIK-1, DG-5
V	Lëmi: Komunikacion			
21	Lëvizja e trenave	TIK-2	TIK-2	TIK-2
22	Tërheqja e trenave	TIK-2	TIK-2	TIK-2
23	Transporti rrugor	TIK-2	TIK-2	TIK-2
VI	Lëmi: Hoteleri dhe turizëm			

⁵¹ DG – Dizajni grafik

24	Asistent hoteli	TIK-2	TIK-2	-
25	Asistent restoranti	TIK-2	TIK-2	-
26	Gjellëbërës	TIK-2	TIK-2	-
27	Pastiçeri	TIK-2	TIK-2	-
28				
29	Asistent turistik	TIK-2	TIK-2	-
VII	Lëmi: Shëndetësi			
30	Asistent i stomatologjisë	TIK-2	TIK-2	TIK-2
31	Teknik i dhëmbëve	TIK-2	TIK-2	TIK-2
32	Teknik i farmacisë	TIK-2	TIK-2	TIK-2
33	Ndihmës infermier i përgjithshëm Ndihmës infermier i mamisë Ndihmës infermier i pediatriisë	TIK-2	TIK-2	TIK-2
VIII	Lëmi: Makineri			
34	Mekanik i makinave	TIK-2	TIK-2	TIK-2
35	Saldator	TIK-2	TIK-2	TIK-2
36	Operator i prodhimit	TIK-2	TIK-2	TIK-2
37	Vegëltar	TIK-2	TIK-2	TIK-2
IX	Lëmi: Elektroteknikë			
38	Mekatronikë	TIK-2	TIK-2 BP-3 Bazat e programimit (BP) Teknika e rregullimit logjik që programohet (PLC-CAX) Elektronikë digjitale (ED)	TIK-2, ED-2 CAX-PLC-2
39	Energjetikë	TIK-2	TIK-2	TIK-2
40	Informatikë	TI-2	ED-A-APC Sistemet operative (SO) Gjuhët	SO-RRK

			programuese (APC) Algoritme(A) Rrjeta kompjuterike(RR K)	
41	Teknik i Komunikimeve Audio dhe Video	TIK-2	TIK-2	TIK-2
42	Makina elektrike	TIK-2	TIK-2	TIK-2
43	Telekomunikacion	TIK-2	TIK-2	TIK-2 ED-ST-SK- SO-2 Sisteme transmetuese Sisteme komutuese Sisteme operative
44	Komunikacion PT	TIK-2 RRD-1 Rrjeta dhe digjitalizim Shfrytëzimi i rrjetit IP Shfrytëzimi i telefonisë mobile dhe Wireless	TIK-1, Rr IP-1 ËRL-1	
X	Lëmi: Bujqësi			
45	Lavërtari-perimtari	TIK-2	TIK-2	TIK-2
46	Pemëtari-Vreshtari	TIK-2	TIK-2	TIK-2
47	Teknologji ushqimore,	TIK-2	TIK-2	TIK-2
48	Pylltari	TIK-2	TIK-2	TIK-2
49	Veterinari	TIK-2	TIK-2	TIK-2
XI	Lëmi: Administratë			
51	Asistent i administratës	TIK-2	TIK-2	TIK-2
52	Asistent juridik	TIK-2	TIK-2	TIK-2

53	Organizator i aktivitet. Shoqërore	TIK-2	TIK-2	TIK-2
XII	Lëmi: Ekonomi			
55	Banka dhe Sigurime	TIK-2	TIK-2	TIK-2
56	Kontabilist	TIK-2	TIK-2	TIK-2
57	Shpedicion dhe logjistike	TIK-2	TIK-2	TIK-2
58	Tregtar me pakicë dhe shumicë	TIK-2	TIK-2	TIK-2

Tabela 11. Plani i rishikuar i orëve të TIK-ut sipas fushave dhe profileve dhe sipas klasave.

Analiza e përgjithshme e programeve të TIK-ut sipas klasave në shkollat profesionale për përafrimin e programeve të TIK-ut me modulet e ECDL-së sjell këto përfundime:

- Në klasën e 10-të, programi mësimor i TIK-ut ka përputhje të përafërt me modulet e programit ‘ECDL-Core’;
- Në klasën e 11-të, programi mësimor i TIK-ut ka përputhje të pjesshme me disa module të programit ‘ECDL-Core’;
- Në klasën e 12-të, programi mësimor i TIK-ut ka përputhje minimale me disa module të programit ‘ECDL-Core’;
- Në klasën e 13-të, programi mësimor i TIK-ut ka përputhje të pjesshme me modulet e programit ‘ECDL-Core’;
- Në shkollat profesionale ka mungesë të teksteve të TIK-ut.

VI. OPINIONET E NXËNËSVE PËR PËRFITIMET NGA TIK-U DHE KOMPETENCAT PËR PËRDORIMIN E KOMPJUTERIT

Me mostrën e nxënësve që kanë përfunduar maturën dhe nxënësve të klasave të 10-ta dhe të 12-ta të gjimnazeve dhe shkollave profesionale të Kosovës është realizuar një anketë, me qëllim të marrjes së informacioneve, opinioneve të tyre për aspektet në vijim:

1. Informimi me përmbajtjet e programeve kryesore që ofron TIK-u;
2. Mënyrat e ngritjes së kompetencave për përdorimin e kompjuterit;
3. Zbatimi i TIK-ut në mësim;
4. Vetëvlerësimi i nxënësve për nivelin e kompetencave të tyre për përdorim të kompjuterit;
5. Përceptimi i nxënësve për nivelin e kompetencave të mësimdhënësve për përdorim të TIK-ut në mësim.

Rezultatet e përfituara nga analiza e pyetësorëve të realizuar me nxënës për këto çështje janë paraqitur në vijum, specifikuar në pesë aspektet e përmenduar më lart.

6.1. Informimi me përmbajtjen e programeve kryesore që ofron TIK-u dhe mënyrat e fitimit të kompetencave për përdorimin e kompjuterit

Ndër faktorët më me rëndësi për arritjen e kompetencave për përdorimin e kompjuterit është niveli i informimit të nxënësve me programet kryesore që ofron TIK-u dhe interesimi i tyre për të shfrytëzuar këto programe. Prandaj, pyetja e parë e adresuar në pyetësorin e anketës është lidhur me informimin e tyre për programet kryesore që ofron TIK-u.

Rezultatet e fituara nga pyetësorët janë mjaft mbresëlënëse, ku 87 % e mostrës së anketuar janë shprehur se janë shumë ose mesatarisht të informuar për programet që ofron TIK-u, ndërsa 13 % e tyre pohojnë se janë pak ose aspak të informuar për këto programe.

Sa jeni të informuar me përmbajtjen e programeve kryesore që ofron TIK-u (Word, Excel, PowerPoint, Internet, etj)?	Numri	%
Shumë	31	16
Mesatarisht	142	71
Pak	23	12
Aspak	2	1
Gjithsej:	198	100%

Tabela 12. Përgjigjet e nxënësve për informimin e tyre me përmbajtjet e programit që ofron TIK-u

Bazuar në rezultatet e hulumtimit të përmbajtjeve të programeve që ofron lënda mësimore Teknologji me TIK-un, jemi nxitur që të marrim informacione të drejtpërdrejta nga nxënësit se në cilat mënyra ata kanë përfituar/zhvilluar njohuritë, kompetencat e tyre, për përdorimin e kompjuterit. Përgjigjet e fituara për mënyrat, vendet, institucionet ku nxënësit i kanë përfituar/zhvilluar kompetencat e tyre për përdorimin e kompjuterit, të specifikuar në numrin e atyre që janë përgjigjur, janë pasqyruar në tabelën në vijim.

Fitimi i aftësive dhe shkathtësitë kryesore për përdorimin e kompjuterit	Ndërlidhja me pohimet për informimin që ofrojnë programet e TIK-ut				
	Aspak	Pak	Mesatarisht	Shumë	Gjithsej
Në internet-kafe	1	1	10	2	14
Në kurse për përdorim të kompjuterit	0	0	1	4	5
Në shkollë	0	9	58	17	84
Në shtëpi dhe me përkrahje të tjerëve	1	7	32	2	42
Në shtëpi dhe në mënyrë të pavarur	0	6	37	4	47
<i>Tjetër (shëno)</i> - në punë	0	0	0	2	2
<i>Tjetër (shëno)</i> - në kompaninë kompjuterike DAXA electronic	0	0	1	0	1
<i>Tjetër (shëno)</i> - në shkollë, shtëpi, internet-kafe	0	0	2	0	2
<i>Tjetër (shëno)</i> - në shkollë dhe shtëpi	0	0	1	0	1
Totali	2	23	142	31	198

Tabela 13. Përgjigjet e nxënësve për mënyrat e ngritjes së kompetencave të tyre për përdorimin e kompjuterit

Të dhënat nga tabela tregojnë se nxënësit, në masën më të madhe, apo 45 % e tyre i kanë përvetësuar shkathtësitë e kompjuterit në shtëpi, në mënyrë të pavarur dhe me përkrahjen e anëtarëve të tjerë të familjes, në shkollë 42 %, në internet-kafe 7 %, në kurse për përdorim të kompjuterit⁵² 2.52 % dhe në forma të tjera 3 % e nxënësve.

⁵² Nxënësit e klasës së 12-të dhe nxënësit që e kanë përfunduar maturën kanë pohuar se kanë ndjekur kurse të informatikës për përdorimin e kompjuterit.




Fig.3. Përfitimi i aftësive dhe shkathtësive kryesore për përdorim të kompjuterit

Është me rëndësi të theksohet se nga 100 % e nxënësve që kanë pohuar se vijojnë kurse jashtëshkollore të informatikës, 80 % e tyre kanë pohuar se janë shumë mirë të informuar me përmbajtjet e programeve që ofron TIK-u dhe 20 % e nxënësve që kanë pohuar se shkathtësitë kryesore të përdorimit të kompjuterit i kanë fituar në shkollë, kanë pohuar gjithashtu se janë shumë të informuar me përmbajtjet e programeve që i ofron TIK-u, pjesa tjetër janë mesatarisht ose pak të informuar. Ndërsa, vetëm 6% e nxënësve, prej 100% që kanë pohuar për përfitimin e njohurive dhe shkathtësive për përdorimin e kompjuterit në shtëpi, në mënyrë të pavarur dhe me përkrahjen e anëtarëve të tjerë të familjes, kanë pohuar gjithashtu se janë shumë mirë të informuar me përmbajtjet e programeve që i ofron TIK-u, pjesa tjetër e nxënësve janë mesatarisht ose pak të informuar.

6.2. Përfshirja në kurse jashtëshkollore dhe internet-kafe për përdorimin e kompjuterit

Asnjë nxënës i klasës së 10-të nuk është përgjigjur se ka ndjekur kurse jashtëshkollore për të arritur kompetencat e përdorimit të kompjuterit, kurse 12 % nga 100 % të nxënësve të anketuar të klasës së 12-të kanë pohuar se kanë ndjekur nga një kurs jashtëshkollor, me qëllim të përfitimit të kompetencave për përdorimin e kompjuterit.

Për dallim nga nxënësit e klasës së 12-të, 39 % prej 100 % të nxënësve të anketuar që kanë mbaruar maturën kanë pohuar se kanë ndjekur nga një kurs jashtëshkollor me qëllim të përfitimit të kompetencave për përdorimin e kompjuterit.

6.2.1. Qëllimet e përdorimit të kompjuterit në internet-kafe

Kur nxënësit janë pyetur se a keni frekuentuar internet-kafetë me qëllim të përdorimit të kompjuterit, me PO janë përgjigjur 9 % e nxënësve të klasës së 10-të , 18 % e nxënësve të klasës së 12-të dhe 44 % e nxënësve që e kanë mbaruar maturën .

Qëllimi:	Nxënësit e klasës së 10-të dhe 12-të			Nxënësit që kanë mbaruar maturën		
	Nr	%	Nr. i nxënësve që janë përgjigjur se i frekuentojnë internet-kafetë	Nr	%	Nr. i nxënësve që janë përgjigjur se i frekuentojnë internet-kafetë
Për të përgatitur detyra mësimore	3	11,54	26	16	35,56	44
Për hulumtimin e materialeve të lidhura me mësimin	2	7,69	26	18	40,9	44
Për të përgatitur materiale për prezantim në klasë	4	15,38	26	9	20,45	44
Për komunikim në messenger	12	46,15	26	13	29,55	44
Për Facebook	10	38,46	26	10	22,73	44
Për komunikim me e-mail	9	34,62	26	11	25,00	44

Tabela 14. Përgjigjet e nxënësve për qëllimet e përdorimit të kompjuterit gjatë frekuentimit të tyre në internet-kafe.

Siç shihet nga tabela paraprake, nga 27 % e nxënësve të klasës 10-të dhe të klasës së 12-të, të përfshirë në anketim, e që kanë pohuar se i frekuentojnë internet-kafetë, 1 prej tyre nuk ka dhënë përgjigje për qëllimet e përdorimit të kompjuterit në internet-kafe, ndërsa disa të tjerë janë përgjigjur për më shumë se një qëllim të frekuentimit në internet-kafe. Përqindja më e madhe e tyre janë përgjigjur se i frekuentojnë në internet-kafe për komunikim me messenger (46 % e nxënësve), për komunikim në facebook (38 % e nxënësve) dhe për komunikim me e-mail (34 %).

Ndërsa, nga 44 % e nxënësve të anketuar që kanë mbaruar maturën dhe që kanë pohuar se i frekuentojnë internet-kafetë, përqindja më e madhe e tyre kanë deklaruar se atë bëjnë për qëllime të përgatitjes së detyrave mësimore dhe për të hulumtuar materiale mësimore. Ne supozojmë se këto të dhëna (e që dallojnë shumë nga të dhënat e nxënësve të klasës së 10-të dhe 12-të (shih tabelën nr. 10) janë rezultat i ndikimit të nevojës së plotësimit dhe dërgimit të formularëve përmes internetit për regjistrim në fakultet.

6.2.2. Qëllimi i përdorimit të kompjuterit në shtëpi

Në vazhdim nxënësit janë pyetur edhe për qëllimet e përdorimit të kompjuterit në shtëpi . Nxënësit kanë dhënë përgjigje të ndryshme në këtë pyetje, rezultatet e përpunuara janë paraqitur në tabelën në vijim.

Qëllimi:	Nxënësit e klasës së 10-të dhe 12-të			Nxënësit që kanë mbaruar maturën		
	Nr	%	Janë përgjigjur	Nr	%	Janë përgjigjur
Për të përgatitur detyra mësimore	43	46,24	93	42	44,68	94
Për hulumtimin e materialeve të lidhura me mësimin	59	63,44	93	61	64,89	94
Për të përgatitur materiale për prezantim në klasë	29	31,18	93	25	26,59	94
Për komunikim në messenger	50	53,76	93	41	43,61	94
Për facebook	48	51,61	93	36	38,30	94
Për komunikim me e-mail	31	33,33	93	31	32,97	94
Për lojëra	6	6,45	93	6	6,38	94

Tabela 15. Përgjigjet e nxënësve për qëllimet e përdorimit të kompjuterit në shtëpi.

Për dallim prej qëllimeve të përdorimit të kompjuterit në internet-kafe, përdorimi i kompjuterit në shtëpi, sipas pohimit të nxënësve, nuk ka dallime të dukshme në mes të nxënësve të anketuar që aktualisht janë në klasat e 10-të dhe 12-të dhe nxënësve që kanë mbaruar maturën në qershor të vitit 2011. Dallimet më të theksuara janë në shpeshësinë e përdorimit të messengerit dhe facebook-ut, ku nxënësit e klasës së 10-të dhe të 12-të pohojnë se e përdorin kompjuterin e tyre për këto dy qëllime me shumë se nxënësit që kanë mbaruar maturën. Qëllimi i përdorimit të kompjuterit në shtëpi për lojëra ka bashkuar përqindjen e njëjtë të nxënësve (6.40 %) të anketuar të klasës së 10-të, 12-të dhe që kanë përfunduar maturën, që kanë pohuar se e përdorin kompjuterin në shtëpi edhe për këtë qëllim.

6.3. Zbatimi i teknologjisë së informimit dhe komunikimit në mësim

Për të marrë përgjigje më të plotë për ndikimin e shkollimit në plotësimin e kompetencave të nxënësve për përdorimin e kompjuterit, në pyetësonin e nxënësve kemi adresuar disa pyetje për zbatimin e teknologjisë së informimit dhe komunikimit në mësim.

A është përdorur/zbatuar teknologjia (TIK) në kuadër të mësimin në klasën tuaj?

Mbi gjysma e nxënësve (56 %) se vetëm ndonjëherë është zbatuar TIK-u në kuadër të mësimin në klasat e tyre, apo fare nuk është përdorur TIK-u në mësim. Pjesa tjetër e nxënësve të anketuar (44 %) pohojnë se shumë shpesh dhe shpesh është përdorur TIK-u në kuadër të mësimin në klasat e tyre. Tabela në vijim pasqyron detajet e përgjigjeve të nxënësve të klasave 10-të dhe 12-të, si dhe nxënësve që kanë mbaruar maturën.

Shpeshtësia:	Nxënësit e klasës së 10-të dhe 12-të		Nxënësit që kanë mbaruar maturën	
	Numri	%	Numri	%
Shumë shpesh	13	13,40	16	16,16
Shpesh	23	23,71	34	34,34
Ndonjëherë	46	47,42	43	43,43
Nuk është përdor fare	15	15,46	6	6
Gjithsej:	97	98,98	99	99

Tabela 16. Përgjigjet e nxënësve për zbatimin e TIK-ut në kuadër të mësimin.

6.3.1. Në cilat lëndë mësimore është bërë përpunimi i teksteve me programin Word në kuadër të mësimin në klasën tuaj?

Për zbatimin e programeve të TIK-ut në kuadër të mësimin, në pyetësorin e anketës realizuar me mostrën e nxënësve kemi adresuar pyetje për zbatimin e Word-it në shkrimin e teksteve gjatë mësimin dhe për shfrytëzimin e programit të PowerPoint-it gjatë prezantimeve në mësim. Pyetjet e adresuara janë dhënë me mundësi të përgjigjes me më shumë se një alternativë.

Lëndët:	Nxënësit e klasës së 10-të dhe 12-të		Nxënësit që kanë mbaruar maturën	
	Nr	%	Nr	%
Në lëndën e informatikës	75	76,53	89	89
Në lëndët gjuhësore	16	16,33	3	3
Në lëndët shkencore	13	13,27	4	4
Në lëndët e artit	1	1	1	1
Në lëndët tjera	3	3	3	3
Nuk është përdorur fare	14	14,29	8	8

Tabela 17. Përgjigjet e nxënësve për përpunimin e teksteve në kuadër të mësimin në klasat e tyre, me programin e Word-it.

Të dhënat nga tabela tregojnë se përpunimi i teksteve me programin Word, në kuadër të mësimin bëhet në lëndën e informatikës (76 % përkatësisht 89 %). Nxënësit e klasave të 10-ta dhe klasave të 12-ta të anketuar (rreth 15 % e tyre) pohojnë se përpunimi i teksteve me programin Word përdoret edhe në lëndët gjuhësore dhe shkencore.

6.3.2. Në cilat lëndë mësimore është përdorur programi PowerPoint për prezantime në mësim?

Për dallim nga programi Word, programi PowerPoint është përdorur më pak në klasën e 10-të dhe 12-të, kurse është përdorur përafërsisht njëjtë në klasat e nxënësve që kanë përfunduar maturën. Këtë e kanë pohuar 41 % e nxënësve të anketuar të klasave të 10-ta dhe 12-ta.

	Nxënësit e klasës së 10-të dhe 12-të		Nxënësit që kanë mbaruar maturën	
	Nr	%	Nr	%
Në lëndën e informatikës	57	58	87	87
Në lëndët gjuhësore	3	3	1	1
Në lëndët shkencore	5	5	5	5
Në lëndët e artit	3	3	3	3
Në lëndët e tjera	2	2	2	2
Nuk është përdorur fare	40	41	8	8

Tabela 18. Përgjigjet e nxënësve për përdorimin e programit PowerPoint për prezantime në mësim

Gjithashtu, të dhënat nga tabela tregojnë se programi PowerPoint për prezantimi në mësim fare pak është shfrytëzuar në lëndët e tjera mësimore.

6.3.3. Sa kanë qenë programet e TIK-ut, të shfrytëzuara në mësim, në funksion të përfitimit të kompetencave për përdorimin e kompjuterit?

Për të identifikuar shfrytëzimin e programeve të TIK-ut në funksion të përfitimit të kompetencave për përdorimin e kompjuterit, në pyetësorët e realizuar me mostrën e nxënësve kemi shtruar pyetje dhe kemi kërkuar përgjigje për këtë aspekt. Rezultatet e përgjigjeve të nxënësve të klasës së 10-të dhe 12-të, gjegjësisht 59% e nxënësve të anketuar, pasqyrojnë ndikim të vogël nga shfrytëzimi i këtyre programeve në

mësim. Për dallim prej tyre, nxënësit e anketuar që kanë mbaruar maturën (59% e tyre) pohojnë se programet e TIK-ut të shfrytëzuara në mësim kanë qenë mesatarisht në funksion të përfitimit të kompetencave për përdorimin e kompjuterit.

	Nxënësit e klasës së 10-të dhe 12-të		Nxënësit që kanë mbaruar maturën	
Aspak	1	1	3	3
Pak	58	59,18	17	17,17
Mesatarisht	9	9,18	58	58,59
Shumë	30	30,61	21	21,21

Tabela 19. Përgjigjet e nxënësve për programet e shfrytëzuara në mësim, në funksion të përfitimit të kompetencave për përdorimin e kompjuterit.

6.4. Vetëvlerësimi i nxënësve për nivelin e kompetencave të tyre për përdorim të kompjuterit

Shumica e mostrës së nxënësve të anketuar nivelin e kompetencave të tyre për përdorim të kompjuterit e kanë vetëvlerësuar me kompetenca të kënaqshme. Është interesant fakti se nxënësit që kanë pohuar se kanë përfituar kompetenca për përdorimin e kompjuterit përmes frekuentimit të internet-kafeve kanë dhënë vetëvlerësime se janë me kompetenca të ulëta në përdorimin e kompjuterit. Gjithashtu, edhe 33 % e nxënësve që janë shprehur se kryesisht njohuritë e tyre për përdorimin e kompjuterit i kanë mësuar në shkollë, janë vetëvlerësuar me kompetenca të pamjaftueshme për përdorimin e kompjuterit. Edhe një përqindje e konsiderueshme e nxënësve që kanë pohuar se në shtëpi e kanë mësuar përdorimin e kompjuterit në mënyrë të pavarur, janë vetëvlerësuar me kompetenca të pamjaftueshme dhe kompetenca të ulëta.

Mënyra e përfitimit	Vetëvlerësimi për nivelin e kompetencave								
	Kompetenca shumë të larta	%	Kompet. të kënaqshme	%	Kompet. të mjaftueshme	%	Kompetenca të ulëta	%	Gjithsej
Në internet kafe	1	11.11	2	22.22	1	11.11	5	55.56	9
Në kurse për përdorim të kompjuterit	1	14.29	5	71.43	0	0.00	1	14.29	7
Në shkollë	5	5.75	45	51.72	29	33.33	8	9.20	87
Në shtëpi dhe me përkrahje të të tjerëve	4	11.43	22	62.86	8	22.86	1	2.86	35
Në shtëpi dhe në mënyrë të pavarur	4	9.09	22	50.00	13	29.55	5	11.36	44
Gjithsej	16	8.25	104	53.61	55	28.35	19	9.79	194

Tabela 20. Ndërlidhja e përgjigjeve të nxënësve për mënyrat e përfitimit të kompetencave për përdorimin e kompjuterit dhe vetëvlerësimin për kompetencat që i zotërojnë.

Nga 71 nxënës që janë vetëvlerësuar me kompetenca të pamjaftueshme apo kompetenca të ulëta për përdorimin e kompjuterit, 51 ose 72 % e tyre kanë dhënë këto arsye se pse kompetencat e tyre janë të pamjaftueshme për përdorimin e kompjuterit.

Arsyet sipas nxënësve për kompetenca jo të larta dhe jo të kënaqshme të nxënësve për TIK-un	Nr	%
Mosinteresimi i mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave për cilësi në shkollë	20	39.22
Kompetenca të ulëta për TIK-un nga vetë mësimdhënësit	22	43.14
Mosinteresimi i nxënësve për të arritur kompetencat e nevojshme për TIK-un	6	11.76
Arsye të tjera	3	7,5

Tabela 21. Arsytet sipas nxënësve për kompetenca jo të larta dhe jo të kënaqshme të nxënësve për TIK-un

Nxënësit që e kanë mbaruar maturën kanë rënë në kundërshtim me përgjigjet e tyre, me njërin nga pyetjet e pyetësorit, ku kërkohet që të tregojnë se si i kanë plotësuar aplikacionet për konkurrim në fakultete të Universitetit të Prishtinës. Në pyetjen tonë se si ata kanë vepruar gjatë shkarkimit të aplikacionit nga ueb-faqja e Universitetit të Prishtinës dhe si e kanë plotësuar atë, vetëm 35 kandidatë të anketuar (nga 76 prej tyre) janë përgjigjur se këtë e kanë bërë vetë, pa ndihmën e askujt, kurse të tjerët janë ndihmuar nga të afërmit e tyre.

Format e plotësimit të aplikacionit për konkurrim në fakultet, krahasuar me vetëvlerësimin e nxënësve/studentëve për kompetencat e tyre për TIK-un						
Niveli i kompetencave	Dikush tjetër	Me ndihmën e prindërve	Me ndihmën e shokëve	Në internet kafe	Pa ndihmën e askujt	Gjithsej
Kompetenca shumë të larta	0	1	3		2	6
Kompetenca të kënaqshme	0	4	11	1	22	38
Kompetenca të mjaftueshme	1	3	8	0	9	21
Kompetenca të ulëta	0	4	5	0	2	11
Totali	1	12	27	1	35	76

Tabela 22. Përgjigjet e nxënësve për mënyrën e aplikimit në Universitet dhe ndërlidhja me përgjigjet për nivelin e kompetencave të deklaruara nga vetë nxënësit.

Në pyetjen lidhur me rezultatet e pritshme nga testi i standardizuar për programin e ECDL-së, më shumë se gjysma (54%) e nxënësve të klasës së 10-të dhe 12-të paraprakisht kanë theksuar se janë të sigurt që mund të tregojnë rezultate të larta në testin e njohurive për përdorimin e kompjuterit. Përqindja më e lartë e nivelit të sigurisë është pohuar edhe për modulin e internetit, ku 76.40% e nxënësve kanë thënë se kanë

nivel të sigurt për rezultatet që do t'i arrijnë në testin e njohurive për shfrytëzimin e internetit në kompjuter.

Programet	Niveli i sigurisë						Gjithsej
	I/e sigurt		Deri diku		I/e pasigurt		
	Nr	%	Nr	%	Nr	%	
Word	50	54,35	41	44,57	1	1,09	92
Excel	19	21,11	62	68,89	9	10,00	90
Power Point	14	19,18	58	79,45	1	1,37	73
Internet	68	76,40	20	22,47	1	1,12	89

Tabela 23. Nivelet e sigurisë së nxënësve (klasa 10-të dhe 12-të) për aplikimin e shkathtësive të tyre në përdorimin e kompjuterit.

Afërsisht nivel të njëjtë të sigurisë kanë treguar edhe nxënësit që kanë mbaruar maturën. Për dallim të sigurisë së pohuar nga nxënësit e klasës së 10-të dhe 12-të, nxënësit që kanë mbaruar maturën kanë treguar siguri më të lartë në shkathtësitë e përdorimit të programit Excel (46 %) dhe PowerPoint (44 %).

Programet	Niveli i sigurisë						Gjithsej
	I/e sigurt		Deri diku		I/e pasigurt		
	Nr	%	Nr	%	Nr	%	
Word	51	57,95	35	39,77	2	2,27	88
Excel	40	45,51	41	47,67	5	5,81	86
Power Point	37	44	33	39,28	14	16,66	84
Internet	62	69,31	24	27,27	2	2,27	88

Tabela 24. Nivelet e sigurisë së nxënësve që kanë mbaruar maturën për aplikimin e shkathtësive të tyre në përdorimin e kompjuterit.

Pohimet e nxënësve për nivelin e sigurisë së tyre në përdorimin e programeve të veçanta në kompjuter kanë qenë edhe një motiv shtesë

për përfshirjen e tyre në testin e standardizuar të ECDL-së. Natyrisht, bazë kryesore janë vendosur programet mësimore që i kanë ndjekur në vitet paraprake.

6.5. Perceptimi i nxënësve për nivelin e kompetencave të mësimdhënësve për përdorim të TIK-ut në mësim

Në disa nga pyetjet paraprake kemi marrë përgjigje indirekte për perceptimet e nxënësve për nivelin e kompetencave të mësimdhënësve për përdorim të TIK-ut në mësim. Pothuajse në të gjitha përgjigjet e tyre ka pasur tregues se nxënësit kanë perceptime të ndryshme sa i përket nivelit të kompetencave të mësimdhënësve për TIK-un. Këto dallime janë shprehur edhe në pyetjen e drejtpërdrejtë adresuar nxënësve në raport me kompetencat e mësimdhënësve për përdorimin e kompjuterit.

6.5.1. Niveli i shkathtësive të mësimdhënësve në përdorimin e kompjuterit

Nxënësit e klasës së 10-të (44%) kanë shprehur mendimin e tyre se shkathtësitë e mësimdhënësve për përdorimin e kompjuterit janë të ulëta. Duke pas parasysh se nxënësit e klasave të 10-ta kanë vlerësuar mësimdhënësit e tyre të viteve paraprake të shkollimit, përgjigjet e tyre lënë për të nënkuptuar se mësimdhënësit e shkollë së mese të ulët kanë kompetenca më të ulëta në përdorimin e kompjuterit krahasuar me mësimdhënësit e gjimnazeve dhe shkollave profesionale. Kjo vërtetohet edhe në vlerësimet e nxënësve që kanë përfunduar maturën.

	Nxënësit e klasës së 10-të dhe 12-të	%	Nxënësit që kanë mbaruar maturën	%
I lartë	37	38,54	27	27,27
Mesatar	8	8,33	67	67,67
I ulët	51	53,13	5	5
Totali	96	100	99	100

Tabela 25. Niveli i e sigurisë së nxënësve për aplikimin e shkathtësive të tyre në përdorimin e kompjuterit.

Nga tabela paraprake vërehet se nxënësit që kanë mbaruar maturën janë më të përmbajtur në vlerësimin e tyre për nivelin e ulët të kompetencave të mësimdhënësve për përdorimin e kompjuterit, kurse për nivelin mesatar shprehen mbi 67 % e tyre.

Perceptimi i nxënësve për nivelin e shkathtësive të mësimdhënësve për përdorimin e kompjuterit reflektohet edhe në pyetjen drejtuar nxënësve për arsyet kryesore për kompetenca jo të larta dhe jo të kënaqshme të tyre për përdorimin e kompjuterit. Shumica e theksuar e nxënësve që janë përgjigjur se kanë kompetenca të ulëta në përdorimin e kompjuterit, kanë renditur në vend të parë dhe të dytë si arsye për këtë kompetencat e ulëta të mësimdhënësve në përdorimin e kompjuterit dhe mosinteresimin e mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave për cilësi në shkollë. Tabela në vijim i pasqyron përgjigjet e nxënësve për arsyet kryesore se pse kanë nivel të ulët të kompetencave për përdorimin e kompjuterit. Tabela 22. Arsyet sipas nxënësve për kompetenca jo të larta dhe jo të kënaqshme të nxënësve për TIK-un

Arsyet sipas nxënësve për kompetenca jo të larta dhe jo të kënaqshme të nxënësve për TIK-un	Nr	%
Mosinteresimi i mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave për cilësi në shkollë	20	39.22
Kompetenca të ulëta për TIK-un nga vetë mësimdhënësit	22	43.14
Mosinteresimi i nxënësve për të arritur kompetencat e nevojshme për TIK-un	6	11.76
Arsye të tjera	3	7,5

Tabela 26. Arsyet sipas nxënësve për kompetenca jo të larta dhe jo të kënaqshme të nxënësve për TIK-un.

VII. REZULTATET E NXËNËSVE TË TESTUAR ME TESTIN E STANDARDIZUAR TË ECDL-SË

Për të siguruar informacionin me relevant lidhur me kompetencat që zotërojnë nxënësit në përdorimin e kompjuterit, mostrën e nxënësve të përfshirë në anketim e kemi përfshirë edhe në testin e standardizuar të ECDL-së.

Procesin organizativ të realizimit të testit të standardizuar të ECDL-së me mostrën e nxënësve të përzgjedhur e kemi përshkruar në kapitullin e tretë të këtij raporti. Vlen të veçohet se nxënësit e përfshirë në testin e standardizuar të ECDL-së nuk janë përgatitur paraprakisht me teste diagnostikuese, me qëllim të vërtetimit se sa përgatitja e tyre paraprake nga shkolla dhe format e tjera ka siguruar kompetencat bazë për përdorimin e kompjuterit. Në pjesën në vijim do të prezantojmë modulet e përfshira në procesin e testimit sipas klasave, numrin e nxënësve të përfshirë në testim dhe rezultatet e arritura.

Nxënësit e klasës së 10-të janë përfshirë në testin e tri moduleve të ECDL-së:

- Moduli 2 - Shfrytëzimi i kompjuterit dhe menaxhimi i fajllave (Word);
- Moduli 3 - Përpunimi i teksteve (Windows XP);
- Moduli 7 - Interneti dhe komunikimi (Internet Explorer & Outlook).

Nxënësit e klasës së 12-të janë përfshirë në testin e dy moduleve të ECDL:

- Moduli 4 - Kalkulimi i tabelave (Excel);
- Moduli 6 - Prezantimet (PowerPoint);

Nxënësit që kanë mbaruar provimin e maturës janë përfshirë në të gjitha modulet e ECDL-së:

- Moduli 1 - Bazat e teknologjisë së informimit dhe komunikimit (ICT);

- Moduli 2 - Shfrytëzimi i kompjuterit dhe menaxhimi i fajllave (Windows XP);
- Moduli 3 - Përpunimi i teksteve (Word);
- Moduli 4 - Kalkulimi i tabelave (Excel);
- Moduli 5 - Baza e të dhënave (Access);
- Moduli 6 - Prezantimet (PowerPoint);
- Moduli 7-Interneti dhe komunikimi (Internet Explorer & Outlook).

7.1. Rezultatet e nxënësve të klasës së 10-të dhe 12-të

Në procesin e anketimit janë përfshirë 98 nxënës të klasës së 10-të dhe klasës së 12-të. Të gjithë nxënësit janë anketuar janë thirrur që të marrin pjesë në testin e standardizuar. Prej nxënësve të anketuar nuk kanë marrë pjesë në test 20 nxënës, me arsyetimin se nuk janë të sigurt se do të kenë rezultate në testin sipas moduleve

Tipi i shkollës	X	%	XII	%	Gjithsej:	%
Gjimnaz	25	58.14	18	41.86	43	54.43
Profesionale	23	63.89	13	36.11	36	45.57
Gjithsej:	48	60.76	31	39.24	79	100.00

Tabela 27. Numri i dhe përqindja e nxënësve sipas klasave dhe tipit të shkollave që kanë marrë pjesë në testin e standardizuar të ECDL-së.

Tipi i shkollës	Gjinia				Gjithsej
	F	%	M	%	
Gjimnaz	26	60.47	17	39.53	43
Shkollë profesionale	17	47.22	19	52.78	36
Gjithsej F/M	43	54.43	36	45.57	79

Tabela 28. Numri i dhe përqindja e nxënësve sipas gjinisë dhe tipit të shkollave që kanë marrë pjesë në testin e standardizuar të ECDL-së.

Përfshirja në test ECDL	X						XII			
	M2		M3		M7		M4		M6	
	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M
Gjimnaz	15	10	15	10	15	9	11	7	9	7
Shkolla profesionale	8	15	8	15	8	15	9	4	8	4
Gjithsej F/M	23	25	23	25	23	24	19	12	17	12
Gjithsej:	48		48		47		31		29	

Tabela 29. Numri i nxënësve të testuar, specifikuar në gjini, klasë, tipit të shkollës dhe moduleve të ECDL-së të testuara.

Nga 48 nxënës të klasës së 10-të që kanë hyrë në testin e modulit M2 - shfrytëzimi i kompjuterit dhe menaxhimi i fajllave (Windows XP), vetëm 9 prej tyre ose 18.75 % e tyre e kanë kaluar testin, sipas standardeve të ECDL-së me 75 % të realizimit pozitiv të testit – kriteri i kalimit. Modulin M3- Përpunimi i teksteve (Word) e ka kaluar vetëm një nxënës ose 2.08 % nga 48 nxënës të testuar në këtë modul. Modulin M7- Interneti dhe komunikimi (Internet Explorer & Outlook), e ka kaluar vetëm 1 nxënës (2.13 %) nga 47 nxënës sa janë testuar në këtë modul. Në modulin M4 - Kalkulimi i tabelave (Excel) janë testuar 31 nxënës, asnjë prej tyre nuk e ka kaluar kriterin e kalueshmërisë. Ndërkaq, modulin M6 Prezantimet (PowerPoint) e kanë kaluar vetëm 2 nxënës prej 29 nxënësve të klasës së 12-që që janë testuar në këtë modul.

Kalueshmëria e ECDL	X			XII	
	M2	M3	M7	M4	M6
Gjimnaz	8	1	1	0	2
Shkollat profesionale	1	0	0	0	0
Gjithsej	9	1	1	0	2

Tabela 30. Numri i nxënësve sipas tipit të shkollave që i kanë kaluar pozitivisht modulet e ECDL-së.

Pra, siç shihet nga tabela paraprake, prej 79 nxënësve që janë testuar për këto module, vetëm 13 nxënës ose 16.45 % e tyre kanë treguar rezultat pozitiv në testim, nga ta vetëm 1 nxënës (ose 3 %) i klasës së 10-të ishte nxënës nga shkollat profesionale të përfshira në hulumtim. Analizat e tjera statistikore tregojnë se nga 13 nxënës që kanë kaluar testet e ECDL-së, vetëm dy prej tyre kanë arritur t'i kalojnë nga dy module. Kjo nënkupton se vetëm 11 nxënës ose 13.92 % e nxënësve të përfshirë në test kanë kaluar nga një modul të ECDL-së dhe 2 nxënës të tjerë i kanë kaluar nga 2 module.

Statistikat tregojnë se nxënësit e gjinisë mashkullore kanë treguar rezultate më të mira në modulin Windows XP dhe në përpunimin e teksteve (Word), ndërsa nxënëset e gjinisë femërore janë treguar më të suksesshme në modulin e Internetit, kurse rezultate përafërsisht të barabarta kanë treguar nxënësit e të të dy gjinive në PowerPoint. Kalueshmëria e ECDL-së specifikuar në gjini është paraqitur në tabelën në vijim.

	X						XII			
	M2		M3		M7		M4		M6	
	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M
Gjimnaz	3	5	0	1	1	0	0	0	1	1
Shkolla profesionale	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsej F/M	3	6	0	1	1	0	0	0	1	1
Gjithsej:	9		1		1		0		2	

Tabela 31. Rezultatet e nxënësve në modulet e ECDL-së specifikuar në gjini.

7.2. Rezultatet e nxënësve/studentëve në testin e standardizuar të ECDL-së

Nga 100 maturantë të anketuar për kompetencat e nxënësve për përdorimin e kompjuterit, edhe pse 79 prej tyre e kanë konfirmuar pjesëmarrjen në testet e ECDL-së, prapëseprapë në testim kanë marrë pjesë vetëm 33 nxënës që e kanë mbaruar maturën. Gjatë procesit të kontaktimit të tyre me telefon dhe e-mail, nxënësit që nuk kanë marrë pjesë në teste kanë pohuar se nuk ndjehen të përgatitur për të hyrë në teste të ECDL-së.

Tipi i shkollës	Gjinia				
	F	%	M	%	Gjithsej
Gjimnaz	12	75,00	10	58,82	22
Shkollë profesionale	4	25,00	7	41,18	11
Gjithsej F/M	16	48,48	17	51,52	33

Tabela 32. Numri i nxënësve/studenteve të testuar, sipas tipit të shkollave dhe gjinisë.

Përfshirja e nxënësve/studentëve në testin e ECDL-së, sipas moduleve. Pavarësisht se janë testuar 33 nxënës që kanë përfunduar maturën, në asnjë modul nuk kanë marrë pjesë të gjithë, edhe pse ata kanë pas mundësi të testohen në të 7 modulet e ECDL-së, mirëpo disa prej tyre qysh në start nuk e kanë ndier veten të sigurt për rezultatet që do të arrijnë dhe kanë hequr dorë nga procesi i testimit në ato module. Testimi i nxënësve/studentëve është realizuar gjatë dy ditëve.

Tipi i shkollës	M1		M2		M3		M4		M5		M6		M7	
	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M
Gjimnaz	3	4	10	10	10	10	11	9	3	4	4	5	10	8
Shkolla profesionale	1	0	3	7	2	7	3	7	1	0	1	0	2	6
Gjithsej F/M	4	4	13	17	12	16	14	16	4	4	5	5	12	14
Gjithsej:	8		30		29		30		8		10		26	

Tabela 33. Numri i nxënësve/studentëve të testuar, specifikuar në module të testuara, tipit të shkollës dhe gjini

Tipi i shkollës	M1		M2		M3		M4		M5		M6		M7	
	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M
Gjimnaze	1	2	1	6	1	0	0	0	0	1	2	0	0	2
Sholla profesionale	0	0	1	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali sipas gjinisë	1	2	2	8	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	3		10		1		0		1		2		2	

Tabela 34. Numri i nxënësve/studentëve që kanë realizuar pozitivisht më shumë se 75 % të testit në modulet përkatëse, specifikuar në modul, tip të shkollës dhe gjini të nxënësit.




Fig 4. Numri i nxënësve/studentëve që janë testuar dhe që kanë realizuar pozitivisht më shumë se 75 % të testit në modulet përkatëse.

Rezultatet e paraqitura dhe grafiku i përfshirjes dhe rezultateve të arritura tregon se dy janë modulet që nxënësit/studentët kanë treguar rezultate tejet të ulëta. Përkatësisht modulën e katërt - Kalkulimi i tabelave (Excel), prej 30 nxënësve/studentëve të testuar, asnjë nuk ka arritur ta kalojë testin. Dhe, modulën e tretë - Përpunimi i teksteve (Word), prej 29 nxënësve/studentëve të testuar, vetëm 1 prej tyre ka kaluar testin ose 3.03 % e totalit të të testuarve për këtë modul.

Prej 19 nxënësve/studentëve që kanë kaluar ndonjërin nga modulet, vetëm 1 prej tyre ka arritur të kalojë me sukses 4 module dhe të fitojë të drejtën e certifikimit bazë – ECDL START, kurse 2 nxënës/studentë të tjerë kanë arritur të kalojnë nga 3 module.

Është interesant fakti, se të 3 nxënësit/studentët që kanë kaluar, 3 përkatësisht 4 module janë nxënës që janë orientuar për të studiuar shkencat politike.

Prej 19 nxënësve/studentëve që kanë kaluar ndonjërin nga modulet, 16 prej tyre ose 84 % e nxënësve që kanë kaluar ndonjërin nga modulet janë nxënës që kanë mbaruar ndonjërin nga gjimnazet në Kosovë.

7.3. Vlerësimi i procesit të testimit për programin e ECDL-së nga nxënësit e testuar

Nxënësit e përfshirë në testim, pas përfundimit të tij kanë pasur mundësi që të plotësojnë një formular/vlerësues për procesin e testimit dhe për suksesin apo arsyet e mospjesëmërisë. Nxënësit (77 %) janë shumë të kënaqur me kohën që kanë pasur në dispozicion për testim, 63 % janë shumë të kënaqur me sallën dhe pajisjet kompjuterike, 54 % janë shumë të kënaqur me mënyrën e testimit, kurse 44 % janë shumë të kënaqur me përmbajtjen e testit, kurse vetëm 28 % janë shumë të kënaqur me testuesit.



Shkalla e kënaqësisë me procesin e testimit	Shumë i/e kënaqur	%	Mesatarisht i/e kënaqur	%	Aspak i/e kënaqur	%
	Me përmbajtjen e testit	31	44.3	39	55.7	0
Me mënyrën e testimit	29	53.7	22	40.7	3	5.6
Me testuesit	18	27.7	39	60.0	8	12.3
Me kohën në dispozicion për testim	50	76.9	12	18.5	3	4.6
Me sallën, pajisjet kompjuterike	49	62.8	28	35.9	1	1.3

Tabela 35. Shkalla e kënaqësisë me procesin e testimit.

Nxënësit e klasës së 10-të, përsëri si arsye kryesore të mospërfitimit në test e kanë vënë në rend të parë faktin se mësuesit e tyre në shkollë nuk punojnë me kompjuter, këtë e kanë thënë mbi 70 % e nxënësve të klasës së 10-të. Përqindje më e lartë se kjo, mbi 76 % e nxënësve si arsye kryesore të mospërfitimit të tyre është fakti se në shkollat e tyre nuk ka kompjuter, që nënkupton se nuk përdoret kompjuteri në klasat e tyre. Është edhe një përqindje e nxënësve, mbi 13 % që kanë pohuar se nuk kanë pasur interesim që të mësojnë për përdorimin e kompjuterit.

Arsyet e mospërfitimit	X	%	XII	%	Gjithsej	%
Nuk kam kompjuter në shtëpi	1	25	3	75	4	6.67
Në shkollën time nuk kemi kompjuter	16	76.19	5	23.81	21	35.00
Mësuesit në shkollën time nuk punojnë me kompjuter	19	70.37	8	29.63	27	45.00
Nuk kam pasur interesim të mësoj për përdorimin e kompjuterit	3	37.5	5	62.5	8	13.33

Tabela 36. Arsyt sipas nxënësve për mospërfitimin e tyre në teste.

Interesant janë edhe përgjigjet e nxënësve për atë se çfarë do të në të ardhmen e afërt për të avancuar shkathtësitë në përdorimin e kompjuterit. Nxënësit vazhdojnë ta ruajnë besimin për shkollën, mbi 56 % e tyre thonë se do të mësojnë më shumë në shkollë programin e TIK-ut. Mbi 25% e nxënësve shprehen se do të ndjekin kurse për përdorimin e kompjuterit, me qëllim të përmirësimit dhe avancimit të shkathtësive në përdorimin e kompjuterit.

<i>Çfarë do të bëni në javët në vijim për të përmirësuar dhe avancuar shkathtësitë në përdorimin e kompjuterit?</i>	Klasa 10	%	Klasa 12	%	Gjithsej	%
Do të mësoj më shumë në shkollë programin e TIK-ut	2 5	53.1 9	2 2	46.8 1	4 7	56.63
Do të kërkoj nga familja që të më sigurojë një kompjuter	1	33.3 3	2	66.6 7	3	3.61
Do të kërkoj nga mësimdhënësit e TIK-ut të mësojmë përdorimin e kompjuterit	4	66.6 7	2	33.3 3	6	7.23
Do të kërkoj nga të gjithë mësimdhënësit që të përdorin TIK-un në mësimdhënie	4	66.6 7	2	33.3 3	6	7.23
Do të ndjek kurse për përdorimin e kompjuterit	1 5	71.4 3	6	28.5 7	2 1	25.30

Tabela 37. Hapat që do t'i ndërmarrin nxënësit për të përmirësuar dhe avancuar shkathtësitë e përdorimit të kompjuterit.

7.4. Rezultatet e testit të arritshmërisë, klasa e 9 -të

Test i arritshmërisë organizohet çdo vit për nxënësit që mbarojnë shkollimin e detyruar, përkatësisht klasën e 9-të. Në mesin e lëndëve që përfaqësohen në testin e arritshmërisë është edhe lënda e Informatikës. Testin e organizon Ministria e Arsimit në bashkëpunim të ngushtë me Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe shkollat. Për të ndërlidhur

rezultatet e nxënësve që në këtë vit kanë hyrë në testin e arritshmërisë (klasa 9) me rezultatet e nxënësve në testin e ECDL-së, i kemi analizuar rezultatet që pasqyrohen në pjesën në vijim.

Në këtë vitin akademik 2011lënda e Informatikës është përfaqësuar në testin e arritshmërisë me 5 kërkesa/pyetje. Pyetjet kërkesat/pyetjet në test janë me alternativa të shumëfishta, ku nga katër alternativa të paraqitura në test, vetëm një prej tyre i përgjigjet saktësisë së kërkesës së pyetje. Rezultatet e marra nga Zyra e vlerësimit në MASHT tregojnë se arritshmëria e nxënësve në testin e maturës në vitin 2011 është 3.46 prej 5 kërkesave/pyetjeve ose 69.20 %. Bazuar në kriteret e vlerësimit të nxënësve me nota, këto rezultate mund të vlerësohen me notën mirë, ndërsa krahasuar me kriteret e kalueshmërisë në testin e standardizuar të ECDL-së, këto rezultate qëndrojnë në pragun minimal të arritshmërisë.

7.5. Rezultatet e provimit të maturës në lëndën e TIK-ut

Provimi i maturës në Kosovë realizohet çdo vit për nxënësit e gjimnazeve që mbarojnë me sukses klasat 12/13-të, si dhe për nxënësit e shkollave profesionale që me sukses e mbarojnë klasën e 13-të. Për të ndërlidhur rezultatet e nxënësve me testin e ECDL-së, kemi siguruar nga Zyra e vlerësimit në MASHT-it rezultatet e nxënësve në provimin e maturës për lëndën e TIK-ut, për Gjimnazin matematikë – informatikë, si dhe për drejtimet teknike të shkollave profesionale.

Në provimin e maturës 2011, lënda e Informatikës në drejtimet e cekura më lart është përfaqësuar me 15 kërkesa/pyetje. Pyetjet kërkesat/pyetjet në test të maturës janë me alternativa të shumëfishta, prej katër alternativave vetëm një prej tyre është e saktë. Rezultatet e marra tregojnë se arritshmëria është 8.55 prej 5 kërkesave/pyetjeve ose 57 %, për drejtimin e Gjimnazit matematikë – informatikë, kurse 5.69 prej 15 kërkesave/pyetjeve ose 38 %, për drejtimet teknike.

Në bazë të kriterëve të provimit të maturës, në total nxënësit e Gjimnazit matematikë – informatikë kanë arritur pragun minimal të

kalimit në këtë lëndë, kurse nxënësit e drejtimeve teknike të shkollave profesionale nuk e kanë arritur kriterin e kalimit. Mesatarja e këtyre rezultateve, në bazë të standardeve të ECDL-së, nuk e siguron as pragun minimal të aftësive për TIK-un.

VIII. MUNDËSITË E INTEGRIMIT TË MODULEVE TË ECDL-SË NË KURRIKULËN E TIK-UT DHE NË KURRIKULAT LËNDORE TË FUSHËS

Mundësitë e integrimit të moduleve të ECDL-së në kurrikulin e TIK-ut dhe në kurrikulat lëndore në kuadër të fushës kurrikulare janë diskutuar në takimet me fokus- grupe që lidhen drejtpërdrejt me procesin e hartimit të programeve të TIK-ut dhe me mësimdhënës që janë pjesë e procesit të mësimdhënies dhe nxënies. Kjo është bërë për faktin se aktualisht MASHT-i me grupet e ekspertëve që ka angazhuar është duke hartuar rezultatet mësimore për fusha kurrikulare dhe me miratimin e tyre pritet të hartohen edhe programet për lëndë mësimore dhe fusha specifike kurrikulare.

Dy fokus-grupet e përfshira në diskutime kanë diskutuar dhe analizuar përmbajtjen aktuale të lëndës së Teknologjisë me TIK-un nga klasa e 6-të deri në mbarim të klasës së 12/13-të, tekstet dhe materialet mësimore që lidhen me përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe problemet që lidhen me infrastrukturën dhe sistemin elektronik në shkolla.

Fokus-grupet në parim kanë ardhur në përfundim se rezultatet e pritura nga lënda e TIK-ut dhe korrelacion të programeve dhe lëndëve të tjera mësimore nuk është në koherencë me zhvillimet e fundit në teknologjinë e informimit dhe komunikimit. Mbështetur mbi këtë parim, pjesëmarrësit e përfshirë në fokus-grupe kanë vlerësuar nevojën e integrimit të t programit të ECDL-së në kurrikulat e TIK-ut dhe në fushat e tjera kurrikulare, edhe për dy arsye:

- Për jetësimin e kompetencave të përshkruara në kornizën e kurrikulës dhe
- Për plotësimin e standardeve – kërkesave evropiane.

Pjesëmarrësit kanë renditur edhe disa arsye kryesore se pse duhet të integrohen modulet e ECDL-së në kurrikulin e TIK-ut dhe kurrikulat lëndore në kuadër të fushave kurrikulare:

- Modulet e ECDL-së janë kurrikula të njohura ndërkombëtarisht;

- Nxënësit e suksesshëm fitojnë shkollim mbarë evropian dhe më këtë rrisin mundësitë për punësimin e tyre;
- Mësimdhënësit më përpikëri mund të përcaktojnë nivelin e arritjeve të nxënësve në këtë fushë;
- Koncepti i programit të ECDL-së siguron nxënësit që pas përfundimit të suksesshëm të secilit modul, të praktikojë njohuritë e fituara në praktikë, në profesionin e përzgjedhur.
- TIK-u vazhdimisht është në zhvillim dhe një prej mundësive që të përcillen këto zhvillime është integrimi i moduleve të ECDL-ës në kuadër të kurrikulave të TIK-ut me argumentin se ECDL-i vazhdimisht i përcjell trendët e zhvillimit të teknologjisë dhe në këtë mënyrë krijohet edhe mundësi që lëndës mësimore e TIK-ut dhe lëndëve të tjera t'u ofrohet mundësia e përcjelljes së këtyre ndryshimeve.

Pjesëmarrësit kanë vlerësuar se dobitë e nxënësve nga integrimi i ECDL-së në kurrikulën e TIK-ut dhe në kurrikula të tjera mësimore janë të shumta. Në radhë të parë rrit nivelin e njohurive themelore kompjuterike dhe te teknologjisë informative, pastaj shton efikasitetin dhe efektivitetin në mësim dhe ushtrim të profesionit, ofron mundësi për arsimim në shkallë më të larta të shkollimit, ofron perspektiv të reja në jetën profesionale, dhe dobia më e rëndësishme qëndron në faktin se ofron një kualifikim të pranuar ndërkombëtarisht.

Integrimi i moduleve të ECDL-së në kurrikulin e TIK-ut dhe në kurrikulat lëndore, në kuadër të fushës mësimore gjegjëse, krijon dobi të veçanta edhe për mësimdhënësit që e ofrojnë programin e TIK-ut, sepse zbatimi i ECDL-së paraqet një metodë të standardizuar për vlerësimin e njohurive të nxënësve, mundëson shpërndarjen e barabartë të njohurive dhe aftësive të IT në tërë klasat, është model me efektiv dhe inovativ në mësimdhënie, motivon mësimdhënësit, rrit cilësinë e punës mësimdhënies dhe rrit aftësitë konkurruese për zhvillim dhe aftësim profesional të mësimdhënësve.

Disa nga sugjerimet e dala nga fokus-grupet janë si në vijim:

- Mësimdhënësit duhet të fillojnë me angazhimin e nxënësve për përdorimin e kompjuterit nga shkalla e dytë e kurrikululës (klasat 3-5), për lojëra të ndryshme, gjetjen e informative të thjeshta në internet, për përgatitjen e prezantimeve të thjeshta;
- Në nivelin e dytë të shkollimit, shkolla e mesme e ulët – klasat 6-9-të, nxënësit duhet të zotërojnë shkathhtësitë e katër moduleve ekzistuese të ECDL-së (M2, M3, M6 dhe M7), të cilat duhet të zhvillohen si pjesë të veçanta të programit për:
 - Përpunimin e teksteve dhe vizatimeve;
 - Përdorimin e disa elemente të fajllimit dhe ruajtjes së dokumenteve;
 - Përdorimin e internetit dhe internet Explorer;
 - Përgatitjen e prezantimeve dhe insertimin e tabelave;
 - Bazat e teknologjisë së informimit dhe komunikimit (hardueri dhe softueri).
- Pjesët e moduleve të ECDL-së duhet përshtatur edhe moshës së nxënësve, pra ato më të lehtë në klasat më të ulëta;
- Duhet pasur kontinuitet në shtrirjen e përmbajtjes së pjesëve të moduleve nëse ato ndahen në klasë apo shkallë;
- Përveç Modullit 5 të ECDL-së, elementet e moduleve të tjera mund të fillojnë që nga klasa e pestë;
- Në shkollat e mesme profesionale të merren parasysh drejtimit përkatëse dhe për ato drejtime të përfshihen softuerët aplikativë përkatës, e jo domosdo vetëm modulet e ECDL-së;
- Tetë modulet e ECDL-së të jenë minimumi që duhet të arrijnë të gjithë nxënësit e Kosovës që mbarojnë maturën, por për drejtimit që lidhen me informatikën të këtë rezultate mësimore dhe përmbajtje kurrikulare edhe softuerët e tjerë aplikativë;
- Krahas moduleve të ECDL-së duhet përfshirë edhe softuerë të tjerë, si ata për vizatim, multimedia. Në klasat 10-12-të duhet shtrire disa njësi edhe në lëndët e tjera sa i përket mësimin elektronik (e-learning), e jo vetëm në kuadër të lëndës së TIK-ut;

- Të përfshihet edhe moduli Aspekti i sigurisë së të dhënave;
- Fondi i orëve lidhur me lëndën e TIK-ut duhet zgjeruar me futjen e lëndëve zgjedhore, ku aty do të mund të ligjëroheshin kapituj të caktuar nga fusha e informatikës;
- Për modulet e ECDL-së dhe softuerët e tjerë aplikative duhet përgatitur manuale përkatëse dhe njëkohësisht duhet mundësuar që ato të plotësohen me avancimin e teknologjisë informative;
- Mësuesit dhe arsimtarët duhet të marrin trajnime përkatëse për të qenë në gjendje që të ligjërojnë pjese të veçanta nga TIK-u.

Për të arritur rezultatet e synuara në integrimin e ECDL-it në shkolla, pjesëmarrësit e përfshirë në diskutime propozojnë që integrimi i ECDL-it në shkolla të bëhet:

- Përmes moduleve të veçanta për nxënës;
- Si lëndë e veçantë;
- Përmes fushave kurrikulare dhe lëndëve të tjera mësimore, dhe
- Përmes projekteve në shkolla.

Diskutimet me fokus grupe kanë identifikuar disa pengesa për futjen e ECDL-së në shkolla. Pengesat e identifikuara meritojnë kujdes në mënyrë që me kohë të kemi parasysh rreziqet dhe mundësitë për tejkalimin e tyre. Pjesëmarrësit kërkojnë që vëmendje të veçantë t'u kushtohet pengesave që lidhen me:

- Mungesën e kapaciteteve në shkolla për të përfshirë si tërësi TIK-un në procesin mësimor dhe në menaxhimin e të dhënave të shkollës;
- Përgatitjen jo e mjaftueshme e mësimeve për përdorimin e kompjuterit në mësimdhënie dhe nxënie;
- Infrastrukturën në shkolla dhe pajisjet;
- Tekstet dhe materialet mësimore;
- Mungesën e përvojës së hartuesve të planeve dhe programeve – në shtrirjen e programit në lëndë dhe fusha të tjera Kurrikulës;
- Mungesën e udhëzuesve për zbatim.

Shikuar në perspektivë, integrimi i moduleve të ECDL-së në kurrikulën e TIK-ut dhe në kurrikulat lëndore, në kudër të fushës kurrikulës gjegjëse, është një alternativë që racionalizon koston e shpenzimeve dhe kohën. Zbatimi në praktikë i integritit të moduleve të ECDL-së në kurrikulën e TIK-ut, si hap i parë duhet t'i paraprijë pajisja me TIK-un. Pa këtë hap nuk mund të flasim për zbatim të suksesshëm.

Kur kemi parasysh se ECDL - 'European Computer Driving Licence' është kualifikim i pranuar ndërkombëtarisht dhe i cili u mundëson individëve të vërtetojnë njohuritë dhe aftësitë kompjuterike, integrimi i moduleve të ECDL-së në kurrikulën e TIK-ut duhet të jetë në harmoni me kriteret e moduleve të ECDL-së dhe me kriteret e kurrikulave bashkëkohore, të njohura në nivel ndërkombëtar.

IX. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Studimi *“ECDL - mundësi e përfitimit dhe e certifikimit të kompetencave për TIK”* është realizuar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës me mbështetje nga ‘ECDL Kosova’. Studimi është realizuar përmes studimit kabinetik dhe studimit në terren. Në studimin në terren janë përfshirë dy komuna dhe katër shkolla (dy gjimnaze dhe shkolla profesionale), me një mostër prej 100 maturantëve/studentëve nga vise të ndryshme të Kosovës.

Studimi *“ECDL - mundësi e përfitimit dhe e certifikimit të kompetencave për TIK”* rezultoi me të dhëna të rëndësishme për përparësitë dhe mangësitë e programeve mësimore të TIK-ut, nivelin e kompetencave të nxënësve për përdorimin e kompjuterit dhe për përvojat.

9.1. Vlerësimi i studimit

Studimi është i bazuar në metodologjinë hulumtuese kuantitative dhe kualitative. Një shembull i mirë ishte përfshirja në mostër të studimit të popullacionit që ka mundur të ofrojë informacione të duhura për fushën e studimit, në mënyrë të veçantë për ndikimin e programeve në fund të shkollës së mesme të ulët dhe të lartë në përvetësimin e kompetencave të nxënësve për përdorimin e TIK-ut.

Një shembull tjetër i mirë ishte kontrolli i kualitetit të të dhënave të studimit, përfshirja në studim e testimi të nxënësve për të evidentuar në mënyrë më të saktë nivelin e kompetencave të nxënësve për përdorimin e kompjuterit, monitorimi i procesit të testimi të nxënësve në modulet e ECDL-së. Gjithashtu, një shembull i mirë ishte edhe ndërlidhja e studimit me të dhënat nga analiza e literaturës, dokumentacioneve relevante, punëtorisë me fokus-grupe dhe vizitës studimore në Zvicër.

Natyrisht, studimi ynë ka pasur edhe kufizimet e veta, të cilat vlen t'i veçojmë:

Koha e realizimit të studimit ka qenë pengesë kryesore. Puna përgatitore dhe realizimi i hulumtimit me nxënës në shkollat e përzgjedhura është bërë në pjesën e parë të muajit korrik dhe në pjesën e dytë të muajit shtator, 2011. Në korrik janë anketuar maurantët/studentët dhe ishte pengesë, sepse brengë kryesore e tyre ishte regjistrimi në Universitet. Kurse, anketimi i nxënësve në shkolla është bërë në javën e tretë të muajit shtator, fillimit të mësimit të rregullt dhe kjo paraqiti vështirësi për organizimin e testimit me nxënës. Megjithatë, vlen për të theksuar se kemi pas përkrahjen e shkollave në këtë proces dhe vetëm me përkrahjen e tyre ne kemi mundur t'i përfshijmë nxënësit në procesin e testimit në modulet e ECDL-së.

Një kufizim tjetër ka qenë mospërfshirja e komuniteteve të tjera në hulumtim.

9.2. Gjetjet më të rëndësishme të studimit

Qëllimi i përgjithshëm studimit “*ECDL - mundësi e përfitimit dhe e certifikimit të kompetencave për TIK*” është të kontribuojë në promovimin e vlerave të ECDL-së për integrim në epokën digjitale në kontekst të zhvillimeve në fushat kurrikulare të arsimit në Kosovë.

Materializimi i kontributit të studimit bëhet përmes ofrimit të mbështetjes dhe ekspertizës profesionale të procesit të rishikimit të kurrikulës në Kosovë, përmes analizës së programeve të TIK-ut, evidentimit të kompetencave të nxënësve për përdorimin e kompjuterit dhe përvojave të avancuara në fushën e TIK-ut, në mënyrë që ato të:

- Tregojnë ku janë përparësitë dhe mangësitë e programeve të TIK-ut dhe ku është niveli i kompetencave të nxënësve në përdorimin e kompjuterit;
- Tregojnë cili është niveli i kompetencave të nxënësve për përdorimin e kompjuterit;

- Japin orientime të qarta dhe të mbështetura në përvoja të mira për mundësitë e integritit të ECDL-së në kurrikula mësimore që sigurojnë nivel të lartë të kompetencave të nxënësve për përdorimin e kompjuterit.

9.2.1. *Gjetjet më të rëndësishme nga analiza e kurrikulave të TIK-ut*

- Fondi i orëve dhe përmbajtjet e TIK-ut në klasat 6-të,7-të dhe 8-të nuk sigurojnë zhvillimin minimal të shkathtësive të nxënësve për përdorimin e kompjuterit;
- Fondi i orëve për përmbajtjet e TIK-ut në klasën e 9-të është në masë të kënaqshme, mirëpo përsëri nuk i mbulon nevojat për zhvillimin e kompetencave të nxënësve për TIK-un në këtë moshë;
- Deri në klasën e 9-të mësohet vetëm programi aplikativ MS Word, kurse programet e tjera MS EXCEL, MS PowerPoint etj. nuk mësohen fare, edhe pse janë të nevojshme për lëndët e tjera mësimore - sidomos MS POWERPOINT, për prezantime dhe forma të tjera të vizuelizimit të përmbajtjeve mësimore në lëndë të ndryshme;
- Teknologjia e informimit dhe komunikimit në arsimin e mesëm të lartë mësohet si lëndë e veçantë;
- Në klasën e 10-të plani dhe programi i teknologjisë së informimit dhe komunikimit është i përbashkët për të gjitha drejtimet e gjimnazeve në Kosovë;
- Ndryshimet e programit të TIK-ut në mes të drejtimeve dhe klasave nuk sigurojnë arritjen e kompetencave minimale për përdorimin e kompjuterit nga të gjithë nxënësit;
- Një numër i konsiderueshëm i rezultateve të pritura mësimore më shumë janë dhënë në formë të deklaratave të synimeve sesa të rezultateve mësimore të matshme;
- Në shkollat profesionale ka mungesë të teksteve të TIK-ut;

- Përmbajtjet e TIK-ut në tekstet në shfrytëzim nuk prezantojnë në masë të duhur zhvillimet në fushën e TIK-ut;
- Një numër i konsiderueshëm i pyetjeve të shtruara në tekste për nxënës, më shumë promovojnë të nxënët teorik sesa atë praktik.

9.2.2. Gjetjet më të rëndësishme nga hulumtimi me nxënës

- Nxënësit pohojnë se i më shumë i kanë përvetësuar shkathtësitë e përdorimit të kompjuterit në shtëpi, në mënyrë të pavarur dhe me përkrahjen e anëtarëve të tjerë të familjes, këtë e pohojnë 45 % e nxënësve të anketuar, pastaj në shkollë 42% e nxënësve, në internet-kafe 7 % e nxënësve, në kurse për përdorim të kompjuterit 2.52 % e nxënësve dhe forma të tjera 3 % e nxënësve;
- Qëllimet kryesore të përdorimit të kompjuterit në internet kafe për nxënësit e klasave 10-të dhe 12-të janë për komunikim me messenger, për facebook dhe për komunikim me e-mail. Kurse për nxënësit maturantë/studentë në vitin e fundit për çështje të mësimit dhe përgatitjes për regjistrim në fakultete;
- Mbi 80 % e nxënësve pohojnë se përpunimi i teksteve në kuadër të mësimit me programin Word-it bëhet vetëm në lëndën e informatikës. Mirëpo, mbi 47 % e tyre thonë se kjo bëhet ndonjëherë;
- Mbi 40 % e nxënësve të anketuar pohojnë se asnjëherë nuk përdoret PowerPoint për prezantimin dhe vizuelizimin e materialeve mësimore. Kurse përqindja tjetër (mbi 47 %) thonë se kjo bëhet vetëm ndonjëherë;
- Rreth 60 % e nxënësve të anketuar të klasës së 10-të dhe 12-të thonë se programet e TIK-ut, të shfrytëzuara në mësim, vetëm në masën *PAK* kanë qenë në funksion të përfitimit të kompetencave për përdorimin e kompjuterit. Kurse mbi 58 % e maturantëve/studentëve kanë thënë *mesatarisht*, por prej tyre

vetëm 46 % e nxënësve të anketuar gjatë konkurrimit për regjistrim në Universitetin e Prishtinës kanë qenë në gjendje ta plotësojnë pa ndihmën e askujt aplikacionin dhe ta dërgojnë në administratën e UP-së;

- Mbi 53 % e nxënësve të anketuar nga klasa e 10-të dhe 12-të kanë dhënë perceptimin e tyre se niveli i kompetencave të mësimdhënësve për përdorim të TIK-ut në mësim është i ulët, kurse mbi 67 % e maturantëve/studentëve thonë se niveli është mesatar.

9.2.3. *Gjetjet më të rëndësishme nga testimi i nxënësve me teste të standardizuara të ECDL-së*

- Prej 208 nxënësve të anketuar me pyetësorë, 108 kanë marrë pjesë në testet e ndryshme të moduleve të ECDL-së. Shumica e theksuar e nxënësve të anketuar që nuk kanë marrë pjesë në testin e standardizuar të ECDL-së nuk kanë qenë të sigurt në kompetencat e tyre për përdorimi e kompjuterit;
- Prej 79 nxënësve që kanë marrë pjesë në testim, vetëm 13 ose 16.45 % kanë kaluar nga një modul. Prej tyre 92.30 % janë nxënës të gjimnazeve;
- Prej 33 nxënësve/studentëve që kanë hyrë në teste të ndryshme, vetëm 10 ose 30.30 % e kanë kaluar në ndonjërin prej moduleve. Prej tyre, vetëm 1 nxënës/student ka arritur të kalojë me sukses 4 module dhe të fitojë të drejtën e certifikimit bazë dhe 2 nxënës/studentë të tjerë kanë arritur të kalojnë nga 3 module. 84 % e maturantëve/studentëve që e kanë kaluar ndonjërin nga modulet e ECDL janë nxënës që kanë mbaruar ndonjërin nga gjimnazet në Kosovë.

Numri në total i nxënësve që kanë kaluar testet sipas moduleve:

- **Modulin 1** - Bazat e teknologjisë së informimit dhe komunikimit (ICT) kanë kaluar 3 (37.80 %) nga 8 studentë⁵³ të testuar;
- **Modulin 2** - Shfrytëzimi i kompjuterit dhe menaxhimi i fajllave (Windows XP) kanë kaluar 10 (33,33 %) nga 30 studentë të testuar dhe 9 (18,75 %) nga 48 nxënës të testuar;
- **Modulin 3** - Përpunimi i teksteve (Word) kanë kaluar 1 (3,45 %) nga 29 studentë të testuar dhe 1 nxënës (2.08 %) nga 48 të testuar;
- **Moduli 4** - Kalkulimi i tabelave (Excel) nuk ka kaluar asnjë nga 30 studentë të testuar;
- **Moduli 5** - Baza e të dhënave (Access) ka kaluar 1(12.50 %) nga 8 studentë të testuar;
- **Moduli 6** - Prezantimet (PowerPoint) kanë kaluar 2 (20 %) nga 10 studentë të testuar dhe 2 nxënës (6.90 %) nga 29 nxënës të testuar;
- **Moduli 7** - Interneti dhe komunikimi (Internet Explorer & Outlook) kanë kaluar 2 (7,69 %) nga 26 studentë të testuar dhe 1 (2.13 %) nga 47 nxënës të testuar;
- TIK - testi i arritshmërisë, në klasën e nëntë arritshmëria është 3.46 prej 5 kërkesave/pyetjeve ose 69.20 %. Në bazë të kriterëve të vlerësimit të nxënësve me nota, këto rezultate mund të vlerësohen me notën mirë, kurse, në bazë të standardeve të ECDL-së, këto rezultate qëndrojnë në pragun minimal të arritjeve;
- TIK- provimi i maturës, arritshmëria është 8.55 prej 15 kërkesave/pyetjeve ose 57 %, për drejtimin e Gjimnazit matematikë - informatikë, kurse 5.69 prej 15 kërkesave/pyetjeve ose 38 % për drejtimet teknike.

⁵³ Studentë i kemi quajtur nxënësit që e kanë mbaruar maturën dhe kanë qenë në proces të aplikimit për regjistrim në fakultet.

9.3. Përfundimi

Studimi tregon se në arsimin e mesëm të ulët, klasat 6-9, lënda mësimore e Teknologjisë me TIK-un përfaqësohet me numër të vogël të orëve mësimore dhe më përmbajtje programore të TIK-ut mjaft të vogël që nuk siguron zhvillimin e kompetencave të nxënësve për përdorimin e kompjuterit raport me jetësimin e kompetencave të përshkruara në kornizën e kurrikulumit dhe në raport me trendët ndërkombëtarë të përgatitjes së nxënësve me kompetencat e TIK-ut.

Studimi tregon se niveli i kompetencave të nxënësve për përdorimin e kompjuterit, i pasqyruar në rezultatet e testimit të nxënësve me teste të standardizuara, është tejet i ulët. Rezultatet e dobëta të nxënësve në testin e standardizuar të ECDL-së lidhen me disa faktorë, mirëpo tre janë faktorët më kryesorë: 1. Përfaqësimi i ulët i TIK-ut në kurrikula mësimore; 2. Përgatitja jo e mjaftueshme e mësimitdhënësve për përdorimin e kompjuterit në mësimitdhënie dhe nxënie; 3. Mungesa e infrastrukturës dhe pajisjeve të TIK-ut në shkolla.

Studimi tregon se nxënësit në Kosovë kanë interesim të shtuar për të arritur kompetencat e duhura në përdorimin e kompjuterit. Nxënësit kërkojnë rrugë dhe mënyra të ndryshme të plotësimit të tyre si: ndjekin kurse të ndryshme të TIK-ut, vijnë në internet-kafe, bëhen autodidaktë në mësimin për përdorimin e kompjuterit, angazhojnë anëtarë të familjes për t'i mësuar etj., mirëpo deri më tani pa sukses. Kjo nënkupton se roli i mësimitdhënies dhe shkollës në përgatitjen e nxënësve me kompetenca të duhura për përdorimin e kompjuterit është i pazëvendësueshëm.

Gjithashtu, studimi tregon se në mesin e mësimitdhënësve, hartuesve të kurrikulave, ekspertëve të TIK-ut, ekziston një kërkesë dhe përkrahje për të integruar modulet e ECDL-së në kurrikulin e TIK-ut dhe kurrikulat lëndore në kuadër të fushave kurrikulare, për faktin se TIK-u vazhdimisht është në zhvillim dhe një prej mundësive që të përcillen këto zhvillime është integrimi i moduleve të ECDL-së në kuadër të

kurrikulave të TIK-ut me argumentin se ECDL-i vazhdimisht i përcjell trendët e zhvillimit të teknologjisë dhe në këtë mënyrë krijohet edhe mundësi që lëndës mësimore e TIK-ut dhe lendeve të tjera t'u ofrohet mundësia e përcjelljes së këtyre ndryshimeve.

9.4. Rekomandime

Nxjerrja e rekomandimeve për trajtimin e drejtë të TIK-ut në arsimin parauniversitar në Kosovë është një përpjekje për të orientuar drejt bartësit e arsimit në nivel qendror dhe lokal, shkollat dhe mësimdhënësit, prandaj rekomandimet i kemi ndarë të veçanta për MASHT-in, DKA-në dhe shkollat.

Për MASHT-in:

- Të vazhdojë me trajnimin e të gjithë mësimdhënësve të arsimit parauniversitar në Kosovë në programin e ECDL-së, si dhe të monitorojë punën e mësimdhënësve të certifikuar me ECDL;
- Të hartohet një platformë e përbashkët në mes të ekspertëve të TIK-ut dhe ekspertëve për hartimin e planeve dhe programeve mësimore për integrimin e moduleve të ECDL-së në shkolla dhe për hartimin e teksteve mësimore e materialeve ndihmëse;
- Të jetësojë projektin për digjitalizimin e shkollave, duke vënë në prioritet pajisjet e shkollave me mjete bashkëkohore të TIK-ut dhe duke përkrahur shkollat në ngritje të kapaciteteve për zbatimin e TIK-ut në procesin mësimor;
- Të krijojë një mekanizëm ligjor për njohje të vlefshmërinë së certifikatave të ECDL-së në sistemin e pikëzimit për regjistrim në klasën e 10-të të shkollës së mesme të lartë dhe për regjistrim në Universitet.

Për DKA-të:

- Të vendosin një sistem funksional të mbikëqyrjes së pajisjeve të TIK-ut në shkolla;

- Të mbështesin shkollat me sistem funksional të rrjetit të internetit;
- Të hartojnë një platformë të përbashkët me partnerë dhe shkolla për të krijuar portalin e ECDL-së për shfrytëzim të burimeve dhe materialeve për procesin mësimor;
- Të ndihmojnë MASHT-in në projektin për digjitalizimin e shkollave dhe në procesin e trajnimit të mësimeve për ECDL-në;
- Të mbështesin shkollat në ndërtimin e kapaciteteve të tyre në përdorimin e kompjuterit;
- Të bëjnë prioritet zhvillimin profesional të drejtorëve të shkollave në TIK.

Për shkolla:

- Të angazhohen në ngritje të kapaciteteve në shkollë për përdorimin e TIK-ut në procesin mësimor;
- Të shfrytëzojnë një pjesë të autonomisë së shkollës për të integruar ECDL-në në shkollë;
- Të përfshijnë iniciativa me kosto konkrete për TIK-un në planet zhvillimore të shkollave të tyre;
- Të ndërtojnë partneritete me komunitetin për TIK-un;
- Të vendosin në prioritet të shkollës ngritjen e kompetencave të nxënësve në përdorimin e kompjuterit.

Referencat:

1. Bit Media Schweiz AG: ECDL barrierefrei - Das Lehrpaket zum Europäischen Computer Führerschein für menschen mit Behinderungen; www.bitmedia.ch
2. Der Europäische Computer Führerschein(ECDL) - Syllabus version 5, Foundation und Österreichischer Computer ECDL www.ecdl.at
3. Die Schweizer Lehrn-und – Arbeitsplattform - educanet², www.educanet2
4. Dieter Backe: Medienkompetenz, www.wikipedia.org
5. DLGI - Dienstleistungsgesellschaft für Informatik mbH: *Daten und Fakten/ECDL*, www.dlgi.de
6. ECDL Core: Kosten, Vorteile,Module,Lehrinhalte,wie kome ich zum ECDL, www.iuec.net
7. ECDL IN Education Austria: ECDL an Schulen, www.edu.ecdl.at
8. ECDL News-Aktuelle informationen zum ECDL: Ernst Karmen - Nichts geht mehr ohne ECDL, Nr.1/2004
9. European Computer Driving License (ECDL) , <http://www.aukonline.org/>
10. Gerhard Tulodziecki: was Schülerinnen und Schüler im Medienbereich wissen und können sollen – Kompetenzmodell und Bildungsstandards für die Medienbildung,Universität Paderborn ,2006. www.dimel-uni-paderborn.de
11. Institut für wirtschaftsinformatik IwI: Qualität und Nutzen der ICT-Anwender –Zertifikate in der Schweiz, Luzern, 2010
12. MASHT: Kornniza e Kurrikulës ,Prishtinë 2011
13. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë: Planet dhe programet mësimore të lëndës mësimore: Teknologjia me TIK (klasa 6 -9 dhe klasa 10 – 12/13) Prishtinë.

14. MSc.Erich Parmmer: Kriterien für ECDL Prüfungen bei behinderten Kindern, 2008, fq1. www.edu.ecdl.at ECDL Core
15. Qeveria e Republikës së Kosovës(2010): Plani i Veprimit 2010 për Zbatimin e Partneritetit Evropian për Kosovën, Prishtinë.
16. Qualität und Nutzen der ICT-Anwender-Zertifikate in der Schweiz, Luzern, 29. April 2010 <http://www.haslerstiftung.ch>
17. Studie zum Europäischen Computerführerschein ECDL: *Schüler finden schneller in der Beruf-* DLGI Bonn, 2008. www.pressebox.de/pressemeldungen/dlgi
18. Trajnimi dhe certifikimi në programin ECDL-AUK, 2010 <http://www.cactus.com>
19. Vildane Kelmendi (2009): Promovimi i mundësive të bashkëpunimit në TIK dhe dialogut rreth politikave me Shtetet e Ballkanit Perendimor, CACTTUS – zyra në Kosovë.
20. Wolfgang Vaupel und Bernd Hoffmann:Ausstattung für das Lernen mit neuen Medien, www.e-nitiative.nrw.de
21. Yalin, H.I, S. Karadeniz and S. Sahin, 2007: Barriers to information and communication technologies integration into elementary schools in Turkey. J. Applied Sci., 7: 4036-4039.

Shtojcat

Shtojca 1:

Përmbajtjet e moduleve të ECDL-së:

Moduli 1. Bazat e teknologjisë së informimit dhe komunikimit (ICT)

Nga ky modul kandidati fiton njohuri të nivelit themelor lidhur me disa nga konceptet kryesore të ICT-së dhe pjesët e ndryshme të kompjuterit.

Në përfundim të këtij moduli çdo kandidat duhet të jetë në gjendje:

- Të njohë harduer-in, faktorët që ndikojnë në performancën e kompjuterit dhe të dijë për pajisjet periferike;
- Të kuptojë se ç'është softueri, të ofrojë shembuj të aplikacioneve të rëndomta softuer-ike dhe sistemeve operative;
- Të njihet përdorimi i rrjetet informative kompjuterike dhe opsionet e ndryshme për t'u lidhur me internetin;
- Të kuptojë se çfarë është Teknologjia Informative dhe Komunikimit (ICT) dhe të ofrojë shembuj të aplikimit të saj praktik në jetën e përditshme;
- Të kuptojë problemet e sigurisë, shëndetit dhe të ambientit në relacion me përdorimin e kompjuterit;
- Të njohë çështjet e rëndësishme të sigurisë, që janë të ndërlidhura me përdorimin e kompjuterit;
- Të njohë çështjet e rëndësishme legale në lidhje me të drejtën autoriale dhe me mbrojtjen e të dhënave gjatë përdorimit të kompjuterit.

Moduli 2. Shfrytëzimi i kompjuterit dhe menaxhimi i fajllave

Nga ky modul kandidati aftësohet të demonstrojë kompetencë në shfrytëzim dhe menaxhim të kompjuterit.

Në përfundim të këtij moduli kandidati do të jetë në gjendje:

- Të shfrytëzojë funksionet kryesore të sistemit operativ, duke përfshirë rregullimin e konfiguracioneve kryesore të kompjuterit dhe duke shfrytëzuar karakteristikat ndihmëse (built-in);
- Të operojë efektshëm me desktop-in dhe të punojë efektshëm me ikona e dritare;
- Të dijë për konceptet kryesore të menaxhimit të fajllave dhe të jetë në gjendje që në mënyrë efektive t'i organizojë fajllat dhe follderët, në mënyrë që të gjinden dhe identifikohen lehtë;
- Të përdorë softuer-ët përcjellës për të komprimuar dhe ekstraktuar fajllat e mëdhenj, të përdorë softuer-in për skanim të viruseve, në mënyrë që ta mbrojë kompjuterin nga ta;
- Të tregojë aftësi në përdorimin e programeve për editim të thjeshtë të tekstit dhe për printim, të cilat janë në dispozicion brenda sistemit operativ.

Moduli 3. Përpunimi i teksteve

Nga ky modul kandidati aftësohet të dëshmojë aftësitë e tij në shfrytëzimin e programit për përpunimin e teksteve për krijimin e letrave dhe dokumenteve të përditshme.

Në përfundim të këtij moduli kandidati do të jetë në gjendje:

- Të punojë me dokumente dhe ruajtjen e tyre në formate të ndryshme;
- Të dijë të bëjë zgjedhjen e opsioneve të integruara, siç është funksioni i ndihmës për ta rritur produktivitetin;
- Të dijë të krijojë dhe të editojë dokumente, që do të jenë të gatshme të distribuohen dhe ndahen;
- Të aplikojë forma të ndryshme të dokumenteve, të avancojë ato para distribuimit, të njohë praktikat e mira për përzgjedhjen e opsioneve të përshtatshme të formatizimit;
- Të insertojë tabela, fotografi dhe objekte grafike në dokumente;

- Të përgatitë dokumente, letra serike;
- Të përshtatë konfigurimin e faqes, të bëjë verifikimin dhe korrigjimin e drejtshkrimit para shtypjes finale të dokumentit.

Moduli 4. Kalkulimi i tabelave

Nga ky modul kandidati informohet për konceptet themelore të kalkulimit të tabelave dhe demonstroi aftësi gjatë shfrytëzimit të programit për kalkulim të tabelave, në funksion të fitimit të rezultateve të sakta të punës.

Në përfundim të këtij moduli kandidati do të jetë në gjendje:

- Të punojë me tabela dhe t'i ruajë ato në formate të ndryshme;
- Të përdorë funksionet e integruara, siç është funksioni i ndihmës në funksion të ruajtjes së produktivitetit të punës;
- Të bëjë futjen e shënimeve në qeliza dhe të përdorë praktikën e mira gjatë krijimit të listave;
- Të zgjedhë, të renditë, të kopjojë, të zhvendosë dhe të fshijë të dhënat;
- Të editojë rreshtat dhe kolonat në fletën punuese;
- Të kopjojë, të zhvendosë, të fshijë dhe të riemërtojë si duhet fletët punuese;
- Të krijojë formulat logjike dhe matematikore duke përdorur funksionet standarde të tabelave;
- Të shfrytëzojë praktikën e mira gjatë punës me formula, njohje e vlerave të gabimit në formula;
- Të bëjë formatizimin e numrave dhe përmbajtjen e tekstit në tabelë;
- Të zgjedhë, të krijojë dhe të formatizojë grafikën, për të komunikuar në mënyrë kuptimplote informacionin;
- Të rregullojë faqen e tabelës dhe të kontrollojë e të korrigjojë përmbajtjen përpara se të ekzekutohet shtypja e tabelës.

Moduli 5. Baza e të dhënave

Nga ky modul kandidati informohet për konceptet bazë të të dhënave dhe aftësohet për demonstrim në shfrytëzimin e tyre.

Në përfundim të këtij moduli kandidati do të jetë në gjendje:

- Të kuptojë se çfarë është baza e të dhënave, si organizohet dhe se si operohet me të;
- Të krijojë një bazë të thjeshtë të të dhënave dhe të shqyrtojë përmbajtjen në mënyra të ndryshme;
- Të krijojë një tabelë, të definojë dhe modifikojë fushat dhe tiparet/karakteristikat e tyre;
- Të shënojë dhe të editojë të dhëna në to;
- Ta radhisë apo filtrojë një tabelë apo formular; të krijojë/modifikojë dhe të ekzekutojë një pyetës (query) për të rifituar informacionin e caktuar nga baza e të dhënave;
- Të krijojë raporte rutinore dhe të përgatisë rezultate/outpute të gatshme për distribuim.

Moduli 6. Prezantimet

Nga ky modul kandidati aftësohet për përdorimin e softuerit për prezantime.

Në përfundim të këtij moduli kandidati do të jetë në gjendje:

- Të punojë me prezantime dhe t'i ruajë ato në formate të ndryshme;
- Të zgjedhë opsionet e integruara, siç janë funksioni i Help-it brenda aplikacionit për ta rritur produktivitetin;
- Të njohë dizajnet e ndryshëm të prezantimeve dhe rastet kur t'i përdorë;
- Të vendosë, të editojë dhe të formatizojë tekstin në prezantime.
- Të ketë përvojë në aplikimin e titujve unik për sllajdet;
- Të zgjedhë, të krijojë dhe të formatizojë diagramet për të komunikuar në mënyrë kuptimplote informacionin;

- Të vendosë dhe të editojë fotografi, imazhe dhe objekte të vizatuara.
- Të aplikojë animacione dhe efekte kalimtare në prezantime dhe të verifikojë dhe korrigjojë përmbajtjen në prezantim para se përfundimisht të shtypet dhe të prezantohet.

Moduli 7. Interneti dhe Komunikimi

Ky modul është i ndarë në dy pjesë.

Në pjesën e parë - Shfletimi i internetit, kandidati informohet për disa nga konceptet dhe nocionet themelore të internetit dhe përdorimit të aplikacioneve të tij.

Në përfundim të këtij moduli kandidati do të jetë në gjendje:

- Të kuptojë çka është interneti dhe termet e zakonshme të ndërlidhura me të, duke përfshirë edhe aspektin e sigurisë gjatë përdorimit të internetit;
- Të kryejë detyra të përditshme në Ueb Brouser, duke përfshirë edhe ndryshimin e konfigurimit të Brouser-it;
- Të kërkojë informacione dhe të kompletojë e të dorëzojë dokumente/formularë elektronikë;
- Të ruaj ue-bfaqe, të shkarkojnë fajlla nga ueb-i/interneti dhe të kopjojë përmbajtje të ueb-it në një dokument.

Në pjesën e dytë - Komunikimi, kandidati informohet për disa nga konceptet themelore të postës elektronike (e-mail), dhe për mundësitë e tjera të komunikimit.

Në përfundim të këtij moduli kandidati do të jetë në gjendje:

- Të kuptojë çka është posta elektronike (e-mail), të dijë për përparësitë dhe mangësitë e përdorimit të saj dhe të njohë mundësitë e tjera të komunikimit;
- Të jetë i informuar për etikën (rregullat e mirësjelljes) e përdorimit të rrjetit dhe aspektet e sigurisë gjatë përdorimit të postës elektronike.

Pyetësor për nxënës që e kanë përfunduar maturën

Tema e hulumtimit:

Kompetencat – aftësitë dhe shkathhtësitë e nxënësve që e kanë përfunduar maturën për përdorimin e kompjuterit

UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E PYETËSORIT

Të dashur nxënës, studentë

Instituti Pedagogjik i Kosovës është duke bërë një studim lidhur me “**ECDL– mundësi e përfitimit dhe e certifikimit të kompetencave për TIK**”. Pjesë e këtij studimi është edhe hulumtimi me nxënësit që e kanë përfunduar maturën, për kompetencat- aftësitë dhe shkathhtësitë e tyre për përdorimin e kompjuterit.

Studimi bëhet me qëllim të marrjes së informacioneve për kompetencat e nxënësve për TIK-un, të fituara gjatë shkollimit të tyre të deritanishëm dhe me qëllim të gjetjes së alternativave më efikase për rritjen e kompetencave të nxënësve për TIK-un dhe certifikimin e tyre.

Saktësia në përgjigje do të na ndihmojë shumë në identifikimin e nivelit të aftësive dhe shkathhtësive të nxënësve për përdorimin e kompjuterit, në hulumtimin e gjetjeve të mundësive për të avancuar kompetencat e tyre për TIK-un, në mënyrë që nxënësit tanë të jenë të barabartë me bashkëmoshatarët e tyre në rajon dhe më gjerë.

Detyrë juaja është që ta lexoni me kujdes secilën pyetje dhe të shkruani, nënvizoni ose plotësoni përgjigjen e mundshme. Secila pyetje ka një ose disa mundësi të përgjigjes, ndërsa detyrë juaja është që të vendosni se cila është reale, që i përgjigjet informacionit që keni dhe kompetencave që keni për TIK-un.

I. Të dhënat personale për nxënës, studentë

Gjinia: M_____ F_____

Emri i shkollës ku keni përfunduar maturën

Tipi i shkollës : Gjimnaz , Shkollë profesionale

Viti i maturës: _____

Vendi: _____

Fakulteti ku i vijoni studimet:

Drejtimi: _____

Vendbanimi: Fshat _____, Qytet _____,

II. Të dhënat lidhur me hulumtimin

1. Sa jeni të informuar me programet kryesore që ofron TIK-u (Word, Excel, PowerPoint, Internet, etj.)?

- a) Shumë
- b) Mesatarisht
- c) Pak
- d) Aspak

2. Ku i keni përfituar aftësitë dhe shkathtësitë kryesore të përdorimit të kompjuterit?

- a) Në shkollë
- b) Në shtëpi dhe në mënyrë të pavarur
- c) Në shtëpi dhe me përkrahje të tjerëve
- d) Në kurse për përdorim të kompjuterit
- e) Në internet-kafe

f) Tjetër (shëno): _____
(*Ju lutem rrethoni vetëm një të përgjigje*)

3. Sa kurse jashtëshkollore keni ndjekur për informatikë?

- a) Një
- b) Dy
- c) Tri – Katër
- d) Pesë ose më shumë
- e) Asnjë

(*Ju lutem rrethoni vetëm një të përgjigje*)

4. A keni poseduar kompjuter në shtëpi gjatë kohës së përfundimit të maturës?

- a) Po
- b) Jo

Nëse PO, për çfarë e keni përdorur atë:

- a) Për të përgatitur detyra mësimore
- b) Për hulumtimin e materialeve të lidhura me mësimin
- c) Për të përgatitur materiale për prezantim në klasë
- d) Për komunikim në Messenger
- e) Për Facebook
- f) Për komunikim me e-mail
- g) Për lojëra

(*Sipas nevojës, rretho më shumë se një të përgjigje*)

5. A keni shkuar në internet kafe gjatë vitit të maturës?

- a) Po
- b) Jo

Nëse PO, për çfarë:

- a) Për të përgatitur detyra mësimore
- b) Për hulumtimin e materialeve të lidhura me mësimin

- c) Për të përgatitur materiale për prezantim në klasë
 - d) Për komunikim në Messenger
 - e) Për Facebook
 - f) Për komunikim me e-mail
 - g) Për lojëra
- (Sipas nevojës, rretho më shumë se një përgjigje)*

6. A është përdorur/zbatuar teknologjia (kompjuteri, (TIK) në kuadër të mësimit në klasën tuaj gjatë maturës?

- a) Shumë shpesh
- b) Shpesh
- c) Ndonjëherë
- d) Nuk është përdorur fare

7. Në cilat lëndë mësimore është bërë përpunimi i teksteve në kuadër të mësimit në klasën tuaj/maturës me programin Word-it?

- a) Në lëndën e informatikës
- b) Në lëndët gjuhësore
- c) Në lëndët shkencore
- d) Në lëndët e artit
- e) Në lëndët e tjera
- f) Nuk është përdorur fare

(Sipas nevojës, rretho më shumë se një përgjigje)

8. Në cilat lëndë mësimore është përdorur TIK-u për prezantime me PowerPoint në mësime?

- a) Në lëndën e informatikës
- b) Në lëndët gjuhësore
- c) Në lëndët shkencore
- d) Në lëndët e artit
- e) Në lëndët e tjera

- f) Nuk është përdorur fare
(*Sipas nevojës, rretho më shumë se një përgjigje*)

9. Sa ju ka aftësuar lënda e TIK-ut për përpunim të teksteve, detyrave dhe prezantimeve në procesin mësimor?

- a) Shumë
b) Mesatarisht
c) Pak
d) Aspak
e) Nuk është bërë të mësuarit përmes TIK-ut.
(*Ju lutem rrethoni vetëm një të përgjigje*)

10. Ju lutemi bëni një vetëvlerësim të sinqertë aftësive tuaja për përdorim të kompjuterit ?

- a) Aftësi shumë të larta
b) Aftësi të kënaqshme
c) Aftësi të mjaftueshme
d) Aftësi të ulëta
e) Nuk di ta përdor fare kompjuterin
(*Ju lutem rrethoni vetëm një të përgjigje*)

11. Nëse mendoni se nuk keni aftësi të larta, të kënaqshme apo të mjaftueshme për përdorim të kompjuterit, cilat kanë qenë arsyet për këtë?

- a) Mosinteresimi i mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollës për cilësi në shkollë
b) Aftësi të ulëta për TIK-un nga vetë mësimdhënësit
c) Mosinteresimi juaj për të arritur aftësi të nevojshme për TIK-un
d) Tjetër (shëno): _____
(*Sipas nevojës, rretho më shumë se një përgjigje*)

12. Sa jeni të sigurt për përdorimin e programeve të kompjuterit:

Nr.	Opsionet e përgjigjeve	Nivelet e sigurisë		
		I/e sigurt	Deri diku	I/e pasigurt
a)	Programi Word			
b)	Programi Excel			
c)	Programi PowerPoint			
d)	Programi Internet			
e)	Program tjetër (shëno programin): _____			

13. Niveli i aftësive dhe shkathtësive për përdorim të TIK-ut nga mësimdhënësit e shkollës tuaj ka qenë:

- a) I lartë
- b) Mesatar
- c) I ulët

(Ju lutem rrethoni vetëm njërin përgjigje)

14. Rëndësia e rritjes së aftësive dhe shkathtësive të TIK-ut për shkollimin tuaj të ardhshëm është:

- a) Shumë e madhe
- b) E madhe
- c) Jo e madhe
- d) Nuk ka fare rëndësi

(Ju lutem rrethoni vetëm njërin përgjigje)

15. Në cilat module të ECDL-së jeni testuar?

- a) Bazat e teknologjisë së informimit dhe komunikimit (ICT)
- b) Shfrytëzimi i kompjuterit dhe menaxhimi i fajllave

- c) Përpunimi i teksteve (Word)
- d) Kalkulimi i tabelave (Exccel)
- e) Prezantimi (PowerPoint)
- f) Interneti dhe komunikimi

16. Në cilat module të testuara keni arritur rezultate më të larta?

- a) Bazat e teknologjisë së informimit dhe komunikimit (ICT)
- b) Shfrytëzimi i kompjuterit dhe menaxhimi i fajllave
- c) Përpunimi i teksteve (Word)
- d) Kalkulimi i tabelave (Excel)
- e) Prezantimi (PowerPoint)
- f) Interneti dhe komunikimi

17. Shkalla e kënaqësisë me realizimin e testimit

Nr	Opsionet e përgjigjeve	Shumë i/e kënaqur	Mesatarisht i/e kënaqur	Aspak i/e kënaqur
a.	Me përmbajtjen e testimit			
b.	Me mënyrën e testimit			
c.	Me angazhimin tuaj			
ç.	Me testuesit			
d.	Me kohën në dispozicion për testim			
e.	Me sallën, pajisjet kompjuterike			
ë.	Me suksesin e arritur			
f.	Tjetër (shëno programin): _____			

18. Nëse nuk jeni të kënaqur me suksesin e arritur, cilat janë arsyet e mosuksesit?

- a) Nuk kam kompjuter në shtëpi

- b) Në shkollën time gjatë maturës nuk është përdorur kompjuteri
- c) Mësimdhënësit në shkollën time nuk kanë zbatuar kompjuterin në mësimdhënie
- d) Nuk kam pasur interesim të mësojë për përdorimin e kompjuterit
- e) Tjetër (shëno) _____
- f) Tjetër (shëno) _____

19. Çfarë do të bëni në javët në vijim për të avancuar shkathtësitë tuaja në përdorimin e kompjuterit?

- a) Nuk do të bëj asgjë
- b) Do të mësoj më shumë për programet e TIK-ut
- c) Do të kërkoj nga familja që të më siguroj një kompjuter
- d) Do të ndjek kurse për përdorimin e kompjuterit
- e) Tjetër (shëno) _____
- f) Tjetër (shëno) _____

20. Ndonjë plotësim, apo koment lidhur me shkathtësitë e nxënësve apo studentëve në përdorimin e kompjuterit (shëno):

Shtojcë 3.

Pyetësor për nxënës të klasës X dhe XII

Tema e hulumtimit:

Kompetencat – aftësitë dhe shkathtësitë e nxënësve të klasës së X dhe XII në përdorimin e kompjuterit

UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E PYETËSORIT

Të dashur nxënës,

Instituti Pedagogjik i Kosovës është duke bërë një studim lidhur me “**ECDL – mundësi e përfitimit dhe e certifikimit të kompetencave për TIK**”. Pjesë e këtij studimi është edhe hulumtimi me nxënës të klasave X dhe XII për kompetencat- aftësitë dhe shkathtësitë e tyre në përdorimin e kompjuterit.

Studimi bëhet me qëllim të marrjes së informacioneve për kompetencat e nxënësve për TIK-un, të fituara gjatë shkollimit të tyre të deritanishëm dhe me qëllim të gjetjes së alternativave më efikase për rritjen e kompetencave të nxënësve për TIK-un dhe certifikimin e tyre.

Saktësia në përgjigje do të na ndihmojë shumë në identifikimin e nivelit të aftësive dhe shkathtësive të nxënësve për përdorimin e kompjuterit, në hulumtimin e gjetjeve të mundësive për të avancuar kompetencat e tyre për TIK-un, në mënyrë që nxënësit tanë të jenë të barabartë me bashkëmoshatarët e tyre në rajon dhe më gjërë.

Detyrë e juaja është që ta lexoni me kujdes secilën pyetje dhe të shkruani, nënvizoni ose plotësoni përgjigjen e mundshme. Secila pyetje ka një ose disa mundësi të përgjigjes, ndërsa detyrë juaja është që të vendosni se cila është reale, që i përgjigjet informacionit që keni dhe kompetencave që keni për TIK-un.

I. Të dhënat personale për nxënës

Gjinia: M _____ F _____

Emri i shkollës ku tani e vijoni mësimin

Tipi i shkollës : Gjimnaz , Shkollë profesionale

Drejtimi: _____

Vendbanimi: Fshat _____, Qytet _____

II. Të dhënat lidhur me hulumtimin

1. Sa jeni të informuar me programet kryesore që ofron TIK-u (Word, Excel, PowerPoint, Internet, etj.)?

- a) Shumë
- b) Mesatarisht
- c) Pak
- d) Aspak

2. Ku i keni përfituar aftësitë dhe shkathtësitë kryesore të përdorimit të kompjuterit?

- a) Në shkollë
- b) Në shtëpi dhe në mënyrë të pavarur
- c) Në shtëpi dhe me përkrahje të të tjerëve
- d) Në kurse për përdorim të kompjuterit
- e) Në internet kafe
- f) Tjetër (shëno): _____

(Ju lutem rrethoni vetëm një të përgjigje)

3. Sa kurse jashtëshkollore keni ndjekur për informatikë?

- a) Një
- b) Dy

- c) Tri - katër
- d) Pesë ose më shumë
- e) Asnjë

(Ju lutem rrethoni vetëm një të përgjigje)

4. A keni poseduar kompjuter në shtëpi gjatë dy viteve paraqake të shkollimit?

- a) Po
- b) Jo

Nëse PO, për çfarë e keni përdorur atë:

- a) Për të përgatitur detyra mësimore
- b) Për hulumtimin e materialeve të lidhura me mësimin
- c) Për të përgatitur materiale për prezantim në klasë
- d) Për komunikim në Messenger
- e) Për Facebook
- f) Për komunikim me e-mail
- g) Për lojëra

(Sipas nevojës, rretho më shumë se një përgjigje)

5. A keni shkuar në internet-kafe gjatë dy viteve paraqake të shkollimit?

- a) Po
- b) Jo

Nëse PO, për çfarë:

- a) Për të përgatitur detyra mësimore
- b) Për hulumtimin e materialeve të lidhura me mësimin
- c) Për të përgatitur materiale për prezantim në klasë
- d) Për komunikim në Messenger
- e) Për Facebook
- f) Për komunikim me e-mail
- g) Për lojëra

(Sipas nevojës, rretho më shumë se një përgjigje)

6. A është përdorur teknologjia/kompjuteri në kuadër të mësimit në klasën tuaj gjatë përfundimit të klasave X dhe XI?

- a) Shumë shpesh
- b) Shpesh
- c) Ndonjëherë
- d) Nuk është përdorur fare

7. Në cilat lëndë mësimore është bërë përpunimi i teksteve me programin e Word-it në kuadër të mësimit në klasë gjatë dy viteve paraprake të shkollimit?

- a) Në lëndën e informatikës
- b) Në lëndët gjuhësore
- c) Në lëndët shkencore
- d) Në lëndët e artit
- e) Në lëndët e tjera
- f) Nuk është përdorur fare

(Sipas nevojës, rretho më shumë se një përgjigje)

8. Në cilat lëndë mësimore është përdorur PowerPoint në kuadër të mësimit në klasën X dhe XI?

- a) Në lëndën e informatikës
- b) Në lëndët gjuhësore
- c) Në lëndët shkencore
- d) Në lëndët e artit
- e) Në lëndët e tjera
- f) Nuk është përdorur fare

(Sipas nevojës, rretho më shumë se një përgjigje)

9. Sa ju ka aftësuar lënda e TIK-ut deri për përpunim të teksteve, detyrave dhe prezantimeve në procesin mësimor?

- a) Shumë
- b) Mesatarisht

- c) Pak
- d) Aspak
- e) Nuk është bërë të mësuarit përmes TIK-ut

(Ju lutem rrethoni vetëm njëzënë përgjigje)

10. Ju lutemi, bëjeni një vetëvlerësim të sinqertë të aftësive tuaja aktuale për përdorim të kompjuterit?

- a) Aftësi shumë të larta
- b) Aftësi të kënaqshme
- c) Aftësi të mjaftueshme
- d) Aftësi të ulëta
- e) Nuk di ta përdor fare kompjuterin

(Ju lutem rrethoni vetëm njëzënë përgjigje)

11. Nëse mendoni se nuk keni aftësi të larta, të kënaqshme apo të mjaftueshme për përdorim të kompjuterit, cilat janë arsyet për këtë?

- a) Mosinteresimi i mësimitdhënësve dhe drejtuesve të shkollës për cilësi në shkollë
- b) Aftësi të ulëta për TIK-un nga vetë mësimitdhënësit
- c) Mosinteresimi juaj për të arritur aftësi të nevojshme për TIK-un
- d) Tjetër (shëno): _____

(Sipas nevojës, rretho më shumë se një përgjigje)

12. Sa jeni të sigurt për përdorimin e programeve të kompjuterit:

Nr.	Opsionet e përgjigjeve	Nivelet e sigurisë		
		I/e sigurt	Deri diku	I /e pasigurt
a)	Programi Word			
b)	Programi Excel			

c)	Programi PowerPoint			
d)	Programi Internet			
e)	Program tjetër (shëno programin): _____			

13. Niveli i aftësive dhe shkathtësive për përdorim të TIK-ut nga mësimmhënësit tuaj në klasat X dhe XI ka qenë:

- a) I lartë
- b) Mesatar
- c) I ulët

(Ju lutem rrethoni vetëm një rën përgjigje)

14. Rëndësia e rritjes së aftësive dhe shkathtësive të TIK-ut për shkollimin tuaj të ardhshëm është:

- a) Shumë e madhe
- b) E madhe
- c) Jo e madhe
- d) Nuk ka fare rëndësi

(Ju lutem rrethoni vetëm një rën përgjigje)

15. Çfarë mendoni të studioni në të ardhmen?

Shëno fakultetin dhe drejtimin:

Ju falënderojmë për bashkëpunim!

Shtojcë 4.

Lista e pjesëmarrësve në punëtorinë për kompetencat e nxënësve për TIK-un dhe rëndësia e integritit të ECDL-së në shkolla

<i>Emri dhe mbiemri</i>	<i>Emri i Shkollës /Institucioni</i>
Agron Zeqiraj	Mësimdhënës - SHMU “Bajram Curri”
Ardian Krasniqi	Mësimdhënës Gjimnazi “Zenel Hajdini”
Myzafer Ademaj	SHMT “Gani Çavderbasha”
Besim Avdimetaj	Inspektor – MASHT/regjion
Nebi Caka	Universiteti i Prishtinës, ekspert vendor për kurrikula
Arbnor Pajaziti	Universiteti i Prishtinës, ekspert vendor për kurrikula
Radica Berishaj	Bashkëkoordinatore e fushës kurrikulare Jeta dhe puna
Binak Gerguri	Bashkëkoordinator i fushës kurrikulare Jeta dhe puna
Esad Simnica	Mësimdhënës – “Shtjefën Gjeqovi”
Valbona Gahi	Mësimdhënëse –“Gjin Gazulli”
Ramush Lekaj	Udhëheqës i Divizionit të cilësisë – MASHT
Zenel Asllani	qendra testuese e ECDL
Bekim Kasumi	‘ECDL-Kosova’
Luljeta Belegu-Demjaha	Universiteti Amerikan AUK
Nezir Çoçaj	Drejtor - Instituti Pedagogjik i Kosovës
Selim Mehmeti	Hulumtues- Instituti Pedagogjik i Kosovës
Haxhere Zylfiu	Hulumtuese - Instituti Pedagogjik i Kosovës
Valbona Kadrijaj	Drejtor - Qendra Trajnimit në KEK

**Zbatimi i përmbajtjeve didaktike „English for
Beginners” në lëndën e Gjuhës angleze në shkollat
profesionale në Kosovë**

Raport i studimit kërkimor



Prishtinë, 2012

Autorë të raportit:

M.Sc.Haxhere Zylfiu

M.Sc.Selim Mehmeti

Ekipi hulumtues:

1. M.Sc.Haxhere Zylfiu - koordinatore e projektit
2. M.Sc.Selim Mehmeti - ekspert për kurrikula, standarde dhe vlerësim
3. Valentina Berisha - Lumezi, eksperte e gjuhës angleze

Përmbajtaja:

Zbatimi i përmbajtjeve didaktike „ <i>English for Beginners</i> ” në lëndën e Gjuhës angleze në shkollat profesionale në Kosovë.....	145
I. Hyrje.....	148
II. Metodologjia e studimit	150
III. Rezultatet e studimit	153
IV. Identifikimi i mundësive për integrim të përmbajtjes „ <i>English for Beginners</i> ” në program/kapituj/ njësi të caktuara në klasë përkatëse.....	195
V Përfundime dhe rekomandime.....	200

I. HYRJE

Ky raport paraqet rezultatet e studimit “Zbatimi i përmbajtjes didaktike elektronike ‘English for Beginners’ në shkollat profesionale në Kosovë”, të realizuar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës, mbështetur nga organizata “Swisscontact”⁵⁴, e cila në Kosovë zbaton projektin “Përkrahje Arsimit Profesional - VES”, të financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim - SCO.

Studimi sjell të dhëna mbi nivelin e përputhjes së materialit didaktik elektronik „English for Beginners” me planet dhe programet mësimore të gjuhës angleze në arsimin profesional (klasat 10, 11 dhe 12) dhe mundësitë për integrim e tij në mësimdhënie dhe nxënie në shkollat profesionale në Kosovë. Të dhënat e studimit janë të mbështetura në analizën dhe krahasimin e përmbajtjes së materialit didaktik elektronik „English for Beginners” me planet dhe programet e gjuhës angleze në arsimin e mesëm të lartë – shkolla profesionale, me tekstet dhe materialet didaktike në shfrytëzim, dhe kanë për qëllim identifikimin e përputhjeve të përmbajtjeve dhe mundësive për integrim të përmbajtjes didaktike „English for Beginners” në program/ kapituj, në klasë të caktuar.

Konteksti i studimit

Instituti Pedagogjik i Kosovës është institucion kërkimor-shkencor publik, që merret me hulumtime, trajnime, vlerësime dhe inovacione në fushën e arsimit. Misioni i Institutit Pedagogjik të Kosovës është që t’i ofrojë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe institucioneve të tjera arsimore mbështetje dhe ekspertizë shkencore e

⁵⁴ “Swisscontact” - është një OJQ globale me seli në Cyrih, Zvicër, e cila promovon zhvillimin e qëndrueshëm privat ekonomik dhe social, qasja e saj është e orientuar në ndihmën e njerëzve për të ndihmuar vetveten.

profesionale, të mbështetur në rezultatet e punës hulumtuese - kërkimore dhe në praktika të avancuara.

Hartimi i përmbajtjes „*English for Beginners*” u iniciua si projekt i përbashkët nga “Swisscontact” dhe “Smart Bits”⁵⁵ dhe u hartua nga një ekip ekspertësh lokalë të fushës. Qëllimi i këtij projekti ishte krijimi i përmbajtjes mësimore elektronike, të përshtatshme për shfrytëzim nga nxënësit e nivelit të arsimit të mesëm, me qëllim të avancimit të njohurive të gjuhës angleze. Kjo përmbajtje u ndërtua duke u bazuar në principin “Lehtë për t’u lexuar, lehtë për t’u kuptuar dhe lehtë për t’u mbajtur në mend”. Përmbajtja mësimore i përmban të gjitha informatat dhe instruksionet e duhura në gjuhën shqipe për mësimin e gjuhë angleze, ndërsa inkorporomi i efekteve multimediale, zërit, dialogëve, testeve dhe kuizeve, e bëjnë mësimin e gjuhës angleze shumë më praktik dhe më atraktiv. Edhe pse kjo përmbajtje u hartua në periudhën njëvjeçare, 2007/2008, deri më tani nuk është bërë ndonjë studim për strukturën, përmbajtjen dhe për mundësinë e integritit të këtij materiali në shkollat profesionale, njëkohësisht dhe nuk ka gjetur zbatim/përdorim në nivelin e dedikuar të arsimit.

Prandaj, në përputhje me misionin e IPK-së dhe me mbështetje nga “Swisscontact” është iniciuar projekti i studimit kërkimor “Zbatimi i përmbajtjeve didaktike ‘*English for Beginners*’ në lëndën e gjuhës angleze në shkollat profesionale në Kosovë”.

⁵⁵ “*Smart Bits*” - është një kompani e specializuar në krijimin e përmbajtjeve mësimore me një përvojë të gjatë pune në Kosovë dhe në Zvicër. “*Smart Bits*” është themeluar në Zug të Zvicrës në vitin 1999, ndërsa përfaqësinë në Kosovë e ka hapur në vitin 2003. Misioni i “*Smart Bits*”-it në Kosovë është përkrahja e reformave dhe avancimi i shoqërisë në fushën e TIK-ut, menaxhmentit dhe lidërshiptit. Në këtë periudhë, “*Smart Bits*” ka arritur të kontribuojë vazhdimisht në avancimin e reformave të arsimit në Kosovë dhe është duke luajtur një rol të rëndësishëm në Zbatimin e Agjendës Digjitale Evropiane.

II. METODOLOGJIA E STUDIMIT

Objekti i studimit

Objekt i studimit janë materiali didaktik elektronik „*English for Beginners*”, planet dhe programet e gjuhës angleze dhe tekstet në shfrytëzim, të klasave 10, 11 dhe 12 në arsimin profesional në Kosovë.

Qëllimet e studimit

Qëllime të studimit janë analiza dhe krahasimi i përmbajtjes së materialit didaktik elektronik “*English for Beginners*” me planet dhe programet e gjuhës angleze në arsimin e mesëm të lartë – shkolla profesionale, me tekstet dhe materialet didaktike në shfrytëzim, identifikimi i përputhjeve të përmbajtjeve dhe mundësive për integrim të përmbajtjes didaktike në program/kapituj për klasë të caktuara, ofrimi i alternativave të reja të shfrytëzimit të materialit mësimor në funksion të arritjes së kompetencave, si dhe vlerësimi i ndikimit pozitiv që mund ta ketë kjo qasje në rezultatet e nxënësve.

Objektivat e përgjithshme të studimit:

- Analiza, krahasimi dhe promovimi i përmbajtjes së materialit didaktik elektronik “*English for Beginners*” në raport me planet dhe programet mësimore, tekstet dhe materialet mësimore të lëndës së gjuhës angleze në shkollat profesionale të Kosovës;
- Hartimi i dëshmive dhe rekomandimeve për integrim në mësimdhënie dhe nxënie të përmbajtjes didaktike “*English for Beginners*” në klasë të caktuara të arsimit profesional;
- Përgatitja e raportit dhe dërgimi për miratim në *MASHT*, me qëllim të pilotimit të tij dhe më vonë licencimit për shtrirje të Zbatimit në shkolla profesionale.

Objektivat specifike të studimit:

- Analiza e plan- programeve dhe përmbajtjeve mësimore të lëndës së Gjuhës angleze në shkollat profesionale të Kosovës dhe krahasimi me materialin didaktik “*English for Beginners*”;
- Analiza e teksteve dhe materialeve didaktike në shfrytëzim, për realizimin e lëndës së Gjuhës angleze në shkollat profesionale të Kosovës me materialin didaktik “*English for Beginners*”;
- Studimi i strukturës dhe përmbajtjeve të materialit didaktik elektronik “*English for Beginners*”;
- Identifikimi i përputhjeve në strukturë dhe përmbajtje i planeve dhe programeve, teksteve dhe materialeve mësimore të lëndës së Gjuhës angleze me strukturën dhe përmbajtjen e materialit didaktik elektronik “*English for Beginners*”;
- Identifikimi i mundësive për integrim të përmbajtjes “*English for Beginners*” në program/kapituj/njësi të caktuara, në klasë të caktuar.

Pyetjet kryesore që e kanë orientuar studimin:

- A është përmbajtja e materialit didaktik elektronik “*English for Beginners*” në përputhje me planet dhe programet zyrtare të gjuhës angleze në arsimin profesional?
- A është përmbajtja e materialit didaktik elektronik “*English for Beginners*” në përputhje me tekstet dhe materialet didaktike që aktualisht janë në shfrytëzim në klasat 10, 11 dhe 12 të arsimit profesional në Kosovë?
- Për cilat klasë të arsimit profesional është i përshtatshëm materiali didaktik elektronik “*English for Beginners*”?

Metodat dhe instrumentet e studimit

Në studim janë përdorë metoda e analizës teorike, metoda përshkruese, metoda krahasuese dhe metoda e analizës statistikore.

Ndërsa, instrumentet e shfrytëzuara për realizimin e studimit ishin: dëshmitë e dokumentacionit shkollor dhe materialit mësimor (planet dhe programet e gjuhës angleze për shkollat profesionale për klasat 10, 11 dhe 12, tekstet dhe materiali didaktik elektronik “English for Beginners”.

2.1. *Procesi i realizimit të studimit*

Pas hartimit të planit të detajuar të aktiviteteve për realizimin e secilës objektivë të planifikuar në studim, për arsye të lehtësimit të punës krahasuese të materialit didaktik elektronik „English for Beginners” me planet dhe programet mësimore, me tekstet dhe materialet e tjera në shfrytëzim në shkollat profesionale të Kosovës, është bërë një përshtatje e materialit nga versioni elektronik - CD në atë të shkruar/shtypur. Janë identifikuar dhe dokumentuar përmbajtjet dhe objektivat e secilës njësi/lesson në kuadër të Unit I, Unit II dhe Unit III në materialin didaktik, përfshirë këtu temën e njësisë /lesson, pjesën gramatikore, fjalorin, zbatueshmërinë në anglishten e përditshme, pjesën e të lexuarit, të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit, pjesën e ushtrimeve, si dhe testin përmbledhës në fund të secilës njësi/lesson. Pastaj është bërë studimi dhe krahasim i përmbajtjes së evidentuar me planet dhe programet mësimore të klasave 10, 11 dhe 12. Janë identifikuar pikat tanguese të përmbajtjeve dhe objektivave të materialit didaktik elektronik “*English for Beginners*” me përmbajtjet dhe objektivat e planeve dhe programeve, specifikuar në tema, njësi të klasës së caktuar. Paralelisht është realizuar edhe krahasimi i materialit didaktik me tekstet dhe materialet përcjellëse të lëndës së gjuhës angleze në shfrytëzim në shkollat profesionale në Kosovë, gjegjësisht në klasat 10, 11 dhe 12. Janë identifikuar përmbajtjet dhe objektivat e përbashkëta të njësive të caktuara nga tekstet e lëndës së Gjuhës angleze dhe të materialit didaktik, veçanërisht pikat tanguese në rezultatet e pritura për shkathësitë kryesore (të lexuarit, të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit), si dhe elemente të favorizuara të materialit

didaktik elektronik, krahasuar me tekstin edhe materialin në shfrytëzim (specifikuar në temë, njësi dhe klasë të caktuar).

Bazuar në gjetjet e studimit, janë identifikuar mundësitë për integrim të përmbajtjeve të materialit didaktik elektronik “*English for Beginners*” (të identifikuar si të favorshme për integrim) në procesin e realizimit të lëndës së Gjuhës angleze në klasat përkatëse, në shkollat profesionale në Kosovë. Materiali i dokumentuar i studimit prezantohet në MASHT, gjegjësisht në Sektorin e arsimit profesional, dhe shqyrtohen mundësitë për licencimin e materialit didaktik elektronik dhe miratimin për pilotimin dhe Zbatimin të materialit në shkolla profesionale (faza II dhe III e projektit). Planifikimi i promovimit dhe pilotimit të materialit në 4 shkolla profesionale të Kosovës i paraprin realizimit të fazave II dhe III të projektit.

III. REZULTATET E STUDIMIT

3.1. Materiali didaktik elektronik “English for Beginners”- struktura dhe përmbajtja e përgjithshme

Materiali didaktik elektronik “English for Beginners” është material i hartuar nga një grup ekspertësh të fushës, mbështetur nga “Smart bits Kosova” dhe “Swiss Contact” (Cooperation Office Kosova), i dedikuar për nivelet fillestare të gjuhës angleze. Përmbajtja e këtij materiali është e përpiluar sipas metodologjisë bashkëkohore të të nxënit, i përmbledhur në formë elektronike në një CD. Përmbajtja është e klasifikuar në tre module bazë (Unit-e), të cilat pastaj janë të shkoqitura në 24 leksione (njësi mësimore).

Përmbajtja e secilës njësi është e zërthyer në fusha përkatëse përmbajtjesore:

- Hyrje në njësi, që përfshin informacionin për përmbajtjen e njësisë;

- Fondin e fjalëve, që përfshin elementet e pasurimit të fjalorit me fjalë dhe shprehje të reja (mbi bazën e temës);
- Pjesa gramatikore;
- Të lexuarit;
- Të dëgjuarit;
- Të shkruarit;
- Të folurit;
- Struktura e anglishtes;
- Testimi i njohurive për përmbajtjet në kuadër të njësive, sipas kërkesave bashkëkohore të evoluimit;
- Vlerësimi i njohurive për përmbajtjet në fund të çdo moduli (Unit-i), sipas kërkesave bashkëkohore të evoluimit.

Në funksion të përvetësimit të përmbajtjeve të specifikuar në këto fusha përmbajtjesore, materiali didaktik elektronik *“English for Beginners”* u ofron nxënësve mundësi mjaft praktike për punë kreative.

Faqja e parë në materialin e CD-së ofron një pamje të përgjithshme që përfshin titullin e materialit didaktik elektronik, si dhe rangimin e moduleve / Unit-eve (fig. 1), ndërsa faqja e punës në versionin elektronik të përmbajtjes (fig. 2) ofron mundësi fleksibile për punë të pavarur dhe kreative të nxënësve.



Fig 1. Përmbajtja e faqes së parë e materialit didaktik elektronik “English for Beginners”



Fig 2. Faqe pune e materialit didaktik elektronik “English for Beginners”

Në fillim të materialit të një moduli (Unit-i) ofrohet lista e njësisve mësimore/lessons dhe me klikim mbi njësinë e caktuar thirret dhe hapet faqja përkatëse e punës.

<p>Unit I</p> <p>Lesson 1 - Greetings and Introductions</p> <p>Lesson 2 - The World Around Me</p> <p>Lesson 3 - My friends and I</p> <p>Lesson 4 - A Day in the Life of a Teacher</p> <p>Lesson 5 - The Workplace</p> <p>Lesson 6 - Talking about Work</p> <p>Lesson 7 - The Ideal Office</p> <p>Lesson 8 - The Interview</p> <p>Check Module I - Quiz</p>
--


Fig 3. Lista e njësisve/lessons në kuadër të Unit I

Faqja e hapur e punës është e përbërë nga disa instrumente të punës, shfrytëzimi me sukses i të cilëve në shkallë të lartë lehtëson procesin e të mësuarit të përmbajtjeve mësimore. Është me rëndësi të ceket se manipulimi me instrumente të caktuara punuese në përgjithësi nuk

kërkon njohuri dhe aftësi të larta të nxënësve për përdorimin e kompjuterit.

Në anën e majtë të faqes punuese (rrethimi 1 në fig. 3) ofrohet lista e fushave përmbajtësore të njësisë, ku nxënësi pastaj me klikim mund të lëvizë dhe shfletojë, sipas nevojës, përmbajtje të caktuara. Në pjesën e sipërme të faqes (rrethimi 2 në fig. 3) ofrohen komanda për lëvizje në përmbajtjen caktuar (“Kthehu”, “Lartë”, “Vazhdo”, “Printo” dhe “Extra”).

Në anën e djathtë të faqes punuese (rrethimi 3 në fig. 3) ofrohen instrumentet punë ndihmëse në përmbajtje. Me klikim mbi shenjën e lapsit hapet faqja e zbrazët e punës dhe jepet mundësia e mbajtjes /shkrimit së shënimeve për njësinë e caktuar. Klikimi mbi shenjën e informacionit hap faqen informative, ku ofrohen informacione, kryesisht të aspekteve gramatikore, për njësinë e caktuar, ndërsa me klikim mbi shenjën e **a/z** hapet faqja e fjalorit dhe pastaj përdoruesi mund të lëvizë dhe kërkojë për fjalën që ka interesim për përkthim dhe informacion. Është me rëndësi të përmendet se çdo informacion i ofruar, si rezultat i përdorimit të këtyre instrumenteve punuese, është në gjuhën angleze dhe shqipe, gjë që i mundëson nxënësit të kuptojë, të krahasojë dhe të mësojë më lehtë përmbajtjet.



*Fig 3.
Instrumentet e
punës në faqen
punuese të
testit vlerësues*


Përvetësimi i përmbajtjeve mësimore në kuadër të njësisë/lesson të caktuar ofrohet përmes tri formave kryesore të punës:

1. Forma tekstuale, që ofrohet në faqen punuese, e cila mundëson ushtrim të të lexuarit të përmbajtjes mësimore;


Shembull:

This, these

- **This** girl is my best friend.
 - **This** pen is red.
 - **This** flat is small.
 - **This** room is big.
2. Forma audio (e zërit) që ofrohet pas klikimi të instrumentit punues (rrethimi 4 në figurën që mundëson të dëgjuarit e përmbajtjes mësimore, me mundësi të pauzës dhe ridëgjimit sa herë që nxënësi ka nevojë;



3. Forma ilustrative e paraqitjes së përmbajtjes, që mundëson konceptim vizuel të përmbajtjes mësimore.



Zhvillimi i të gjitha përmbajtjeve mësimore të njërive/lessons mundësohet gjithashtu përmes instruksioneve të qarta, të dhëna në gjuhën shqipe, të cilat japin orientim për përmbajtjet vijuese, si dhe udhëzojnë mjaftueshëm nxënësin për hapat që duhet ndjekur për zgjidhjen e detyrave të caktuara.

Shembull1: Përemri dëftor **'this'** përdoret për të treguar për një njeri apo objekt që ndodhet afër nesh.

Shembull 2:

Dëgjoni dialogjet në vijim si dhe ushtroni shqiptimin dhe leximin e përemrave pronor në Gjuhën Angleze.


Gjithashtu, për më shumë informata dhe sqarime, si dhe për përkthimin e detajuar, sidomos të përmbajtjeve gramatikore, në disa raste ofrohet alternativa e klikimit (kliko [këtu](#)), me ç'rast hapet faqja me informacionet shtesë.

Shembull:

Për më shumë informata dhe sqarime, si dhe për përkthimin e detajuar të përdorimit të foljes ‘TO BE’ (në Simple Present Tense) dhe të përemrave pronorë klikoni këtu.⁵⁶

Në kuadër të njëjësive mësimore/lessons, kryesisht pas fushave kryesore përmbytjesore (të lexuarit, të dëgjuarit, struktura e gjuhës angleze), me qëllim të mbikëqyrjes së ecurisë dhe rocesit të përparimit të nxënësve, në materialin didaktik “English for Beginners” janë të integruara testet formuese, të cilat realizohen kryesisht përmes:


1. Klikimit në alternativat e dhëna në faqen punuese;




2. Plotësimit të hapësirave të zbrazëta në faqen punuese në funksion të kontrollimit të të kuptuarit;

56

Personal Pronoun and the verb “To Be” in Simple Present Tense		Përemri vetor dhe folja “Jam” në kohën e tashme	
I	am	Unë	jam
You	are	Ti	je
He / She / It	is	Ai / Ajo	është
We		Ne	jemi
You	are	Ju	jeni
They		Ata/Ato	janë





- Radhitjes së drejtë të fjalëve në fjali, apo të pozitës së fjalive në tekst, varësisht nga të dëgjuarit apo lexuarit e tekstit paraprak.



Ka edhe alternativa të tjera punuese në testet e dhëna, si plotësimi i hapësirave të zbrazëta me versionin e drejtë të fjalëve apo foljeve të dhëna në kllapa, plotësim me klikim nga lista shpaluese, etj.

Faqja punuese e teksteve, instrumenti punues në të, mundëson vlerësim të rezultateve në test përmes klikimit të komandës “Vlerëso” (“Evaluate”), si dhe ofron mundësinë e shfaqjes së përgjigjeve të sakta (shiko rrethimin 6 në figurën 4), pas përfundimit të testit dhe me klikim mbi komandën “Shiko zgjidhjen” (“Show Solution”).



*Fig. 4. 4.
Instrumentet e
punës në faqen
punuese të
testit formues*

Testi përmbledhës (moduli kontrollues) në fund të secilës njësi/lesson përbëhet kryesisht nga gjashtë nënteste dhe përcakton arritjet e nxënësve për njësinë e caktuar. Realizohet përmes të njëjtave procedura, sikurse testet formuese, mirëpo në fund të procesit instrumenti i faqes punuese (shiko rrethimin 5 në figurën 3) ofron katër alternativa punuese: shfaqjen e rezultateve të testit (“Test Results”), përsëritjen e testit (“Reset”), shfaqjen e pikëve fituese (“Send Score”) dhe printimin e rezultateve (“Print”).



Gjithsesi, përdorimi i suksesshëm i të gjitha formave dhe instrumenteve të punës kërkon përkushtim dhe angazhim të plotë të përdoruesit (mësimdhënësit dhe nxënësit), por, në anën tjetër, ofron kreativitet dhe rezultat pozitiv të punës.

3.1.1. Moduli I (Unit I) - struktura dhe përmbajtja

Materiali didaktik elektronik, i përfshirë në Unit I, është i përbërë nga 8 njësi mësimore

(Lessons):

Lesson 1: Greetings and Introductions

Lesson 2: The World Around Me

Lesson 3: My Friends and I

Lesson 4: A Day in the Life of a Teacher

Lesson 5: The Workplace

Lesson 6: Talking about Work

Lesson 7: The ideal Office

Lesson 8: The Interview

Check Module I - Quiz.

Përmbajtja e secilës njësi është e zbërthyer në fushat kryesore përmbajtjesore të pjesës gramatikore, zhvillimit të të folurit, të të lexuarit, të të dëgjuarit, të të shkruarit, zhvillimit të anglishtes së përditshme, pasurimit të fondit të fjalëve, testimi dhe vlerësimi të njohurive për përmbajtjet e caktuara.

Në njësitë e para të këtij moduli ofrohen përmbajtje të thjeshta mësimore, si folja “**To Be**”, ndajfoljet e shpeshësisë për të përshkruar rutinën ditore dhe preferencat personale që mund të kemi, ndërsa në

njësitë vijuese vjen duke u zgjeruar dhe thelluar përmbajtja dhe fondi i fjalëve .

Përmbajtjet mësimore të Modulit I (Unit I), të evidentuara dhe të specifikuara mbi baza të fushave të njërive/lesson të caktuara, janë të bashkëngjitura në formë të shtojcës⁵⁷ në këtë raport.

Rezultatet e pritura të përmbajtjeve mësimore gjithsesi i kanë specifikat dalluese të kërkesës, por në përgjithësi janë të ndërlidhura ngushtë dhe kanë kontinuitet të arritshmërisë nga njësia në njësi dhe janë në funksion të përgatitjes së nxënësit në mënyrë që ai:

Lesson 1: Greetings and Introductions

- Të kuptojë informata thelbësore të shkurtra dhe shprehje të thjeshta;
- Të përdorë foljen “**To Be**” në kohën e tashme dhe në të gjitha trajtat;
- Të dallojë shtetet /nacionalitetet, të dijë të përshëndesë në mënyrë formale dhe joformale;
- Të zhvillojë biseda të kufizuara.

Lesson 2: The World Around Me

- Të përshtatet në situata të përditshme (në dyqan, stacion, qytet);
- Të dijë të përdorë drejt të gjitha trajtat e foljes “**To Be**”;
- Të dijë të emërtojë vende me interes në qytet.

Lesson 3: My Friends and I

- Të kuptojë, të flasë, të dëgjojë, si dhe të shkruajë për përditshmërinë (me fjalë të thjeshta);
- Të mund t’i thotë numrat dhe të tregojë për kohën-orën me kujdes në parafjalë;
- Të dijë për një numër të limituar emrash në numrin shumë.

⁵⁷ Shtojca 1-Moduli I (Unit I)

Lesson 4: A Day in the Life of a Teacher

- Të përdorë fjalorin për rutinën ditore, shprehitë që kemi dhe kohën kur këto ndodhin;
- Të përdorë ndajfoljet e shpeshtësisë, si pjesë thelbësore të kohës së tashme;
- Të përdorë kohën e tashme vetëm në numrin njëjës, në të gjitha trajtat;
- Të flasë për preferencat personale (formë e limituar).

Lesson 5: The Worlpace

- Të flasë për rutinën ditore, duke përdorur ndajfoljet e shpeshtësisë me saktësi;
- Të kërkojë përsëritje të gjërave që nuk i ka kuptuar;
- Të dijë të kërkojë ndjesë;
- Të dijë të emërtojë disa nga profesionet dhe detyrat e tyre (përshkrimi i tyre);
- Të përdorë si duhet parafjalët e vendit, lëvizjes/shkuarjes.

Lesson 6: Talking about Work

- Të komunikojë me shprehje të caktuara në raport me kolegët dhe punën;
- Të dijë të caktojë takime dhe gjërat që duhet të merren parasysh (orën, ndarjen e detyrave etj.);
- Të dijë për ditët e javës dhe shumësin e tyre, stinët, muajt dhe shqiptimin e drejtë të tyre, duke u kushtuar vëmendje parafjalëve që përdoren me javë, ditë, muaj, që shkaktojnë një problem të vazhdueshëm tek ata që e mësojnë gjuhën angleze.

Lesson 7: The ideal Office

- Të bëjë përshkrimin e ambientit në të cilin ndodhet, sidomos atë të punës, pasi fondi i fjalëve të kësaj njësie ka të bëjë me zyrën, punën dhe gjërat që i gjejmë në zyrë;

- Të tregojë për pozitën e gjërave që e rrethojnë;
- Të dijë të përdorë me korrektësi fjalët “**Some/Any**” dhe disa kombinime me po këto fjalë.

Lesson 8: The Interview

- Të përsërisë dhe të përforcojë fjalë për të dhënë informata personale;
- Të përdorë folje të caktuara modale “**Can**” për të treguar aftësi;
- Të përdorë folje të caktuara për të treguar për tipare (pronësi) që ka personi;
- Të jetë i suksesshëm në intervistë për punë.

Check Module I- Quiz - Nxënësi duhet të jetë në gjendje të zotërojë pjesën gramatikore:

- Folja “**To Be**” **there is/there are,**
- **Possessive adjectives,**
- **Singular and Plural of Nouns,**
- **Present Simple, Can,**
- **Preposition of movement/place,**
- **Articles, Have/have got,, Some/any, This/that/these/those,**
- **Preposition of time.**

3.1.2. Moduli II (Unit II) - struktura dhe përmbajtja

Materiali didaktik elektronik, i përfshirë në Unit II, është i përbërë nga 8 njësi mësimore

(Lessons):

Lesson 10: Shopping

Lesson 11: Now.....Then

Lesson 12: Telling a Story

Lesson 13: Reasons

Lesson 14: At a dinner

Lesson 15: Quantities

*Lesson 16: The difference between
Lesson 17: Responsibilities and Advice
Check Module II - Quiz.*

Përmbajtja e secilës njësi është e zërthyer në fushat kryesore përmbajtjesore të pjesës gramatikore, zhvillimit të të folurit, të të lexuarit, të të dëgjuarit, të të shkruarit, zhvillimit të anglishtes së përditshme, pasurimit të fondit të fjalëve, testimin dhe vlerësimin të njohurive për përmbajtjet e caktuara. Nga ky modul nxënësit krijojnë mundësi të tregojnë diçka që u ka ndodhur në të kaluarën, duke përdorur kohën e kryer të thjeshtë (**Past Simple**), pasi që supozohet se ata tanimë e kanë përvetësuar kohën e tashme (**Present Simple**). Fondi i fjalëve është më i zgjeruar dhe krijon mundësi që nxënësi të jetë në gjendje të kuptojë dhe të përdorë informacionin, të bëjë përshkrim e ambientit që e rrethon, të flasë për preferencat e tij me një fond më të zgjeruar të fjalëve dhe të shprehjeve.

Përmbajtjet mësimore të Modullit I (Unit I), të evidentuara dhe të specifikuara mbi baza të fushave të njësive/lesson të caktuara, janë të bashkëngjitura në formë të shtojcës⁵⁸ në këtë raport.

Rezultatet e pritura të përmbajtjeve mësimore gjithsesi i kanë specifikat dalluese të kërkesës, por në përgjithësi janë të ndërlydhura ngushtë dhe kanë kontinuitet të arritshmërisë nga njësia në njësi, dhe janë në funksion të përgatitjes së nxënësit në mënyrë që ai:

Lesson 10: Shopping

- Të dijë të kërkojë ndihmë në situata të ndryshme, si në dyqane, sa i përket blerjes dhe njohjes me valutat;
- Të dijë të informohet, të pyesë për vendndodhjen e gjërave /objekteve të ndryshme në qytet;
- Të përdorë drejt foljen “**Can**” për të shprehur mundësi, aftësi, leje në të gjitha trajtat.

⁵⁸ Shtojca 2-Moduli II (Unit II)

- Të përdorë drejt parafjalët për vendndodhjen/raportin e vendeve-objekteve-gjëseneve me bashkëbiseduesin.

Lesson 11: Now.....Then

- Të tregojë dhe të përshkruajë një ngjarje (pushim) që ka ndodhur në të kaluarën me përdorimin e foljes ndihmese “**Be**” në të gjitha trajtat;
- Të dijë si të përdorë foljet e RREGULLTA në “**Past Tense**”;
- Të dallojë ndryshimet që mund të pësojë folja pas mbaresës që merr në “**Past Tense**”;
- Të pasurojë fjalorin sa i përket përshkrimit të festave dhe çfarë ndodh në këto festa.

Lesson 12: Telling a Story

- Të tregojnë me sukses dhe të bisedojnë për të kaluarën, duke përdorur foljet e rregullta dhe të parregullta;
 - Të përdorë shprehje në “**Past Tense**”;
 - Të mund të tregojë ngjarje me sekuenca të shkurta;
 - Të përdorë numrat rendorë;
- Të kuptojë tekste dhe të jetë në gjendje të japë informacione për atë çfarë ka dëgjuar dhe lexuar.

Lesson 13: Reasons

- Të bëjnë identifikimin e llojit të fjalive (pohore, pyetëse, mohore), në mënyrë që të mund të përdorë drejt fjalët dhe kombinimet që kanë të bëjnë me “**Some/Any**” , duke mos anashkaluar as identifikimin e emrave (të numërueshëm/të panumërueshëm);
- Të dijë të përdorë përemrat lidhorë si duhet, sepse në ushtrime u është dhënë theks i veçantë;
- Të dijë të emërtojë një numër të caktuar të gjërave dhe mjeteve që na rrethojnë.

Lesson 14 At a dinner

- Të dijë të bëjë porosinë e ushqimit/pijeve në situatën reale, pra në restorant, duke qenë i kujdesshëm në përdorimin e shprehjes “**Would like**” në të gjitha format;
- Të bëjë dallimin e strukturës dhe modelit gramatikor që mund të ketë folja **Like - +To/+Ing**;
- Të flasë për të dhëna personale si dhe për preferencat-hobin që ka, sepse disa nga shprehjet përsëriten nga mësimet e mëparshme.

Lesson 15: Quantities

- Të përshkruajë një ambient me të gjitha gjërat që e rrethojnë, raportin e tyre përballë njeri-tjetrit dhe ngjyrën e tyre;
- Të bëjë përshkrime për emrat e numërueshëm / të panumërueshëm dhe përdorimin/shqiptimin e drejtë të fjalëve, si: **a few, a lot of, a couple of, how many/ how much.**

Lesson 16: The difference between

- Të dijë të bëjë krahasimin e mbiemrave një, dy e më shumë rrokësh si duhet, sepse ka mjaft ushtrime rreth përdorimit të tyre;
- Të aplikojë këta mbiemra kur duhet, të përshkruhen dallimet në situata të ndryshme, duke mos anashkaluar edhe përdorimin e shkallës sipërore;
- Të përdorë drejt të gjitha format e foljeve **Have/Have got**, meqenëse këto folje janë të trajtuara edhe në njësinë 8 të Modullit I.

Lesson 17: Responsibilities and Advice

- Të përdorë foljet modale si duhet, meqenëse ato kanë përdorim të gjerë dhe të larmishëm;

- -Të jetë në gjendje të tregojë për obligimet që ka apo që ka pasur, si dhe të japë ndonjë këshillë;
- Të kërkojë leje për të bërë diçka ose të shtrojë ndonjë kërkesë për tjetrin;
- Të mund t'i shkruajë shokut/shoqes një letër jozyrtare.

Check Module II- Quiz

Me ushtrimet dhe detyrat që përmban kjo pjesë nxënësit i mundësohet edhe një herë të bëjë një vlerësim të gjithmbarshëm të përmbajtjeve të materialit që është punuar në Modulin II (Unit II). Pjesëve gramatikore u është dhënë theks i veçantë, pa e lënë anash as shkrimin e drejtë (korrekt). Pra, pjesët gramatikore që ushtrohen janë:

- **Past Tense** - foljet e rregullta/ të parregullta, përcaktoret e sasisë (a few, a little , a couple of, a little...),
- Kombinimet me **any/some**, parafjalët **In,At,On**, emrat dhe shumësi i tyre.

3.1.3. Moduli III (Unit III) - struktura dhe përmbajtja

Materiali didaktik elektronik, i përfshirë në Unit III, është i përbërë nga 7 njësi mësimore (Lessons):

Lesson 18: Describing People and Their Actions

Lesson 19: We are at the Moment Working On

Lesson 20: Planning the Future

Lesson 21: Thinking About and Predicting the Future

Lesson 22: Getting Information

Lesson 23: Written Communication

Lesson 24: Experience

Check Module III- Quiz.

Përmbajtjet mësimore të këtij moduli u dedikohen përfituesve që kanë njohuri paraprake për gjuhën angleze të niveleve STARTER dhe

ELEMENTARY. Zgjerimi i fondit të fjalëve dhe shprehjeve, si dhe pjesës gramatikore, është vazhdimësi e modulit paraprak, me zgjerim dhe thellim të pjesës gramatikore me **Present Perfect, Will/Going To dhe Përemrat lidhor**. Përmbajtja e secilës njësi është e zërthyer në fushat kryesore përmbajtjesore të pjesës gramatikore, zhvillimit të të folurit, të të lexuarit, të të dëgjuarit, të të shkruarit, zhvillimit të anglishtes së përditshme, pasurimit të fondit të fjalëve, testimin dhe vlerësimit të njohurive për përmbajtjet e caktuara.

Përmbajtjet mësimore të Modullit III (Unit III), të evidentuara dhe të specifikuara mbi baza të fushave të njësive/lesson të caktuara, janë të bashkëngjitura në formë të shtojcës⁵⁹ në këtë raport.

Rezultatet e pritura të përmbajtjeve mësimore gjithsesi i kanë specifikat dalluese të kërkesës, por në përgjithësi janë të ndërlydhura ngushtë dhe kanë kontinuitet të arritshmërisë nga njësia në njësi, dhe janë në funksion të përgatitjes së nxënësit në mënyrë që ai:

Lesson 18: Describing People and Their Actions

- Të bëjë dallimin dhe të dijë të përdorë **“Present Simple”** dhe **“Present Cont”** për veprime që ndodhin në momentin kur bisedohet;
- Të përshkruajë njerëzit, tiparet, karakteret e tyre, dhe njëkohësisht të mund të dallojë ngjyrat, format dhe stilet;
- Me sqarimet e dhëna në pjesën gramatikore dhe ushtrimet gramatikore duhet t'i dijë dhe t'i përdorë përemrat lidhorë - **Relative Pronouns**.

Lesson 19: We are at the Moment Working On

- Pasi në këtë njësi është përsëritur përdorimi i **“Present Cont”**, duhet të përdorin këtë kohë si duhet, kur gjinden në situata të ndryshme dhe të tregojnë çfarë po bëjnë në momentin kur bisedohet;

⁵⁹ Shtojca 3 - Moduli III (Unit III)

- Të përvetësojnë fjalorin dhe të plotësojnë fondin e fjalëve që kanë të bëjnë me punën dhe përgjegjësitë;
- Të bëjnë pyetje për të kërkuar një informacion të caktuar, pasi në gjuhën angleze ekzistojnë struktura të veçanta (të cilat janë shpjeguar mjaft mirë në pjesën gramatikore).

Lesson 20: Planning the Future

- Të përvetësojë foljen “Be” në **Present Simple** edhe në **Past Simple**, sepse edhe një herë i kushtohet vëmendje shpjegimit dhe trajtave të saj;
- Të japë sugjerime me fjalë dhe shprehje të caktuara, si dhe të mund të flasë dhe të tregojë për planet dhe synimet që ka në të ardhmen, duke përdorur “**Going To**”;
- Të dijë të gjendet në vendet që kanë të bëjnë me udhëtime - të kërkojë informacion si dhe të dijë çfarë duhet bërë;
- Të dijë të përdorë fjalë dhe shprehje urimi me rastin e festave/rasteve të veçanta.
- Të përdorë “**Going To dhe will**” në të gjitha trajtat;
- Të bëjë dallimin ndërmjet këtyre dy formave për të biseduar për të ardhmen;
- Të bëjë përshkrimin/parashikimin e motit në stinë dhe situata të ndryshme;
- Të dallojë/identifikojë fjalët që janë emra/mbiemra nga mbarezat që marrin ata dhe t’i përdorë pa gabime.

Lesson 21: Thinking About and Predicting the Future

Lesson 22: Getting Information

- Të ndërtojë fjalë nga mbiemrat në ndajfolje – pra identifikimi i pjesës së ligjëratës;
- Të dijë të gjendet në vende të ndryshme, në aeroport, dyqan, spital etj;

- Të realizojë komunikim të mirëfilltë me rastin e marrjes apo dhënies së informatave e që lidhen me **WH-questions**.

Lesson 23: Written Communication

- Të dijë t'i drejtohet personave me shkrim (me letër, e-mail), duke pas kujdes raportin që ka me këta persona, si dhe shprehjet që duhet të përdorë, por pa lënë anash as komunikimin e drejtpërdrejtë dhe përdorimin e shprehjeve dhe intonacionin;
- Të përdorë drejt shprehje të caktuara për situata të caktuara, bazuar në sqarimet gramatikore dhe ushtrimet në pjesën gramatikore.

Lesson 24: Experience

- Të dijë të përdorë **Present Perfect-in** pasi i është kushtuar kujdes në këtë njësi, si formës dhe përdorimit të kësaj kohe;
- Të mund të flasë për përvoja dhe përjetime të ndryshme;
- Të mund të përshkruajë vende duke përdor **Past Simple** kur përmenden datat.

Check Module III- Quiz

Këtu është listuar pjesa gramatikore që është mësuar në Modulin III dhe llojin e ushtrimit që është përdorë për të vlerësuar një njësi gramatikore të caktuar. Edhe shkrimi i drejtë është përfshirë. Prandaj, nxënësi në këtë pjesë mund të bëjë një përsëritje të asaj që është punuar dhe njëkohësisht të vlerësojë njohuritë e arritura.

- **Relative Pronouns** – ushtrim që klikohet në përgjigje të saktë;
- **Possessive Pronouns** - ushtrim që klikohet në përgjigje të saktë;
- **Present Continuous** – radhitja e fjalëve për të formuar fjali dhe ushtrim, duke shkruar formën e drejtë të foljes;

- **“To be” in Simple Present and Simple Past Tense** – Formimi i trajtës pyetëse dhe klikim me shpalosje;
- **Shapes and Colors** – Tërheqje e ngjyrave me mi (mouse) dhe vendosja në vendin e duhur, shkrimi i formave;
- **Future with ‘going to’ and ‘will’**- Plotësimi i formave që mungojnë në tabelë dhe formimi i fjalive me fjalë të dhëna;
- **Personal Pronouns** - Plotësimi i tabelës me këta përemra;
- **Question Words** – Klikim në fjalëzën e drejtë pas shpalosjes;
- **Object Pronouns** – Zgjedhje e përgjigjes së saktë pas klikimit;
- **Adjectives or Adverbs** – Formimi dhe plotësimi i tabelës me ndajfolje nga mbiemrat e dhënë;
- **Possessive Adjectives** - Plotësim i hapësirave pas shpalosjes;
- **English Contractions** – Shkrim i formave të gjata nga ato të shkurtra;
- **Present Perfect** - Plotësim i hapësirave duke shkruar formën e duhur, zgjedhja e formës së saktë pas klikimit.

3.2. Përputhjet e materialit didaktik elektronik “English for Beginners” me planet dhe programet e lëndës së Gjuhës angleze në shkollat profesionale

Te pika 2.1 (Kapitulli II - Objekti i studimit) kemi cekur se objektivat e studimit “Zbatimi i përmbajtjeve didaktike ‘English for Beginners’, në lëndën e Gjuhës angleze, në shkollat profesionale në Kosovë” i referohen aktiviteteve specifike dhe rezultateve të projektit, gjegjësisht studimit dhe analizës së dokumentacionit /literaturës përkatëse, burimeve relevante dhe dokumentimit të të dhënave që kanë të bëjnë me qëllimin e studimit.

Sa i përket studimit të planeve dhe programeve mësimore të lëndës së Gjuhës angleze dhe materialit didaktik elektronik “English for Beginners”, në funksion të nxjerrjes së rezultateve të studimit, janë realizuar aktivitete përkatëse studimore dhe është identifikuar shkalla e

përputhjes së strukturës dhe përmbajtjeve të materialit didaktik elektronik “*English for Beginners*” me planet dhe programet mësimore të lëndës së Gjuhës angleze (klasat 10, 11 dhe 12), gjegjësisht ndikimet e kësaj përputhje në arritjen e rezultateve të caktuara mësimore, specifikuar në modul (Unit) dhe klasë të caktuar.

3.2.1. *Moduli I (Unit I)*

Studimi krahasues i njësive mësimore të Modulit I (Unit I) të materialit didaktik elektronik “*English for beginners*” me planet dhe programet zyrtare të lëndës së Gjuhës angleze në klasat 10, 11 dhe 12 të arsimit profesional në Kosovë, nxori disa rezultate kryesore, të cilat të përgjithësuara po i paraqesim në vijim, ndërsa pasqyrimi i detajuar, specifikuar në njësi mësimore (lesson) dhe klasë, është bashkëngjitur në formë të materialit shtesë në fund të raportit⁶⁰.

- *Njësiti mësimore /lessons të Modulit I*, si njësia/lesson 1 dhe 3, nuk përputhen me planet dhe programet e klasave 10, 11 dhe 12 dhe rrjedhimisht mund të përdoren në klasën e 10-të vetëm në rastet kur nxënësit kanë fare pak informacione për çështjet programore që ofrojnë këto mësimore, sepse këto më shumë janë të përshtatshme për klasat tetë dhe nëntë të shkollës së mesme të ulët;
- *Njësiti mësimore /lessons të Modulit I*, si njësia/lesson 2, 4, 5, 6, 7 dhe 8, nuk përputhen në esencë me planin dhe programin e klasës së 10-të, por mund të praktikohen në këtë klasë dhe përmes tyre mund të ndihmohen nxënësit në arritjen e disa rezultateve mësimore:
 - Të kenë shkathtësi të komunikimit në situata të përditshme;
 - Të përdorin drejt të gjitha trajtat e foljes “**To be**”;
 - Të përdorin ndajfoljet e shpeshhtësisë si pjesë thelbësore të kohës së tashme;
 - Të flasin për preferencat vetjake;

⁶⁰ Shtojca 4 –Pasqyra e plotë e rezultateve të studimit për Modulin I (Unit I)

- Të komunikojnë me shprehje të caktuara në raport me kolegët dhe punën;
 - Të caktojnë takime dhe gjëra që duhet të merren parasysh (orën, ndarjen e detyrave etj);
 - Të bëjnë përshkrimin e ambientit ku ndodhen, e sidomos atë të punës;
 - Të tregojnë për pozitën e gjërave që i rrethojnë;
 - Të dinë të përdorin me korrektësi fjalët “**some/any**” dhe disa kombinime me po këto fjalë.
- *Njësitë mësimore /lessons të Modullit I*, si njësia/lesson 5 dhe 8, edhe pse nuk përpunohen me planin dhe programin mësimor të shkollave profesionale – klasa e 11-të, mund të praktikohet në klasën e 11-të dhe përmes tyre mund të ndihmohen nxënësit e kësaj klase në arritjen e disa rezultateve mësimore sipas planit dhe programit mësimor të kësaj klase:
 - Të dinë të emërtojnë disa nga profesionet dhe detyrat e tyre (përshkrimi i tyre);
 - Të përdorin si duhet parafjalët e vendit, lëvizjes/shkuarjes;
 - Të jenë të suksesshëm në intervista për të treguar profesionin dhe për të kërkuar punë.
 - *Moduli kontrollues 1 – Kuizi* është një përmbledhje e gramatikës së mësimave dhe ushtrimeve të këtij moduli. Është një pjesë e dobishme për nxënësit për çështje të ushtrimeve dhe më shumë mund të përdoret në fund të klasës së 10-të. Mund të shfrytëzohet edhe në fillim të klasës së 11-të për të diagnostikuar nivelin e arritjeve të nxënësve në fillim të klasës.

3.2.2. Moduli II (Unit II)

Studimi krahasues i njërive mësimore të Modullit II (Unit II), të materialit didaktik elektronik “*English for beginners*” me planet dhe programet zyrtare të lëndës së Gjuhës angleze në klasat 10, 11 dhe 12 të

arsimit profesional në Kosovë, nxori disa rezultate kryesore, të cilat të përgjithësuara po i paraqesim në vijim, ndërsa pasqyrimi i detajuar, specifikuar në njësi mësimore (lesson) dhe klasë është bashkëngjitur në formë të materialit shtesë në fund të raportit⁶¹.

- *Njësitë mësimore /lessons të Modullit II*, si njësia/lesson 10, 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16, nuk përputhen me planet dhe programet e shkollave profesionale, por mund të praktikohen në klasën e 10-të dhe përmes tyre mund të ndihmohen nxënësit e kësaj klase në arritjen e disa rezultateve mësimore:
 - Të përdorin drejt foljen **“Can”** për të shprehur mundësi apo për të kërkuar leje në të gjitha trajtat;
 - Të përdorin drejt parafjalët për vendndodhjen/raportin e vendeve-objekteve-gjësendeve me bashkëbiseduesin;
 - Të tregojnë dhe përshkruajnë një ngjarje që ka ndodhur në të kaluarën me përdorimin e Toljes ndihmese be në të gjitha trajtat;
 - Të kërkojnë ndihmë në situata të ndryshme të jetës së përditshme;
 - Të përdorin drejt foljet e rregullta në **“Past Tense”**, e gjithësi të dallojnë ndryshimet që mund të pësojë folja pas mbaresës që merr në **“Past Tense”**.
 - Të pasurojnë fjalorin sa u përket përshkrimit të festave dhe ngjarjeve për to;
 - Të përdorin në mënyrë të drejtë numrat rendorë;
 - Të kuptojnë tekste dhe të jenë në gjendje të japin informacione për atë se çfarë kanë dëgjuar dhe lexuar;
 - Të bëjnë identifikimin e llojeve të fjalive (pohore, pyetëse, mohore) dhe të përdorin drejt fjalët dhe kombinimet që kanë të bëjnë me **“Some/Any”**;

⁶¹ Shtojca 5 –Pasqyra e plotë e rezultateve të studimit për Modulin II (UnitII)

- Të përdorin në mënyrë të drejtë shprehjen “Would Like” në të gjitha format;
 - Të flasin për të dhëna personale si dhe për preferencat që kanë;
 - Të përshkruajnë ambientin me të gjitha gjërat që e rrethojnë;
 - Të përdorin krahasimin e mbiemrave njërrrokësh dhe dy e me shumë rrokje.
- *Njësitë mësimore /lessons të Modullit II, si njësia/lesson 10, 12, 13, edhe pse janë më të përshtatshme me programin e klasës së 10-të, mund të praktikohen edhe në klasën e 11-të. Kurse mësimi 17 mund të praktikohet në klasën e 11-të dhe përmes tij mund të ndihmohen nxënësit e kësaj klase në arritjen e disa rezultateve mësimore:*
 - Të dinë të përdorin foljet modale në mënyrë të drejtë;
 - Të jenë në gjendje të tregojnë për obligimet personale në kohë të ndryshme dhe të japin ndonjë këshillë për të tjerët në përmbushjen e obligimeve të përafërta;
 - Të kërkojnë leje për të bërë ndonjë detyrë, aktivitet ose të shtrojnë kërkesa për të tjerët.
 - *Njësitë mësimore /lessons të Modullit II, si njësia/lesson 17, mund të praktikohet edhe në klasën e 12-të dhe përmes tij mund të ndihmohen nxënësit e kësaj klase në arritjen e disa rezultateve mësimore që lidhen me foljet gjysmëndihmëse.*
 - *Moduli kontrollues 2 – Kuizi, është një përmbledhje e gramatikës së të gjitha mësimëve dhe disa ushtrime. Është pjesë e dobishme për nxënësit për çështje të ushtrimeve dhe më shumë mund të përdoret në fund të klasës së 10-të ose në pjesën e parë të gjysëmvetorit të parë të klasës së 11-të.*

3.2.3. Moduli III (Unit III)

Studimi krahasues i njësive mësimore të Modullit III (Unit III) të materialit didaktik elektronik “English for beginners” me planet dhe

programet zyrtare të lëndës së Gjuhës angleze në klasat 10, 11 dhe 12 të arsimit profesional në Kosovë, nxori disa rezultate kryesore, të cilat të përgjithësuara po i paraqesim në vijim, ndërsa pasqyrimi i detajuar, specifikuar në njësi mësimore (lessons) dhe klasë, është bashkëngjitur në formë të materialit shtesë në fund të raportit⁶².

- *Njësitë mësimore/lessons të Modullit III* nuk përputhen me planet dhe programet e lëndës së Gjuhës angleze në klasat 10, 11 dhe 12 të arsimit profesional në Kosovë, mirëpo ato ndihmojnë në arritjen e disa rezultateve të pritura në plane dhe programe të gjuhës angleze, sidomos të atyre të klasës së 10-të;
- *Njësitë mësimore /lessons të Modullit III*, si njësi/lesson 19, 20,21,22 dhe 24, mund të praktikohen në klasën e 10-të;
- *Njësitë mësimore /lessons të Modullit III*, si njësi/lesson 23 dhe 25, mund të praktikohen në klasën e 10-të vetëm për nevoja të përsëritjes me nxënës që janë në nivel më të ulët të zotërimit të gjuhës angleze në këtë klasë;
- *Njësitë mësimore/lessons të Modullit III*, si njësi/lesson 19, 20 dhe 22, mund të praktikohen edhe në klasën e 11-të;
- *Njësi mësimore /lessons 22 e Modullit III* mund të praktikohen edhe në klasën e 12-të për nevoja të përsëritjeve të aspekteve që lidhën me fjalëformimin;
- Praktikimi i njësive *mësimore /lessons të Modullit III* mund të ndihmojë nxënësit në arritjen e disa rezultateve mësimore:
 - Të bëjnë dallimin dhe të dinë të përdorin drejt foljet “**Present Simple**” dhe “**Present Cont**”;
 - Të përshkruajnë njerëzit, tiparet, karakteret e tyre dhe njëkohësit të mund të dallojë ngjyrat, format dhe stilet;
 - Të përdorin përemrat lidhorë;

⁶² Shtojca 6 –Pasqyra e plotë e rezultateve të studimit për Modulin III (Unit III)

- Të pasurojnë fjalorin dhe të plotësojnë fondin e fjalëve që kanë të bëjnë me punën dhe përgjegjësitë;
- Të bëjnë pyetje dhe të kërkojnë informata nga të tjerët;
- Të përvetësojë foljen “**be**” në present simple edhe në past simple, sepse edhe një herë i kushtohet vëmendje shpjegimit dhe trajtave të saj;
- Të flasin dhe të tregojnë për planet dhe synimet e tyre për të ardhmen, duke përdorur shprehjen “**going to**”;
- Të dinë të kërkojnë informacion gjatë udhëtimeve;
- Të dijë të përdorin fjalë dhe shprehje urimi, falënderimi – në rastet e duhura;
- Të përdorin “**going to dhe will**” në gjatë bisedave me të tjerët për të ardhmen e tyre;
- Të përshkruajnë motin në stinë të ndryshme;
- Të kuptojnë, përdorin dhe shkruajnë fjalë dhe fjali për situata dhe vende të ndryshme, si: gjatë qëndrimit dhe udhëtimit me aeroplan, në lokale ushqimore, në spital etj.;
- Të shkruajnë tregime të shkurtra në kohën e tashme;
- Të shkruajnë letra duke pasur kujdes raportin që ka me personat që u shkruan, p.sh. letra zyrtare;
- Të reflektojnë për mënyrat e komunikimit gjatë marrjes dhe dhënies së informative;
- Të përdorin drejt shprehje të caktuara për situata të caktuara dhe përshëndetje zyrtare dhe jozyrtare;
- Të përdorin format e shkurta në gjuhën e folur dhe të flasin për përvoja e përjetime të ndryshme.

3.2. Përputhjet e materialit didaktik elektronik “English for Beginners” me tekstet dhe materialet mësimore të lëndës së Gjuhës angleze në shkollat profesionale

Studimi, analiza dhe krahasimi i materialit didaktik elektronik “*English for Beginners*” me materialet mësimore në shfrytëzim në shkollat

profesionale në Kosovë (tekstet mësimore) sjellin informacione konkrete rreth përputhjeve të caktuara të të dyja përmbajtjeve.

Për realizimin e planeve dhe programeve mësimore në shkollat profesionale në Kosovë mësimdhënësit dhe nxënësit kanë në shfrytëzim tekste ‘New Headway’, të shtëpisë botuese ‘Oxford University Press’, tekste këto në shfrytëzim për klasat përkatëse edhe në gjimnaze.

Meqenëse në klasën e nëntë në arsimin e mesëm të ulët punohet me nivel/tekst të ‘New Headway ELEMENTYRY’, atëherë nivelet/tekstet e shfrytëzuara në klasat vijuese të arsimit të mesëm të lartë janë vazhdimësi e këtij niveli. Materiali mësimor përbëhet nga libri bazë - Libri i nxënësit (Student’s Book) dhe nga Libri i ushtrimeve (Workbook).Këtij materiali i bashkëngjitet edhe një material elektronik i përmbledhur në një CD, e cila përmban përmbajtje audio të njëjta me tekstet e shkruara në librin bazë, e cila jo shpeshherë vjen në pakon e librave përkatës dhe jo shpeshherë përdoret nga nxënësit apo mësimdhënësit në funksion të zhvillimit të përmbajtjeve mësimore. Tekstet e shfrytëzuara në shkollat profesionale, specifikuar në klasë dhe nivel përkatës:

- Klasa e 10-të: New Headway Pree-Intermediate;
- Klasa e 11-të: New Headway Intermediate;
- Klasa e 12-të: New Headway Uper –Intermediate;
- Klasa e 13-të: New Headway Advance.

Struktura përmbajtjesore e këtyre teksteve është pak a shumë e njëjtë me strukturën e materialit didaktik elektronik “*English for Beginners*”, përfshirë pjesën gramatikore (Grammar), fjalorin (Vocabulary), anglishten e përditshme (Everyday English), të lexuarit (Reading), të folurit (Speaking), të dëgjuarit (Listening) dhe të shkruarit (Writing). Libri bazë (Student’s Book) në strukturën e tij përmban edhe materialin shtesë të bashkëngjitur në fund të librit, si referencat gramatikore (Grammar Reference), tekste të shkruara të ngjashme me tekstet audio

në CD që u referohen ushtrimeve të caktuara në njësinë (Unit) përkatëse, listën e fjalëve (Word list), listën e foljeve të parregullta dhe modelet e foljeve (Irregular verbs and verb patterns) dhe simbolet fonetike (Phonetic symbols). Libri i ushtrimeve (Workbook) ofron material punues në formë të testeve vlerësuese për secilën njësi (Unit), të fokusuara më tepër në përmbajtjet gramatikore të trajtuara në njësinë (Unit) përkatës.

Meqenëse në fokus të studimit tonë janë vetëm tri nivelet e para të teksteve të ‘New Headway’, atëherë në vazhdim po japim informacion të përgjithshëm për strukturën dhe përmbajtjen e tyre.

3.2.3. *New Headway Pre-Intermediate*

Materiali mësimor i përfshirë në tekstin bazë të New Headway Intermediate është i përbërë nga 12 njësi mësimore (Units):

1. *Getting to know you*
2. *The way we live*
3. *What happend*
4. *The market place*
5. *What do you want to do*
6. *Places and things*
7. *Fame!*
8. *Do's and don'ts*
9. *Going places*
10. *Things that changet the world*
11. *What if....?*
12. *Trying your best.*

Përmbajtjet mësimore të këtyre njësive u dedikohen përfituesve që kanë njohuri të mira paraprake të gjuhës angleze. Kryesisht është e zbërthyer në fushat përmbajtjesore të gramatikës (Grammar), fjalori (Vocabulary), anglishtja e përditshme (Everyday English), të lexuarit

(Reading), të folurit (Speaking), të dëgjuarit (Listening) dhe të shkruarit (Writing). Një pasqyrë e plotë e përmbajtjeve mësimore mund të gjendet në tekstin përkatës të gjuhës angleze⁶³, ndërsa rezultatet e pritura të secilës njësi janë kontinuitet i njësisë/njësave paraprake dhe janë në funksion të përgatitjes së nxënësit në mënyrë që ai:

1. Getting to know you

- Të kuptojë dhe të përdorë kohët kryesore – **Past** , **Present** dhe format e **Future**, të shprehura me këto kohë gramatikore: **Past Simple**, **Present Continue**, **Present Simple** dhe **Going to** në të gjitha format;
- Të kuptojë dhe të përdorë pyetjet dhe përgjigjet me **WH-** question dhe me **YES/NO** question, në të cilat përdoren edhe foljet ndihmese (**Be, Do, Have**);
- Të dallojë pjesët e ligjëratës, si dhe fjalët më me shumë se një kuptim dhe po ashtu fjalë për situata të përshkrimit të shokëve;
- Të aftësohet për të kuptuar një tekst me informata dhe preferenca personale.

2. The way we live

- Të bëjë dallimin mes kohës së tashme **Present Simple** dhe **Present Cont**, si dhe formës **Have got**;
- Të ushtrojë fjalët që shkojnë së bashku (Collocations);
- Të kuptojë dhe të përdorë pyetje dhe përgjigje rreth informatave personale;
- Të kuptojë tekstin për mënyra (stile) të ndryshme të jetës, punës që bëjnë dhe obligimet që kanë;
- Të aftësohet për komunikim përmes e-mail-it;
- Të përdorë drejt fjalëzat lidhëse (**but, although, so...**).

⁶³ New Headway Pree-Intermediate, Liz and Johns Soars, OXFORD University Press, faqe ,3,4,5 dhe 6

3. What happend

- Të bëjë dallimin dhe përdorimin e drejtë të dy kohëve të kaluara – **Past Simple** dhe **Past Continuous** dhe shprehjeve kohore që janë pjesë e këtyre dy kohëve;
- Të formojë pyetje dhe përgjigje me kohët paraprake;
- Të përdorë drejtë foljet e rregullta dhe t'i kushtojë kujdes shqiptimit të drejtë të mbaresës **ed**;
- Të përdorë dhe të shqiptojë drejt foljet e parregullta;
- Të përdorë ndajfolje të mundësisë, mënyrës dhe kohës dhe të përcaktojë drejt pozitën e tyre në fjali.

4. The market place

- Të identifikojë emrat e numërueshëm dhe të panumërueshëm;
- Të përdorë drejt fjalët që tregojnë sasi: **much, many, some, ny, a few, a little**;
- Të kombinojë fjalët me **Some, Any, Every, No**;
- Të përdorë drejt nyjat /Articles-**a/an, the,zero**);
- Të lexojë dhe të kuptojë tekste, në të cilat përshkruhen vende interesante;
- Të jetë në gjendje të bëjë një bisedë me rastin e blerjes dhe pagesës së artikujve të ndryshëm;
- Të dijë të shkruajë një kartolinë duke përdorur mbiemra.

5. What do you want to do

- Të përdorë drejt modelet e foljeve (**Verb Patterns**) që kanë të bëjnë me **Gerund-in, Infinitiv-in** dhe trajtën bazë të foljeve;
- Të përdorë drejt kohën e ardhme (**Future**), që në gjuhën angleze shprehet me forma të ndryshme – **Present Cont, Going to dhe Will**;
- Të përdorë drejt mbiemrat që mbarojnë me **-ed/ing**, që mundësojnë shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve tona;
- Të jetë i aftë të plotësojë formularë me të dhëna personale.

6. Places and things

- Të përdorë format krahasore dhe sipërore të mbiemrave në funksion të përshkrimit të gjërave që i pëlqejnë;
- Të pasurojë fjalorin me sinonime dhe antonime dhe përdorimin e tyre në të folur;
- Të jetë në gjendje të bëjë rezervimin e pushimeve përmes internetit;
- Të përshkruajë vendlindjen me përdorimin e përemrave lidhorë: **That, Which, Who, Where**.

7. Fame!

- Të dallojë **Past Simple** dhe **Present Perfect**, veçanërisht shprehjet që përdoren në këto dy kohë;
- Përdorimin e mbiemrave për përshkrimin fitik të personit, si dhe karakterin e tij;
- Të identifikojë pjesët e ligjëratës në bazë të mbaresës që merr fjala;
- Të ndërtojë forma të reja të fjalëve, fjalë nga emri në mbiemër dhe nga ndajfolja në folje;
- Të shqiptojë drejt theksimin e rrokjeve të caktuara (**Word Stress**).

8. Do's and don'ts

- Të përdorë foljet modale në funksion të shprehjes së një këshille apo obligimi (**modal verbs**), **Have To, Must, Should**, në **Present** dhe **Past** në të gjitha trajtat;
- Të përdorë fjalët që shkojnë bashkë (Collocations) me rastin e aplikimit për punë dhe probleme shëndetësore;
- Të përdorë fjalë dhe shprehje zyrtare dhe jozyrtare me rastin e shkrimit të ndonjë letre ose e-maili.

9. Going places

- Të përdorë fjalitë kushtore **Type 1 (If Clauses)**;
- Të përdorë drejt **Present Simple** pas lidhezave kohore;
- Të dallojë kuptimin e foljeve **Make/Do/Take/Get**;
- Të japë udhëzime orientuese për një vend të caktuar, duke përdorur parafjalët **Behind, opposite, in front of, on the corner, along, across, through...**

10. Things that changet the world

- Të përdorë drejt Passiv në **Present Simple, Past Simple, Present Perfect dhe Will**;
- Të ketë aftësi për të dalluar veprimin në diatezën veprorë (**Active**);
- Të përdorë drejt emrat dhe foljet që shkojnë bashkë (**Collocations**);
- Të dijë të flasë për gjërat që e bezdisin;
- Të dijë të zhvillojë bisedë telefonike.

11. What if....?

- Të përdorë fjalitë kushtore **Type 2 (If Clauses)**, që formohen me **Past Simple**, për të shprehur një situatë joreale në të tashmen;
- Të dijë të shprehet për gjërat që mund të ndodhin në të ardhmen (nuk jemi të sigurt), për të cilat përdoret shprehja **Might**;
- Të pasurojë fjalorin me shprehje dhe idioma frazeologjike;
- Të shprehë ndjenjat e befasisë me **So/Such**.

12. Trying your best

- Të përdorë dhe të dallojë **Present Perfect Continuous** në raport me Present Perfect;
- Të dallojë kuptimin e foljeve **Bring, Take, Come dhe Go**;

- Të zgjerojë fondin e shprehjeve komunikatave me njerëz;
- Të përdorë fjalë në funksion të lidhjes së ideve (**Transition Expressions**).

Rezultatet e studimit kanë treguar se përmbajtja e materialit didaktik elektronik “*English for Beginners*” ka përputhje konkrete me tekstet e nivelit Pree-Intermediate, ndërsa në mënyrë tërthore përdorimi paralel i materialit mund të ndihmojë në arritjen e rezultateve mësimore të kërkuara në planet dhe programet zyrtare përkatëse të lëndës.

English for Begginers Moduli I	Pree Intermediate	Përputhjet
Lesson 1 Greetings and introduction	Unit I	-Folja To Be , -Formimi i WH questions
Lesson 2 The World around Me	Unit 4	-Articles
Lesson 7 The ideal Office	Unit 4	- Some / Any -po edhe forma të tjera
Lesson 8 The interview	Unit 2	- Have/ Have got

Tab 1. Përputhjet e përmbajtjeve të “English for Beginners” me New Headway Pree - Intermediate

3.2.4. *New Headway Intermediate*

Materiali mësimor i përfshirë në tekstin bazë të New Headway Intermediate është i përbërë nga 12 njësi mësimore (Units):

1. *It's a wonderful World!*
2. *Get happy!*
3. *Telling tales*
4. *Doing the right thing*
5. *One the move*
6. *I just love it!*

7. *The world of work*
8. *Just imagine!*
9. *Relationship*
10. *Obsessions*
11. *Tell me about it!*
12. *Life's great event's!*

Përmbajtjet mësimore të këtyre njësive u dedikohen përfituesve që kanë njohuri të kënaqshme paraprake të gjuhës angleze. Kryesisht është e zbërthyer në fushat përmbajtjesore të gramatikës (Grammar), fjalori (Vocabulary), anglishtja e përditshme (Everyday English), të lexuarit (Reading), të folurit (Speaking), të dëgjuarit (Listening) dhe të shkruarit (Writing). Një pasqyrë e plotë e përmbajtjeve mësimore mund të gjendet në tekstin përkatës të gjuhës angleze⁶⁴, ndërsa rezultatet e pritura të secilës njësi janë kontinuitet i njësisë/njësive paraprake dhe janë në funksion të përgatitjes së nxënësit në mënyrë që ai:

1. It's a wonderful World!

- Të jetë në gjendje të japë informacione për kohët e foljeve dhe foljet ndihmëse të mësuara, Pree-Intermediate;
- Të shprehet lirshëm duke përdorë informacionin e mësuar paraprakisht;
- Të identifikojë pjesët e ligjëratës dhe kuptimin e tyre;
- Të formojë fjalë me anë të mbaresave;
- Të përdorë fjalë dhe shprehje ideomatike.

2. Get happy!

- Të zgjerojë njohuritë për **Present Simple dhe Present Cont;**
- Të dallojë veçoritë dhe foljet e gjendjes (**State Verbs**);

⁶⁴ New Headway Intermediate, Liz and Johns Soars, OXFORD University Press, faqe 2,3,4,dhe 5

- Të pasurojë fjalorin me fjalë që kanë të bëjnë me sportin, aktivitetet dhe pajisjet e ndryshme të nevojshme për kohën e lirë;
- Të përdorë drejt numrat dhe datat.

3. Telling tales

- Të përdorë kohën **Past Perfect**, përveç **Past Simple** dhe **Past Continue**, të mësuara në nivelin paraprak;
- Të përdorë këto kohë në pasive;
- Të dijë të përdorë fjalë dhe shprehje për artin, letërsinë dhe llojet e ndryshme të librave/ filmave;
- Të jetë në gjendje të përdorë shprehje dhe mënyra për të dhënë mendim/vlerësim.

4. Doing the right thing

- Zë zhvillojë njohuri të mëtutjeshme për foljet modale në funksion të shprehjes së aftësive, sugjerimeve, kërkesave, lutjeve, lejeve, këshillave, obligimeve, etj.
- Të zhvillojë fjalë dhe shprehje për nacionalitetet/shtetet dhe traditat e tyre.

5. One the move

- Të përdorë format e ndryshme gramatikore për të shprehur të ardhmen në gjuhën angleze;
- Të përdorë fjalë dhe shprehje të ndryshme për parashikimin e motit dhe për udhëtime/forma të transportit.

6. I just love it!

- Të përdorë **Like** si folje dhe si parafjalë;
- Të përdorë modele foljesh (**Verb Patterns**) sidomos në trajtën pyetëse;

- Të përdorë modele foljesh me **-ing/-to**;
- Të pasurojë fjalorin me fjalë /mbiemra rreth ushqimit, qytetit dhe njerëzve;
- Të kuptojë shenjat dhe vërejtjet;
- Të dijë të shkruajë një letër falënderuese.

7. The world of work

- Të zhvillojë njohuri të mëtejme për **Present Perfect** në diatezën vepore dhe pësore (**Active/Passive**);
- Të zgjerojë fondin e fjalëve me folje dhe shprehje frazeologjike (**Phrasal Verbs/Idiomatic expressions**);
- Të zhvillojë aftësi për të realizuar biseda telefonike;
- Të zhvillojë biseda rreth punës/vendit të punës dhe mundësisë për të aplikuar.

8. Just imagine!

- Të krijojë situata të ndryshme me përdorimin e fjalive kushtore tipi 1 (**If Clauses**) dhe tipi 2 (**Second Conditional**), si dhe të bëjë dallimin mes tyre;
- Të përdorë drejt mbiemrat bazë dhe të fortë (**Gradable/Ungradable**);
- Të përdorë fjalë dhe shprehje për të bërë sugjerime.

9. Relationship

- Të thellojë përdorimin e foljeve modale, si **Deduction, në Present dhe Past**, për të treguar se sa jemi të sigurt për të sqaruar një situatë;
- Të përdorë mbiemra që përshkruajnë karakterin e një personi;
- Të përdorë shprehje të caktuara për t'u pajtuar/mospajtuar (**Agree/Disagree**).

10. Obsessions

- Të zgjerojë përdorimin e **Present Perfect Continuous** dhe shprehjeve që karakterizojnë këtë kohë;
- Të dijë të përdorë emrat e përbërë (Compound Nouns) dhe fjalë që shprehin sasinë.

11. Tell me about it!

- Të përdorë pyetje indirekte (**Indirect Questions**) duke pasur kujdes në renditjen e fjalëve;
- Të përdorë drejt Question Tag , për të vërtetuar informatën apo për të filluar një bisedë;
- Të përshkruajë pjesët e trupit dhe foljet që mund të përdoren;
- Të përdorë shprehje dhe fjalë në situata joformale.

12. Life's great event's!

- Të përdorë drejt ligjëratën e zhdrejtë (**Reported Speech**) kur kemi të bëjmë me kumtimin e fjalive, pyetjeve, urdhrave, kërkesave dhe kujdesin që duhet të kemi me formën që pëson folja;
- Të përdorë drejt fjali dhe shprehje rreth lindjes/ martesës dhe vdekjes;
- Të përdorë drejt fjalë dhe shprehje për të kërkuar falje.

Rezultatet e studimit kanë treguar se përmbajtja e materialit didaktik elektronik “*English for Beginners*” nuk ka përputhje konkrete me tekstet e nivelit Intermediate, ndërsa në mënyrë tërthore përdorimi paralel i materialit me tekstet mund të ndihmojë në arritjen e rezultateve mësimore të kërkuara në Planet dhe Programet zyrtare përkatëse të lëndës.

3.2.5. *New Headway Upper – Intermediate*

Materiali mësimor i përfshirë në tekstin bazë të New Headway Uper - Mediate është i përbërë nga 12 njësi mësimore (Units):

1. *No place like home*
2. *Been there, done that!*
3. *What a story!*
4. *Nothing but the truth*
5. *An eye to the future*
6. *Make it big*
7. *Getting on together*
8. *Going to extremes*
9. *Forever friends*
10. *Risking life and limb*
11. *In your dreams*
12. *It's never too late.*

Përmbajtjet mësimore të këtyre njësive u dedikohen përfituesve që kanë njohuri të avancuara paraprake të gjuhës angleze. Kryesisht është e zbërthyer në fushat përmbajtjesore të gramatikës (Grammar), fjalori (Vocabulary), anglishtja e përditshme (Everyday English), të lexuarit (Reading), të folurit (Speaking), të dëgjuarit (Listening) dhe të shkruarit (Writing). Një pasqyrë e plotë e përmbajtjeve mësimore mund të gjendet në tekstin përkatës të gjuhës angleze⁶⁵, ndërsa rezultatet e pritura të secilës njësi janë kontinuitet i njësisë/njësive paraprake dhe janë në funksion të përgatitjes së nxënësit në mënyrë që ai:

1. No place like home

- Të përdorë sistemin e foljeve Simple, Continuous dhe Perfect në diatezën veprorë/pësorë (**Active/Passive**);
- Të përdorë fjalë të përbëra në të folurit joformal;
- Të aftësohet për të shkruar një CV dhe Cover Letter me rastin e aplikimit për punësim;
- Të veçojë përparësitë dhe mangësitë e të jetuarit jashtë shtetit (mënyra e të jetuarit).

⁶⁵ New Headway Intermediate, Liz and Johns Soars, OXFORD University Press, faqe 2,3,4,dhe 5

2. Been there, done that!

- Të bëjë përdorimin dhe dallimin e **Present Tenses (Present Simple/Present Cont)** dhe **Perfect tenses (Present Perfect Simple dhe Cont)**;
- Të përdorë drejt dhe të dallojë modelet e foljes **Do/Make**;
- Të shprehë mendime me anë të shprehjeve të caktuara;
- Të dijë të shkruajë letër joformale;
- Të përdorë shprehje dhe fjalë për të shprehur befasi/çudi.

3. What a story!

- Të përdorë drejt kohët narrative (**Narrative Tenses**) kur dëshiron të tregojë ngjarje në të kaluarën, duke përdorur ndajfolje narrative;
- Të dijë të përdorë fjalën Like në pjesë të ndryshme të ligjëratës;
- Të dijë të përdorë fjalë dhe shprehje për të shfaqur interesim /befasi për bisedën që zhvillohet.

4. Nothing but the truth

- Të aftësohet për të bërë pyetje në të gjitha kohët e mësuara;
- Të përdorë drejt trajtën mohore dhe interrogative;
- Të zhvillojë mundësi të përdorimit të parafjalëve për formimin e fjalëve të reja;
- Të zgjerojë fjalorin me antonime;
- Të krijojë mundësi të shkëmbimit të informatave, duke përdorur fjalë dhe lidhëza përkatëse.

5. An eye to the future

- Të zhvillojë njohuri për format e së ardhmes, duke përfshirë edhe dy kohët e tjera: **Future Perfect dhe Future Cont**;
- Të bëjë dallimin në përdorimin e foljeve **Take/Put**;
- Të dijë të zhvillojë biseda të ndryshme telefonike, si të fillojmë dhe përfundojmë këto biseda;

- Të aftësohet për të bërë aranzhime të takimeve, duke pas për bazë kujdesin për vendin dhe kohën e mbajtjes së tyre;
- Të zhvillohen njohuritë dhe aftësitë e shkrimit të një e-maili.

6. Make it big

- Të zgjerohet përdorimin e shprehjeve të sasisë dhe përsëritjes së disa shprehjeve nga njësitë paraprake;
- Të zhvillojë aftësi për shkrimin e një reklame;
- Të identifikojë fjalë që kanë formë të njëjtë, e që përdoren edhe si folje, edhe si emra;
- Të zgjerohet fondin e fjalëve dhe shprehjeve biznesore;
- Të aftësohet për shkrimin e raporteve duke përdorur numra she shifra.

7. Getting on together

- Të përdorë drejt foljet modale dhe gjysmë modale (**Modals dhe Semi Modals**) në **Present**;
- Të dijë të shtrojë pyetje që shprehin befasi;
- Të dijë të zhvillojë debat/shprehje mendimesh personale rreth çështjeve të caktuara;
- Të dijë të dallojë përdorimin dhe kuptimin që mund ta ketë folja **Get**.

8. Going to extremes

- Të përdorë drejt pjesorët **Present/Past Participle** dhe fjalitë lidhore;
- Të përdorë drejt mbiemrat dhe ndajfoljet;
- Të zhvillojë aftësi për të bërë përshkrime të gjata.

9. Forever friends

- Të zhvillojë aftësi për të shprehur shprehitë (Habits) në **Present** dhe **Past**;

- Të identifikojë dhe të përdorë drejt **Homophones/Homononyms** dhe fjalët të plotësojnë kuptimin e tjetrës (**Intensifying compounds**).

10. Risking life and limb

- Të përdorë drejt foljet modale në **Past** dhe shprehjet që shkojnë me këto folje;
- Të zgjerojë fondin e fjalëve dhe shprehjeve sinonime, metafora dhe shprehje (idioma) frazeologjike;
- Të aftësohet për të shkruar letra/e-maile zyrtare dhe jozyrtare.

11. In your dreams

- Të shprehë situata joreale në Present (**Hypothesizing**);
- Të përdorë fjalë çift (**Ups/Downs,Pros/Cons**);
- Të përdorë shprehje dhe fjalë lidhëse;
- Të zhvillojë modele fjalish me If, kur flasim;
- Të zhvillojë fjalorë me fjalë ankuese dhe rënkuese.

12. It's never too late

- Të përdorë drejt nyjat dhe përcaktorët;
- Të zhvillojë njohuri për përdorimin e më tepër mundësive të fjalëve **Life/Time**;
- Të zhvillojë njohuri shprehëse me anë të foljeve ndihmëse dhe shprehjeve të reja.

Rezultatet e studimit kanë treguar se përmbajtja e materialit didaktik elektronik “*English for Beginners*” nuk ka përputhje konkrete me tekstet e nivelit Uper-Intermadiate, ndërsa në mënyrë tërthore përdorimi paralel i materialit me tekstet mund të ndihmojë në arritjen e rezultateve mësimore të kërkuara në Planet dhe Programet zyrtare përkatëse të lëndës.

IV. IDENTIFIKIMI I MUNDËSIVE PËR INTEGRIM TË PËRMBAJTJES „ENGLISH FOR BEGINNERS” NË PROGRAM/KAPITUJ/ NJËSI TË CAKTUARA NË KLASË PËRKATËSE

Përveç objektivave me karakter studimi, analize dhe krahasimi, të realizuara në kuadër të studimit dhe sigurisht mbi bazën e rezultateve të dalta përmes realizimit të këtyre objektivave, detyra parësore e studimit qëndron pikërisht në identifikimin e mundësive për integrim të përmbajtjeve të materialit didaktik elektronik “*English for Beginners*” në program/kapituj/njësi të caktuara të klasës përkatëse, në funksion të arritjes së rezultateve të dëshiruara mësimore.

Materiali didaktik elektronik “*English for Beginners*” është material mësimor i hartuar enkas për nivelin e mesëm të arsimit, prandaj edhe integrimi i përmbajtjeve të këtij materiali në këtë nivel dhe tip të shkollimit duhet të ketë për bazë disa aspekte kryesore.

Lënda mësimore e Gjuhës angleze, krahas lëndëve profesionale të përcaktuara nga tipi i shkollës, zë një vend mjaft të rëndësishëm në pajisjen e nxënësit me kompetenca për qasje në informacion profesional në gjuhën angleze dhe për përshtatje me tregun vendor dhe atë ndërkombëtar të punës.

Bazuar në qëllimin afatgjatë të Kurrikulës të gjuhës angleze në arsimin profesional, nxënësi në fund të shkollimit të mesëm të lartë duhet të arrijë rezultate të pasqyruara në Planet dhe Programet mësimore të gjuhës angleze, të cilat janë në përputhje me kërkesat e shoqërisë së sotme. Mirëpo, deri më tani, arritshmëria e nxënësve të shkollave profesionale në Kosovë në lëndën e Gjuhës angleze është më e ulët në krahasim me atë të gjimnazeve, meqenëse rezultatet mesatare të testit të maturës (bazuar në kriteret e testit të maturës) tregojnë se kompetencat e nxënësve në lëndën e Gjuhës angleze në shkollat profesionale në Kosovë janë nën minimumin e kalueshmërisë. Sipas të dhënave të

marra nga Zyra për standarde dhe vlerësim në MASHT, nga 20 pyetje sa aktualisht shtrohen në Testin e Maturës, nxënësit e shkollave profesionale mesatarisht arrijnë 8.89 pikë ose 44.45% (Provimi i maturës 2011), që nënkupton se me këtë përqindje nuk është arritur pragu minimal i kalueshmërisë sipas kriterëve të provimit të maturës. Këto rezultateve shpeshherë arsyetohen nga shkollat dhe mësimdhënësit me mungesë të teksteve shkollore dhe materialeve tjera didaktike që ndihmojnë nxënësit në arritjen e kompetencave kryesore të gjuhës angleze.

Gjithsesi, për të arritur rezultatet të pritura të planifikuara në planet dhe programet mësimore në fund të klasës dhe nivelit të caktuar mësimor në lëndën e gjuhës angleze, shkolla përveç se duhet të disponojë me kuadër të kualifikuar dhe të përgatitur mirë për lëndën, me infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e përmbajtjeve dhe aktiviteteve të planifikuara në plan, gjithsesi që duhet të ketë në shfrytëzim edhe materiale të përshtatshme didaktike, të cilat përshtaten me nevojat e nxënësve (nivelet e arritshmërisë), por që gjithashtu nxisin dhe mbështesin kreativitetin e mësimdhënies dhe nxënies në këtë lëndë. Rezultatet paraprake të studimit japin orientim se materiali didaktik elektronik “English for Beginners” nuk ka përputhshmëri të madhe me përmbajtjet e materialeve mësimore në shfrytëzim (teksteve), por që konsiston shpesh me rezultatet mësimore të synuara përmes tyre, i njëjti material didaktik ka një mbështetje relativisht të mirë me rezultatet mësimore të synuara në planet dhe programet mësimore të klasave të caktuara dhe mund të ndikojë në mënyrë të tërthortë në arritjen e këtyre rezultateve.

Prandaj, mund të themi se integrimi i përmbajtjeve të materialit didaktik elektronik në këtë tip dhe nivel të shkollimit mund ndihmojë në ngritjen e rezultateve mësimore dhe se, varësisht nga qëllimi i përdorimit të materialit, mund të përcaktohet edhe forma e realizimit të tij dhe mund të përdoret si:

1. Material bazë për përdorim nga nxënës të caktuar

Në këtë rast, për shkak të rezultateve të ulëta mësimore të një numri të nxënësve në lëndën e Gjuhës angleze, mësimdhënësit dhe nxënësit mund të shfrytëzojnë materialin didaktik “*English for Beginners*” si material bazë mësimor, në funksion të ngritjes së këtyre rezultateve. Struktura, përmbajtja dhe format e punës në materialin didaktik “*English for Beginners*” ofrojnë më tepër mundësi për punë të pavarur dhe kreative për këtë kategori të nxënësve, meqenëse ky material posedon informacione dhe instruksione të qarta në gjuhën shqipe si dhe mjete konkrete të punës që janë mjaft të favorshme për përvetësimin e rezultateve mësimore (shih pikën 3.1. të kapitulli III i raportit). Mirëpo, në asnjë rrethanë, përdorimi i këtij materiali didaktik elektronik si material bazë nuk e pengon edhe përdorimin e materialeve të tjera plotësuese që ndihmojnë në arritjen e rezultateve mësimore të përcaktuara në planet dhe programet mësimore të gjuhës angleze për shkollat profesionale.

2. Material shtesë krahas teksteve dhe materialeve mësimore në shfrytëzim

Në këtë rast, mësimdhënësi u ofron nxënësve përmbajtjet e identifikuar në materialin didaktik “*English for Beginners*”, të cilat tangojnë me rezultatin mësimor të kërkuar në planin dhe programin e klasës përkatëse (shih pikën 3.2. dhe 3.3 të kapitulli III i raportit) dhe që në kombinim me materialin mësimor në shfrytëzim i krijon nxënësit mundësi për zhvillim të mëtutjeshëm të kompetencave për gjuhën angleze.

3. Material për përdorim të pavarur nga nxënësit

Në këtë rast, varësisht nga interesimi i nxënësve për zgjerimin e njohurive për gjuhë angleze, u ofrohet atyre përmbajtja e materialit didaktik elektronik “*English for Beginners*” për shfrytëzim të pavarur në shkollë apo në shtëpi.

Varësisht nga qëllimet e integritit të përmbajtjeve të materialit didaktik elektronik “*English for Beginners*” në procesin mësimor, mund të përcaktohen edhe mundësitë e realizimit të këtij integrimi. Sigurisht që mundësitë konkrete të realizimit të përmbajtjes varen nga faktorë të shumtë brenda dhe jashtë shkollës, por në vazhdim po japim disa orientime bazë për realizim të përmbajtjeve:

a) *Shfrytëzimi i kabineteve të informatikës në kuadër të shkollës*

Materiali didaktik elektronik “*English for Beginners*” është material i përmbledhur në formë elektronike në një CD, e cila mund të instalohej në kompjuterë në kabinetin e informatikës në shkollën përkatëse. Në këtë rast, varësisht nga rezultatet paraprake në lëndën e Gjuhës angleze, mësimdhënësi do të klasifikonte nxënësit në grupe pune dhe do të jepte instruksione për punë me përmbajtjen përkatëse sipas modeleve 1, 2 apo 3 të identifikuar më lart.

b) *Shfrytëzimi i mjeteve audio-vizuele në klasa*

Në klasat ku realizohet procesi mësimor në lëndën e Gjuhës angleze mund të shfrytëzohen mjete audio-vizuele (kompjuterë, video-bim, flipqarta, etj.) për realizimin e përmbajtjeve të materialit didaktik elektronik “*English for Beginners*”. Zakonisht kjo formë e punës kërkon specifikim të grupeve punuese të nxënësve, si dhe koordinim të punës mes mësimdhënësve të lëndës së Gjuhës angleze të së njëjtës shkollë (aktiveve profesionale), ku mund të bëhej ndarja e nxënësve në klasa, varësisht nga niveli e arritshmërisë në lëndën e Gjuhës angleze, dhe të punohej me ta sipas modelit 1, 2 apo 3 të identifikuar më lart.

c) *Shfrytëzimi i kompjuterëve privatë /në shtëpi*

I njëjti material elektronik/CD mund të instalohej në kompjuterët privatë/në shtëpi, ku nxënësi mund të punojë në mënyrë të pavarur me përmbajtjet përkatëse të materialit didaktik, sipas modeleve 1, 2 apo 3 të identifikuar më lart.

d) Krijimi i një platforme elektronike

Shkollat profesionale në përgjithësi (apo shkolla në veçanti) do të mund të krijojnë një platformë elektronike, rrjetëzimi i së cilës do të mundësonte qasje të të gjithë nxënësve të shkollave profesionale (apo nxënësve të shkollës përkatëse). Në platformë, përveç përmbajtjeve dhe informacioneve të tjera lidhur me shkollat (shkollën), mund të lansohet edhe përmbajtja e materialit didaktik elektronik “English for Beginners”, prej nga mund të zgjidheshin përmbajtje të caktuara dhe mund të punohej në mënyrë të organizuar (në shkollë), apo në mënyrë të pavarur (në shtëpi), sipas modeleve 1, 2 apo 3 të identifikuar më lart.

e) Përcaktimi i lëndës së Gjuhës angleze si lëndë zgjedhore

Varësisht nga përcaktimi i nxënësve për lëndën e Gjuhës angleze si lëndë zgjedhore, mund të krijoheshin grupe pune, ku mund të shfrytëzoheshin kabinetet e informatikës, apo mjete audio-vizuele në klasa për punë me ta. Realizimi i përmbajtjeve të materialit didaktik elektronik “English for Beginners” dhe përcaktimi për format e punës do të varej nga struktura e nxënësve të përcaktuar për këtë lëndë dhe mund të punohej sipas modeleve 1, 2 dhe eventualisht 3 të identifikuar më lart.

Sigurisht se qëllime dhe forma më të nevojshme dhe më të përshtatshme për integrimin e materialit didaktik elektronik “English for Beginners” në funksion të arritjes së rezultateve të pritura të planifikuara në planet dhe programet mësimore në fund të klasës dhe nivelit të caktuar mësimor në lëndën e Gjuhës angleze mund të identifikohen dhe realizohen në bashkëpunim me nxënës dhe mësimdhënës gjatë fazës II të studimit - pilotimi i materialit didaktik elektronik në katër shkolla profesionale të Kosovës (shkollat e përcaktuara), të cilat pritet të përfshihen në studimin në periudhën maj-korrik 2012.

Në fund të kësaj faze do të dokumentohen rezultatet e studimit/pilotimit dhe do të prezantohen qëllime dhe forma konkrete për integrimin e

materialit didaktik elektronik “*English for Beginners*” në të gjitha shkollat profesionale në Kosovë, faza III e projektit.

V. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Realizimi i qëllimeve të Kurrikulës të gjuhës angleze në arsimin profesional në Kosovë, gjegjësisht arritja e rezultateve të pasqyruara në planet dhe programet mësimore të gjuhës angleze në këtë nivel dhe tip të shkollimit, në funksion të pajisjes së nxënësve me kompetenca për qasje në informacion profesional në gjuhën angleze dhe për përshtatje me tregun vendor dhe atë ndërkombëtar të punës, mbetet edhe më tutje sfidë dhe prioritet për realizim në të ardhmen.

Qëllimet e studimit ishin analiza dhe krahasimi i përmbajtjes së materialit didaktik elektronik “*English for Beginners*” me planet dhe programet e gjuhës angleze në arsimin e mesëm të lartë – shkolla profesionale, me tekstet dhe materialet didaktike në shfrytëzim, identifikimi i përputhjeve të përmbajtjeve dhe mundësive për integrim të përmbajtjes didaktike në program/kapituj për klasë të caktuara dhe ofrimi i alternativave të reja të shfrytëzimit të materialeve mësimore në funksion të arritjes së kompetencave.

Rezultatet e studimit japin orientime të qarta dhe të mjaftueshme sa u përket synimeve në qëllimet e studimit, të dhëna këto që mund t’u shërbejnë mësimdhënësve dhe nxënësve për përcaktim në raport me shfrytëzimin e materialeve mësimore në funksion të arritjes së rezultateve të caktuara mësimore dhe mund të klasifikohen specifikuar në fushat e studimit:

Materiali didaktik elektronik “English for Beginners” – struktura dhe përmbajtja

- ✓ Materiali didaktik elektronik ka përmbajtje të klasifikuar në tri module bazë (Unit-e), të cilat pastaj janë të shkoqitura në 24 leksione (njësi mësimore);
- ✓ Përmbajtja e njësive mësimore të materialit didaktik elektronik është e zërthyer në fushat kryesore përmbajtjesore të pjesës gramatikore, zhvillimit të folurit, të lexuarit, të dëgjuarit, të shkruarit, zhvillimit të anglishtes së përditshme, pasurimit të fondit të fjalëve, si dhe testimit dhe vlerësimit të njohurive për përmbajtjet e caktuara;
- ✓ Faqja punuese e materialit didaktik elektronik përbëhet nga disa instrumente të punës, shfrytëzimi me sukses i të cilave në shkallë të lartë lehtëson procesin e të mësuarit të përmbajtjeve mësimore, ofron kreativitet dhe rezultate pozitive të punës;
- ✓ Modulet/testet vlerësuese në përbërje/fund të secilës njësi të materialit didaktik elektronik janë mjaft të rëndësishme për diagnostikim, formim dhe vlerësim të njohurive të nxënësve në klasën përkatëse.

Përputhjet e materialit didaktik elektronik “English for Beginners” me planet dhe programet e lëndës së gjuhës angleze në shkollat profesionale.

- ✓ Njësi të caktuara mësimore (Lessons) të materialit didaktik kanë përputhshmëri tërthore me planet dhe programet mësimore zyrtare të gjuhës angleze të klasave të caktuara dhe praktikimi i tyre në këto klasa mund të ndihmojë nxënësit në arritjen e rezultateve mësimore;
- ✓ Njësi të caktuara mësimore (Lessons) të materialit didaktik kanë mundësi të praktikohen veçanërisht në klasën e 10-të. Praktikimi i tyre në strukturën e dhënë në këtë material didaktik ndihmojnë nxënësit në procesin e përvetësimit të kompetencave kryesore të mësimit të gjuhës angleze;
- ✓ Njësi të caktuara mësimore (Lessons) të materialit didaktik janë në funksion të qasjes së bazuar në kompetenca, ku nxënësit vihen në situata praktike të zotërimit të kompetencave të gjuhës angleze në

jetën e përditshme dhe mësimdhënësit mund të përzgjedhin përmbajtje të ndryshme në funksion të rezultateve mësimore të përcaktuara.

Përputhjet e materialit didaktik elektronik “English for Beginners” me materialet mësimore në shfrytëzim.

- ✓ Përmbajtjet mësimore të materialit didaktik elektronik “English for Beginners” nuk kanë përputhje të shumta konkrete me përmbajtjet e teksteve dhe materialeve mësimore në shfrytëzim të New Headway Pree-Intermediate (klasa e 10-të), Intermediate (klasa e 11-të) dhe Uper-Mediate (klasa e 12-të), por mund të ndihmojnë në realizimin e rezultateve të pritura mësimore të kërkuara në këto nivele;
- ✓ Përmbajtjet e materialit didaktik elektronik dhe rezultatet e pritura mësimore janë të krahasueshme me ato të New Headway Elementary dhe Pree-Intermediate, dhe përshtaten më shumë me nivelin e arritshmërisë të shumicës së nxënësve në shkollat profesionale në Kosovë;
- ✓ Struktura, përmbajtja dhe format e punës në materialin didaktik “English for Beginners” ofrojnë më tepër mundësi për punë të pavarur dhe kreative për këtë kategori të nxënësve, meqenëse ky material posedon informacione dhe instruksione të qarta në gjuhën shqipe, si dhe mjete konkrete të punës që janë mjaft të favorshme për përvetësimin e rezultateve mësimore.

Rezultatet e studimit tregojnë se materiali didaktik elektronik “English for Beginners” mund të përdoret si:

- ✓ Material bazë për përdorim për grupe të nxënësve dhe klasa të caktuara;
- ✓ Material shtesë krahas teksteve dhe materialeve mësimore në shfrytëzim;
- ✓ Material për përdorim të pavarur nga nxënësit.

Forma të përdorimit të rekomanduara:

- ✓ Shfrytëzimi i kabineteve të informatikës në kuadër të shkollës;

- ✓ Shfrytëzimi i mjeteve audio-vizuele në klasa;
- ✓ Shfrytëzimi i kompjuterëve privatë/në shtëpi;
- ✓ Krijimi i një platforme elektronike;
- ✓ Përcaktimi i lëndës së Gjuhës angleze si lëndë zgjedhore.

Me siguri që në asnjë rrethanë përdorimi i materialit didaktik “*English for Beginners*” nuk e pengon përdorimin e materialeve të tjera plotësuese mësimore që ndihmojnë në arritjen e rezultateve të përcaktuara në planet dhe programet mësimore të gjuhës angleze për shkollat profesionale.

Për të vlerësuar format dhe mënyrat e mundshme të integrimit të materialit didaktik elektronik “*English for Beginners*” në mësimdhënie dhe nxënie të gjuhës angleze në shkollat e mesme profesionale, si dhe ndikimin e përdorimit të materialit didaktik elektronik në arritjet/rezultatet e nxënësve në lëndën e Gjuhës angleze në shkollat profesionale, i rekomandojmë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës që, mbi bazën e rezultateve të studimit, të lejojë përdorimin e materialit didaktik “*English for Beginners*” për pilotim në disa shkolla profesionale të Kosovës. Kurse, vlerësimi dhe licencimi i materialit didaktik elektronik për zbatim në të gjitha shkollat profesionale të Kosovës, në klasat përkatëse, të bëhet vetëm mbi bazën e rezultateve pozitive që dalin nga pilotimi i materialit didaktik elektronik.

Burimet:

- *Smart bits* (Consulting & Solution) dhe *Swiss Contact* (Swiss Cooperation Office Kosovo): Materiali didaktik/CD-„English for Beginners.’’
- *MASHT* : Planet dhe programet mësimore të gjuhës angleze, klasat 10-12.
- *Oxford University Press: New Headway Pre-Intermediate* (Student’s Book & Workbook).
- *Oxford University Press: New Headway Intermediate* (Student’s Book & Workbook).
- *Oxford University Press: New Headway Uper –Intermediate* (Student’s Book & Workbook).

Botues

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Zhvillimi i kompetencave për TIK dhe gjuhë angleze – perspektivë
për integrim në epokën digjitale

Përgatitja kompjuterike: Instituti Pedagogjik i Kosovës

Shtypi

Shtypshkronja “Teknika”, Prishtinë

Katalogimi në botim – CIP

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

37:004(047)

37:811.111(047)

Zylfiu, Haxhere

Zhvillimi i kompetencave për TIK dhe gjuhë
angleze – perspektivë për integrim në epokën
digjitale: raporte të studimeve / Haxhere Zylfiu,
Selim Mehmeti. – Prishtinë: Instituti Pedagogjik i
Kosovës, 2013. – 205 f.: ilustr. me ngjyra; 21 cm.

Shkurtesat e përdorura : f. 11-12. – Burimet :f. 200
1. Mehmeti, Selim

ISBN 978-9951-591-03-4